



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË TREPÇA SH.A PËR VITIN 2025

Raporti i nënshkruar nga  
Vlora Spanca,  
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2026

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Trepça sh.a për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2025, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Trepça sh.a (Trepça sh.a), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes/ve së përshkruar në paragrafin “Baza për Opinion të Kundërt”, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Trepça sh.a deri me 31 dhjetor 2025, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2025, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

## Baza për Opinion të kundërt

- B1 Ndërmarrja nuk ka zbatuar në mënyrë të plotë kërkesat e SNK 2 “Inventarët” lidhur me matjen dhe prezantimin e stoqeve në pasqyrat financiare. Për një pjesë të konsiderueshme të stoqeve, në veçanti për mbetjet teknologjike/sterilin dhe mbeturinat e procesit të fërgimit të piritit (FeS<sub>2</sub>) dhe pirotinës (FeS) në vlerë prej 23,187,129€, nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme për metodologjinë e përdorur në përcaktimin e vlerës, duke krijuar pasiguri mbi saktësinë e tyre.
- B2 Ndërmarrja ka prezantuar në Pasqyrën e të ardhurave dhe në Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet vlera që nuk përputhen me shënimet kontabël dhe evidencën mbështetëse, duke rezultuar në mospërputhje materiale ndërmjet pasqyrave financiare dhe regjistrave kontabël. Këto pasaktësi ndikojnë në paraqitjen e drejtë dhe të besueshme të performancës financiare dhe pozicionit financiar të ndërmarrjes për periudhën raportuese.
- B3 Ndërmarrja nuk ka paraqitur saktë obligimin e klientit si llogari të arkëtueshme si rezultat, pasqyrat financiare paraqesin mbivlersësim të llogarive të arkëtueshme për 376,245€
- B4 Ndërmarrja nuk ka siguruar regjistrim të plotë dhe të saktë të pasurive afatgjata dhe nuk ka siguruar dokumentacion për pasuri në vlerë prej 42,755,994€. Si rezultat, pasuritë e paluajtshme dhe të dhënat përkatëse nuk janë të pasqyruara në mënyrë të plotë dhe të saktë në pasqyrat financiare, duke ndikuar në besueshmërinë e raportimit financiar dhe duke rritur rrezikun e keqmenaxhimit dhe humbjes së pasurive.

- B5 Ndërmarrja nuk kishte aplikuar fare zhvlerësimin për ndërtesat dhe strukturat ndërtimore vlera e të cilave ishte prezantuar në pasqyra financiare 45,984,576€, dhe automjete transporti dhe pajisje në vlerë 112,538,322€, për shkak të mungesë së një politike të qartë dhe të unifikuar për zhvlerësimin e pasurive në njësitë e saj. Për pasojë, ekziston rreziku që pasuritë dhe rezultatet financiare të jenë materialisht të shtrembëruara, duke ndikuar në paraqitjen e drejtë të pozitës financiare të ndërmarrjes.
- B6 Shënimet kontabël nga të cilat rrjedhin pasqyrat financiare nuk respektojnë parimin e kontabilitetit të dyfishtë, pasi ana kredi tejkalon anën debi për 10,252,608€, duke reflektuar mungesë të kontroleve dhe duke cenuar besueshmërinë e të dhënave kontabël dhe pasqyrave financiare të ndërmarrjes.
- B7 Ndërmarrja nuk ka shpalosur në pasqyrat financiare detyrimet kontingjente në vlerë prej 5,911,008€ nga konteste gjyqësore, për shkak të mungesës së bashkëpunimit mes zyrës ligjore dhe financave si dhe mungesës së procedurave të brendshme.
- B8 Ndërmarrja nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse për vlerën e kapitalit aksionar prej 596,084,306€, duke pasur mospërputhje me statutin që e përcakton kapitalin themeltar në 10,000€. Mungesa e dokumentacionit mbështetës të mjaftueshëm për të dëshmuar origjinën, përbërjen dhe ndryshimet e këtyre zërave, e bën të pamundur të marrim siguri për këtë llogari.
- B9 Ndërmarrja nuk ka siguruar harmonizim të plotë ndërmjet regjistrit analitik të pasurive dhe pasqyrave financiare, duke rezultuar në mospërputhje materiale në vlerat e pasurive afatgjata, në shumë prej 2,846,203€. Si rezultat, pasqyrat financiare nuk paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme pozitën financiare të ndërmarrjes.
- B10 Ndërmarrja kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme në vlerë prej 1,202,606€, për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës dhe mos zbritjes së pagesave për shpronësimin.
- A1 Gjatë auditimit konstatuam se ndërmarrja nuk kishte siguruar dokumentacion të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm mbështetës për verifikimin e një pjese të të hyrave të regjistruara në Librin Kryesor në vlerë prej 243,572€. Po ashtu, u identifikuan mospërputhje ndërmjet Librit Kryesor dhe Pasqyrave Financiare Vjetore, si dhe llogaritje jo të sakta të disa të hyrave nga shërbimet.
- B11 Ndërmarrja nuk ka përjashtuar transaksionin ndërmjet njërive të saj gjatë konsolidimit financiar, duke përfshirë gabimisht shumën prej 780,472€ në llogaritë e arkëtueshme tjera.
- A2 Kemi identifikuar raste të klasifikimit jo të duhur të investimeve kapitale dhe pasurive jo-materiale, të cilat janë regjistruar si shpenzime operative në kundërshtim me kërkesat e SNK/IAS 16 dhe SNK/IAS 38. Si rezultat, shpenzimet operative janë mbivlerësuar për shumën prej 140,416€, duke ndikuar në paraqitjen e drejtë dhe të saktë të pasqyrave financiare.
- A3 Ndërmarrja nuk ka reflektuar në mënyrë të plotë dhe të saktë efektet e faturave finale dhe notave kreditore që rrjedhin nga kontrata e shitjes, duke ndikuar në paraqitjen jo të drejtë të të hyrave në pasqyrat financiare. Si rezultat, të hyrat nga shitjet janë mbivlerësuar për 59,049€, duke bërë që pasqyrat financiare të mos paraqesin në mënyrë të saktë gjendjen financiare dhe rezultatin nga të hyrat në kundërshtim me kërkesat e SNFR15.

- A4 Ndërmarrja nuk ka trajtuar në mënyrë të drejtë obligimet e bartura nga vitet paraprake në kartelat e klientëve dhe në regjistrat kontabël. Si rezultat, një pjesë e këtyre obligimeve është regjistruar gabimisht si të hyra të vitit 2025, duke çuar në mbivlerësim të shitjeve/të hyrave në vlerë prej 75,781€ dhe njëkohësisht në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme. Për më tepër, edhe mosverifikimi i obligimeve për klientë para përgaditjes së PFV ka ndikuar në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme. Mosregjistrimi i saktë i obligimeve të bartura nga periudhat e kaluara dhe mosverifikimi i obligimit për klientë ka rezultuar në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 152,174€.
- B12 Gjatë auditimit konstatoam se ndërmarrja nuk ka zbatuar në mënyrë të qëndrueshme parimin aktual gjatë njohjes së shpenzimeve, duke rezultuar në regjistrim të transaksioneve në periudha të gabuara. Janë identifikuar raste ku shpenzimet janë njohur në momentin e pagesës në regjistrat kontabel dhe jo kur ka lindur detyrimi në vlerë 259,892€, ndërsa për vlerën 380,516€ shpenzimet janë nënvlerësuar, dhe raste të mos-përputhjes së shpenzimeve me regjistrimet kontabël dhe pasqyrat financiare në vlerë 370,048 €
- B13 Ndërmarrja ka prezantuar detyrime ndaj granteve në pasqyrat financiare pa ofruar dëshmi mbështetëse për to në vlerë 3,071,409€, për shkak të mungesës së databazës së pasurive të financuara nga grantet, duke rritur rrezikun për pasqyrim jo të saktë të tyre në pasqyra financiare.
- B14 Ndërmarrja kishte përfshirë gabimisht parapagimet e klientëve, në shumë prej 456,745€, në analitikën e llogarive të arkëtueshme si vlera negative, duke rezultuar në nënvlerësim të llogarive të arkëtueshme në pasqyrat financiare. Po ashtu, vlera e parapagimeve të prezantuara në pasqyra financiare ishte nënvlerësuar për 82,639€.
- B15 Ndërmarrja obligimet ndaj tatimit në burim i kishte prezantuar të nënvlerësuar në pasqyrat financiare për vitin 2025 në shumën prej 37,225€, përderisa obligimet ndaj kontributeve pensionale i kishte prezantuar të mbivlerësuar për vlerë 51,615€ duke mos reflektuar gjendjen e saktë të borxhit tatimor ndaj ATK-së.
- B16 Kemi identifikuar mospërputhje materiale ndërmjet pasqyrave financiare dhe evidencave kontabël lidhur me detyrimet afatshkurtra, përfshirë interesin e pagueshëm për rentën minerare dhe llogaritë e pagueshme. Gjithashtu, për detyrime në vlerë prej 4,803,981€ nuk kemi mundur të sigurojmë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme auditimi për të verifikuar ekzistencën, saktësinë dhe plotësinë e tyre.

*Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përkrahur më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjes/ve të përshkruara në kapitullin Baza për Konkluzion, transaksionet e kryera të Trepça sh.a nuk ishin në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A5 Ne kemi identifikuar se në një procedurë prokurimi operatori ekonomik i shpallur fitues nuk kishte ofruar dëshmi të plotë për regjistrimin profesional, komercial dhe/apo në regjistrin e ndërmarrjeve, siç kërkohet me Ligjin për Prokurimin Publik. Kjo tregon mungesë të verifikimit të plotë të dokumentacionit gjatë fazës së vlerësimit dhe dobësi në kontrollin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore të kualifikimit.
- A6 Ndërmarrja nuk kishte funksionalizuar dhe përdorur plotësisht modulet e stoqeve dhe asetëve të parapara me kontratë dhe specifikimet teknike të sistemit KIT. Si rezultat, evidencimi dhe menaxhimi i stoqeve dhe asetëve nuk ishte kryer plotësisht përmes sistemit, duke rritur rrezikun për paraqitje jo të saktë të tyre në pasqyrat financiare.
- A7 Gjatë auditimit konstatoam se Njësia Kopaonik-Leposaviç nuk ka zbatuar kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë lidhur me pranimin dhe protokollimin e dokumentacionit financiar. Faturat e pranuar nga furnitorët nuk janë regjistruar në evidencën themelore të protokollit, nuk janë pajisur me vulë dhe datë pranimi, si dhe nuk u është caktuar numër zyrtar protokollit në ditën e pranimit. Në vend të kësaj, është përdorur një evidencë e brendshme jozyrtare, e cila nuk i plotëson kërkesat ligjore për administrimin e dokumenteve.
- A8 Gjatë auditimit kemi identifikuar se Njësia Kopaonik Leposaviç ka realizuar pagesa për punonjësit të cilat nuk janë trajtuar si pjesë e pagës bruto dhe nuk janë subjekt i tatimit në të ardhura personale dhe kontributeve pensionale, në kundërshtim me kërkesat e legjislati i fiskal në fuqi. Po ashtu, këto pagesa janë klasifikuar në mënyrë jo të duhur në llogaritë kontabël, duke ndikuar në paraqitjen e drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare.
- A9 Gjatë auditimit kemi identifikuar se kontratat e punës të punonjësve të Njesisë Kopaonik-Leposaviç vazhdojnë të jenë të nënshkruara në emër të “Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP-së”, subjekt juridik i shuar sipas Ligjit për Trepçën.
- A10 Janë identifikuar dobësi të rëndësishme në procesin e inventarizimit të pasurive, pasi inventarizimi nuk ishte kryer në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e brendshme të ndërmarrjes. Mangësitë e evidentuara përfshijnë mungesën e raportit përmbledhës të inventarizimit, mos përfshirjen e të gjitha kategorive të pasurive në inventarizim, mungesën e identifikimit të pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit, si dhe mungesën e krahasimit ndërmjet gjendjes fizike dhe regjistrave kontabël. Si rezultat, ekziston rreziku që pasuritë të mos prezantohen saktë dhe në mënyrë të plotë në pasqyrat financiare.
- B17 Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka transferuar 119 punonjës në pozita të tjera, përfshirë ndryshime në paga pa nënshkrim të kontratës së re apo aneksit.
- B18 Shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare nuk përmbanin të gjitha informacionet e kërkuara nga standardet e kontabilitetit, përfshirë mungesën e bazës së përgatitjes, mospërputhje të referencave me zërat përkatës dhe mungesë të shpalosjes së politikave për grantet.

- B19 Në një rast kemi identifikuar se kontrata e nënshkruar nuk ishte në përputhje të plotë me ofertën e vlerësuar.
- B20 Ndërmarrja nuk ka bërë provizionimin e llogarive të arkëtueshme tregtare sipas IFRS 9, duke mos reflektuar humbjet e pritshme nga klientët. Kjo ka rezultuar në mbivlerësim të aktiveve dhe fitimit.
- B21 Ndërmarrja nuk ka realizuar vlerësimin e pasurive në pronësi të saj dhe as vlerësimin e mbetjeve teknologjike.
- B22 Ndërmarrja nuk i ka përgatitur dhe miratuar në afat pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e menaxhmentit për vitin 2025.
- B23 Është identifikuar mungesë e dokumentimit të certifikimit të pagesave nga zyrtari certifikues për një pjesë të periudhës së audituar, si dhe mungesë të një forme zyrtare të dokumentimit të këtij procesi në njësinë Kopaonik-Leposaviç. Kjo ka rezultuar në pagesa të realizuara pa dëshmi të plotë të certifikimit nga zyrtari i autorizuar, duke treguar dobësi në kontrollin e brendshëm dhe në zbatimin e kërkesave ligjore.
- B24 Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh. A. nuk ka arritur t'i ushtroj kompetencat e veta në të gjitha njësitë biznesore të ndërmarrjes. Njësia Biznesore Minierat me flotacion Kopaonik-Leposaviç nga aspekti organizativ, rregullativ dhe financiar ka operuar jo në harmoni të plotë me kërkesat ligjore.
- B25 Ndërmarrja nuk ka hartuar dhe miratuar në tërësi rregulloret e brendshme të kërkuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe Statutin e Trepça Sh.A., të cilat janë të domosdoshme për administrimin dhe funksionimin e proceseve kryesore operative dhe financiare.
- B26 Ndërmarrja nuk ka kryer pagesat për tatimin në paga dhe kontributet që nga viti 2020, duke akumuluar detyrime prej 15,005,277€, përfshirë interesa dhe ndëshkime. Po ashtu, për rreth 107 punonjës në njësinë në Leposaviç nuk është bërë deklarimi i tatimit në Administratën Tatimore.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë te pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Çështjet kyçe të auditimit**

Çështjet kyçe të auditimit në auditimin e Pasqyrave Financiare të Trepça sh.a për 2025 ishin si më poshtë:

1. Ndërmarrja gjatë vitit 2025 është përballur me procedura përmbarimore, ku vlera e lëndëve në pritje për t'u ekzekutuar në fund të vitit ishte 1,677,226€. Gjithashtu, në pasqyrat financiare vjetore, ndërmarrja ka njohur humbje të vitit në shumën prej 2,233,687€. Për më tepër, ndërmarrja ka pranuar subvencione nga Qeveria në vlerë prej 5,320,332€ (46% më pak krahasuar me vitin paraprak), të cilat janë përdorur kryesisht për pagesën e pagave të punonjësve.

Pavarësisht kësaj mbështetjeje, gjendja financiare e ndërmarrjes mbetet e brishtë, pasi detyrimet afatshkurtra në fund të vitit arritën në 36,741,032€. Pamundësia për të shlyer obligimet në afat ndikon drejtpërdrejt në rritjen e kostove shtesë gjyqësore dhe përmbarimore, si dhe rrit rrezikun për mosqëndrueshmëri financiare dhe mungesë solventiteti në afat të gjatë.

Ndërmarrja "Trepça" Sh.A. posedon prona, pajisje dhe impiante me vlerë të konsiderueshme kontabël në njësitë e saj operative, përfshirë Njësinë Biznesore Miniera me Flotacion "Stan Tërg", Njësinë Biznesore "Kishnicë-Artanë" dhe Njësinë Biznesore "Kopaonik-Leposaviç". Këto asete përfshijnë pajisje dhe infrastrukturë minerare të instaluar në periudha të ndryshme historike, si makineri ngritëse, ventilatorë kryesorë, kompresorë, makineri me djegie të brendshme, sisteme pompimi, pajisje të flotacionit si dhe infrastrukturë transporti minerar.

Për shkak të vjetërsisë së theksuar të pajisjeve dhe teknologjisë, mungesës së pjesëve rezervë dhe mungesës së investimeve kapitale, ekziston një rrezik i lartë që asetet të jenë të ekspozuara ndaj vjetërsisë teknologjike dhe zhvlerësimit potencial. Kjo situatë mund të ndikojë në mënyrë materiale në përcaktimin e jetëgjatësisë së dobishme të aseteve, vlerën e mbetur të tyre, llogaritjen e amortizimit, efikasitetin operacional të proceseve prodhuese, si dhe vazhdimësinë dhe sigurinë e operacioneve.

Gjithashtu, janë identifikuar tregues të mundshëm të zhvlerësimit, përfshirë humbjet operative në procesin e flotimit të xehe, ndërprerjet e shpeshta teknike, si dhe sfida në funksionimin e sistemeve të ajrimit dhe pompimit. Ndërsa në Njësinë Biznesore "Kopaonik-Leposaviç" janë realizuar investime në rekonstruktimin e flotacionit në vitin 2012.

Vlerësimi i menaxhmentit lidhur me jetëgjatësinë e dobishme të aseteve, normat e amortizimit dhe nevojën për testim të zhvlerësimit përfshin nivel të lartë gjykimi profesional dhe vlerësimesh kontabël.

**Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit mbi to**

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionet në raportin e menaxhmentit dhe deklaratën e qeverisjes korporative, por këto informacione nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditorit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale.

Ne kemi marrë parasysh nëse informacionet në raportin për menaxhmentin janë në përputhje me informacionet në pasqyrat financiare dhe deklaratat e qeverisjes korporative përfshinë shpalosjet e kërkuara me nenet 7 dhe 10 të ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Nëse, bazuar në punën e kryer, arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Trepça sh.a.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Trepça sh.a është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Trepça sh.a në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>2</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Trepça sh.a me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Trepça sh.a.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruar të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Trepça sh.a, për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me 36 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja, dhe 26 të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Mos prezantim i drejtë i vlerës stoqeve

##### Gjetja

Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 2 "Inventarët":

Paragrafi 9: Stoqet duhet të maten me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe vlerës së realizueshme neto.

Paragrafët 10-18: Kostoja e stoqeve përfshin kostot e blerjes, kostot e konvertimit dhe kostot e tjera të nevojshme për t'i sjellë ato në gjendjen dhe vendndodhjen e tanishme.

Paragrafët 28-33: Vlera e realizueshme neto përcaktohet si çmimi i vlerësuar i shitjes në kursin normal të biznesit, minus kostot e vlerësuara për përfundim dhe kostot e vlerësuara të nevojshme për të kryer shitjen. Vlerësimi duhet të bazohet në dëshmi të besueshme, objektive dhe të dokumentuara.

Nga analizimi i vlerës së stoqeve të prezantuara në pasqyrat financiare kemi identifikuar mangësi të rëndësishme lidhur me matjen dhe prezantimin e tyre. Konkretisht, për një pjesë të konsiderueshme të stoqeve, në veçanti mbetjet teknologjike/sterilin në vlerë prej 19,080,575€, si dhe mbeturinat e procesit të fërgimit të piritit (FeS<sub>2</sub>) dhe pirotinës (FeS) në vlerë 4,106,554€, ndërmarrja nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme dhe të besueshme mbi metodologjinë e përdorur për përcaktimin e vlerës.

Mungesa e bazës së qartë për vlerësim (si p.sh. kostoja, vlera neto e realizueshme apo ndonjë metodë tjetër e pranueshme kontabël) krijon pasiguri të konsiderueshme mbi saktësinë e prezantimit të këtyre stoqeve në pasqyra financiare dhe rrit rrezikun për mbivlerësim apo nënvlerësim të tyre. Për më tepër, edhe pse ndërmarrja kishte realizuar një studim fizibiliteti lidhur me rezervat e metaleve në deponitë e mbetjeve industriale, mungesa e analizave konkrete mbi trajtimin industrial dhe mungesa e vlerësimit ekonomik të qartë të këtyre rezervave e kufizon përdorshmërinë e këtij studimi për qëllime të raportimit financiar. Si rrjedhojë, prezantimi i stoqeve nuk reflekton në mënyrë të besueshme gjendjen reale dhe vlerën ekonomike të tyre.

Kjo dobësi kishte ndodhur si pasojë e një praktike të trashëguar ndër vite, dhe tejkalimit të detyrave dhe përgjegjësive të cilat i kishte komisioni i inventarizimit, në përcaktimin e vlerës së stoqeve për prezantim në Pasqyra Financiare.

#### **Ndikimi**

Kjo rezulton në pasiguri të konsiderueshme mbi saktësinë e vlerës së stoqeve të prezantuara në pasqyrat financiare. Kjo mund të ketë sjellë mbivlerësim ose nënvlerësim të tyre, duke ndikuar drejtpërdrejt në pozicionin financiar të ndërmarrjes dhe në rezultatin e saj financiar.

#### **Rekomandimi B1**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që menaxhmenti i ndërmarrjes të vendosë dhe zbatojë politika të qarta dhe të dokumentuara për vlerësimin e stoqeve, në përputhje me standardet përkatëse të raportimit financiar, duke garantuar që çdo vlerë e prezantuar në pasqyrat financiare të mbështetet në dëshmi të mjaftueshme dhe metodologji të besueshme (si kostoja apo vlera neto e realizueshme). Gjithashtu, Bordi duhet të sigurojë vlerësime të pavarura dhe profesionale për stoqet specifike si dhe të ndërmarrë hapa konkret për përcaktimin e vlerës së tyre ekonomike dhe trajtimin e tyre në përputhje me praktikën më të mira.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Mos prezantim i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë gatshme dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet**

##### **Gjetja**

Sipas SNK 1- Paraqitja e pasqyrave financiare, pika 38 informacion krahasues, me përjashtim të rastit kur lejohet ose kërkohet nga SNRF-të, për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare duhet të paraqesë informacion krahasues në lidhje me periudhën e shkuar për të gjitha shumat e raportuara në pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Si dhe sipas SNK 7, një njësi ekonomike përgatit një pasqyrë të fluksit monetar në përputhje me kërkesat e këtij Standardi dhe e prezanton atë si pjesë përbërëse të pasqyrave financiare të saj për secilën periudhë për të cilën paraqiten pasqyrat financiare. Po ashtu, Sipas SNK 1 paketa e plotë e pasqyrave financiare paragrafi 10 , një paketë e plotë e pasqyrave financiare përmban ndër të tjera edhe pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto për periudhën.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin 2025 paraqet informacion krahasues për vitin 2024, por ka pasaktësi në rregullimet fillestare. Konkretisht, është bërë një "Korrigjim i PFV nga viti 2024" në shumën 857,252 €, pa dëshmi mbështetëse të plota, dhe pa shpalosje në shënimet shpjeguese. Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet paraqet rritje të madhe të kapitalit aksionar nga 358,711,927€ me 31 dhjetor 2024 në 596,084,306€ me 31 dhjetor 2025, kryesisht për shkak të rritjes së vlerës së tokës me 237,372,379€. Megjithatë, vlerat krahasuese për vitin 2024 nuk përputhen me shënimet kontabël. Për më tepër, rritja e kapitalit aksionar dhe ekuitetit (përfshirë vlerën e tokës me 237,372,379€) nuk është mbështetur plotësisht me dokumentacion kontabël të verifikueshëm. Si rezultat, të dy pasqyrat (rrjedhja e parasë dhe ndryshimet në ekuitet) nuk paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme lëvizjet financiare të ndërmarrjes gjatë vitit 2025.

Po ashtu, gjetjet e identifikuar në këtë raport kanë ndikim të drejtpërdrejtë dhe material në Pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.

Shkak për mos prezantimin e saktë të informacioneve ishte mungesa e kontrollit të brendshëm gjatë përpilimit të pasqyrave si dhe mungesa e dëshmive përkatëse.

<b>Ndikimi</b>	Mangësitë e identifikuar përveç që nuk ofrojnë informacion të besueshëm ndikojnë, në kredibilitetin e pasqyrave financiare në tërësi.
<b>Rekomandimi B2</b>	Bordi Mbikëqyrës të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet, si dhe të marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Mosparaqitja e saktë e gjendjes së klientit në llogaritë e arkëtueshme**

<b>Gjetja</b>	Sipas SNRF 15 (paragrafët 31-33, 39, 40, 47 dhe 105-107) dhe Kornizës Konceptuale (paragrafi 4.53), çdo pagesë e pranuar paraprakisht nga klienti para transferimit të kontrollit mbi mallrat duhet të regjistrohet si detyrim kontraktual (të hyra të shtyra), ndërsa shuma përkatëse si rritje e mjeteve monetare. Edhe pasi që kontrolli mbi mallrat kalon te blerësi, të ardhurat nuk njihen menjëherë në shumën përfundimtare, por si të hyra akruale, duke reflektuar faktin se vlera e faturës përfundimtare mund të jetë ende e pasigurt dhe duhet konfirmuar. Regjistrimet kontabël duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë, kronologjike dhe në përputhje me substancën ekonomike të marrëveshjes, të gjitha fazat e transaksionit, duke respektuar parimin e kontabilitetit akrual.
---------------	---

Gjatë auditimit kemi konstatuar se ndërmarrja nuk kishte marrë për bazë gjendjen reale të klientit më 31.12.2024 gjatë bartjes së saldove fillestare për vitin 2025. Në regjistrat kontabël ishte bartur e njëjta vlerë e llogarive të arkëtueshme prej 506,251€, pa u korrigjuar për pagesën e realizuar gjatë vitit 2024 në shumën prej 480,819€. Si rezultat, saldoja fillestare reale për vitin 2025 duhej të ishte 25,432€.

Sipas evidencave kontabël, shitjet e regjistruara sipas DUD-it ishin në vlerë prej 11,648,305€, ndërsa pagesat e pranuar gjatë vitit 2025 ishin 11,543,731€. Bazuar në këto regjistrime, gjendja përfundimtare e llogarive të arkëtueshme pa përfshirjen e faturës finale rezultoi të jetë 130,007€. Kjo vlerë nuk përputhet as me letërkonfirmimin e pranuar nga klienti, ku saldoja e raportuar ishte 281,348 USD, përkatësisht 239,145€ pas konvertimit në euro. Diferenca ndërmjet këtyre dy vlerave është 109,138€.

Megjithëse gjendja reale sipas regjistrimeve kontabël rezultoi 130,007€, ndërmarrja në PFV kishte paraqitur vlerën e llogarive të arkëtueshme prej 506,251€. Si rezultat, llogaritë e arkëtueshme janë mbivlerësuar për 376,245€.

Mungesa e njohurive të mjaftueshme për aplikimin e kushteve të kontratës, si dhe mungesa e procedurave të qarta dhe kontrolleve efektive të brendshme për regjistrimin e saktë në kontabilitet, kanë ndikuar në trajtimin jo të duhur të llogarive të arkëtueshme.

#### **Ndikimi**

Si rezultat i mosparaqitjes së saktë për borxhet nga klienti, llogaritë e arkëtueshme janë mbivlerësuar, duke ndikuar në mosparaqitjen e saktë dhe reale të pasqyrave financiare të ndërmarrjes

#### **Rekomandimi B3**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme dhe hartimin e procedurave të qarta për trajtimin kontabël të kontratave të shitjes, në mënyrë që llogaritë e arkëtueshme dhe shitjet të regjistrohen dhe korrigjohen në përputhje me kushtet kontraktuale, faturat finale dhe dokumentacionin mbështetës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B4 - Mosregjistrim i plotë i pasurive dhe mungesë e dokumentacionit mbështetës**

##### **Gjetja**

Sipas SNK 16, Toka, ndërtesa, makineria dhe pajisjet janë zëra materiale që mbahen për përdorim në prodhimin ose furnizimin e të mirave ose shërbimeve, për dhënie me qira palëve të treta ose për qëllime administrative dhe pritet të përdoren gjatë më shumë se një periudhë

Nga analizimi i fushës së pasurive kemi vërejtur dobësitë si në vijim:

- Ndërmarrja nuk ka arritur të sigurojë dokumentacionin burimor për 59 pasuri në vlerë totale prej 42,755,994€;
- Njësia Kopaonik Leposaviq nuk ka shpalosur 668 parcela me sipërfaqe prej 309 hektarësh në pasqyrat financiare, ndonëse këto janë evidentuar nga komisioni i inventarizimit;
- Janë identifikuar 107 parcela në njësinë biznesore Miniera Kopaonik - Leposaviq (zona kadastrale Zveçan) të cilat sipas të dhënave kadastrale figurojnë si pronë e ndërmarrjes, por nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të njësisë;
- Ndërmarrja nuk posedon një databazë të plotë dhe të detajuar për banesat e dhëna në shfrytëzim punonjësve të saj. Sipas të dhënave të siguruara përmes zyrës ligjore, janë evidentuar 236 kërkesa nga punonjësit për blerjen e banesave;
- Nga analiza e regjistrit të parcelave të pranuar nga Trepça Sh.a. kemi konstatuar se 129 parcela në vlerë prej 33,907,680€ nuk janë të regjistruara në pronësi të vetme të Trepça Sh.a., por figurojnë si bashkëposedim. Për më tepër, lloji i pronës për këto parcela është i kategorizuar si pronë shoqërore, gjë që paraqet paqartësi lidhur me të drejtat pronësore të ndërmarrjes mbi këto asete.

Këto mangësi kanë ndodhur si rezultat i mungesës së veprimeve të vazhdueshme dhe të koordinuara ndër vite për trajtimin e çështjeve pronësore, si dhe mungesës së një sistemi të plotë dhe të azhurnuar të menaxhimit të pasurive afatgjata.

#### **Ndikimi**

Mos përditësimi dhe mos regjistrimi i plotë i pasurive afatgjata ndikon në pasqyrimin jo të saktë të vlerës së pasurive në pasqyrat financiare. Kjo rrit rrezikun e keqmenaxhimit, përdorimit të paautorizuar të pasurive dhe humbjes apo tjetërsimit të tyre, si dhe zvogëlon besueshmërinë e raportimit financiar.

#### **Rekomandimi B4**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për trajtimin e çështjeve pronësore të ndërmarrjes dhe përditësimin e plotë të regjistrit të pasurive. Regjistri i pasurive duhet të pasqyrojë saktë dhe në mënyrë të plotë gjendjen aktuale të pasurive afatgjata, në përputhje me kërkesat ligjore, standardet përkatëse dhe kërkesat e raportimit financiar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B5 - Mangësitë lidhur me zhvlerësimin e pasurive**

##### **Gjetja**

Sipas SNK 16 pika 50, shuma e amortizueshme e një pasurie do të shpërndahet mbi baza sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Ndërsa në pikën 55 të këtij standardi jepen shpjegime se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, d.m.th. kur ai është në vendin dhe kushtet e nevojshme për të, që të ketë mundësi të funksionojë në mënyrën e synuar nga drejtimi.

Nga analizat tona të regjistrimit të pasurive dhe prezantimit në PVF kemi vërejtur mangësitë lidhur me trajtimin e zhvlerësimit të pasurive në ndërmarrje si në vijim:

Ndërmarrja politikën e zhvlerësimit të pasurive e kishte të bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mirëpo nuk e kishte zbatuar në praktikë; Ndërsa, njësitë biznesore Kopaonik-Leposaviç kishte aplikuar normat tjera të zhvlerësimit duke u bazuar në kërkesat e ATK-së;

Ndërmarrja nuk kishte aplikuar fare zhvlerësimin për ndërtesat dhe strukturat ndërtimore, vlera e të cilave ishte prezantuar në pasqyra financiare 45,984,576€ si dhe automjete transporti dhe pajisje në vlerë 112,538,322€.

Kjo kishte ndodhur për arsye të pa qartësisë dhe mungesës së një politike të brendshme adekuate për menaxhimin dhe zhvlerësimin e pasurive të ndërmarrjes, si dhe mungesës së një regjistri të plotë dhe të integruar në sistemin e kontabilitetit.

**Ndikimi** Mangësitë e tilla ndikojnë që pasqyrat financiare vjetore të mos prezantojnë gjendjen e drejtë dhe të vërtetë.

**Rekomandimi B5** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të përcaktuar një politike të menaxhimit të pasurive dhe zhvlerësimit të pasurive në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B6 - Mos barazimi i debisë dhe i kredisë në libër kryesor**

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet raportim financiar dhe auditim Neni 11 regjistrat kontabël dhe librat e llogarive pika 2 regjistrat kontabël përfshijnë regjistra të hyrjeve fillestare kontabël dhe regjistra mbështetës, siç janë kontrollet dhe regjistrat e transfereve të fondeve elektronike; fatura, kontratave, librave kryesor dhe ato dytësor, shënimeve në ditar dhe rregullimeve tjera në pasqyrat financiare të cilat nuk janë reflektuar tek hyrjet në ditar, dhe regjistrat si fletë pune që mbështesin alokimet e kostos, llogaritjet, barazimet dhe shpalosjet. Regjistrat kontabël ruhen në sistemin e regjistrimit të dyfishtë kontabël.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se shënimet kontabël, të cilat shërbejnë si bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare, nuk janë të balancuara, pasi ana debi nuk përputhet me anën kredi me një vlerë prej 10,252,608€.

Kjo ka ndodhur nga mungesa e mirëfilltë e kontrolleve në departamentin përkatës që është përgjegjës për përpilimin e pasqyrave financiare vjetore, dhe mangësive sistematike në procesin e regjistrimit të të dhënave financiare.

**Ndikimi** Mos barazimi i librit kryesor dhe ditarit ndikon në mos besueshmërinë e të dhënave kontabël prej të cilave rrjedh përpilimi PFV-të e ndërmarrjes.

**Rekomandimi B6** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që ndërmarrja gjatë regjistrimit dhe përpilimit të PFV ka përdorur kontabilitetin e dyfishtë si dhe duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme dhe identifikimi i gabimeve që ka shkaktuar këtë mos barazim.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B7 - Mos shpalojta e detyrimeve kontingjente**

**Gjetja** Sipas SNK 37 njësitë ekonomike duhet të shpalosin në shënimet shpejguese detyrimet kontingjente që mund të kenë ndikim të rëndësishëm financiar, nëse ato burojnë nga ngjarje të kaluara dhe ekziston mundësia që të rezultojnë në dalje të burimeve ekonomike në të ardhmen.

Ndërmarrja nuk kishte bërë asnjë shpalojta në pasqyrat financiare për vitin 2025 lidhur me detyrimet kontingjente. Nga dokumentacioni i pranuar nga zyra ligjore rezulton se ndërmarrja është palë e paditur në konteste gjyqësore me vlerë totale 5,911,003€.

Gjithashtu, në procedurë përmbartimore ishte paraqitur vlera prej 2,205,963€. Sipas gjendjes së pagesave në bankë, një pjesë e këtyre obligimeve, në vlerë prej 528,737€, ishte ekzekutuar, mirëpo kjo vlerë nuk ishte pasqyruar në listën përfundimtare të Zyrës Ligjore. Zyra Ligjore kishte paraqitur në procedurë përmbartimore vlerën totale prej 2,205,963€, ndonëse pas zbritjes së pagesave të ekzekutuara, vlera reale e mbetur ishte 1,677,226€.

Mos shpalojta ka ardhur si rezultat i mungesës së bashkëpunimit ndërmjet zyrës ligjore dhe departamentit të financave, si dhe mungesës së procedurave të brendshme për raportimin e detyrimeve kontingjente.

**Ndikimi** Mos përfshirja e këtyre detyrimeve cenon transparencën dhe besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe rrit rrezikun për vendimmarrje jo të informuar nga ana e palëve të interesit.

**Rekomandimi B7** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë, së bëhen vlerësimet e nevojshme për provizionet dhe detyrimet kontingjente dhe të jepen informacionet shpejguese të plota në pasqyra financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B8 - Mungesa e dëshimve për llogarinë e kapitalit aksionar****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet raportim financiar dhe auditim Neni 11 regjistrat kontabël dhe librat e llogarive pika 4 libri kryesor është regjistër kronologjik kontabël i cili përdoret për të mbajtur gjurmët e transaksioneve financiare. Transaksionet kategorizohen dhe përmbledhen në llogaritë e Librit Kryesor. Llogaria është regjistër i veçantë për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, kapitalit, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe zërave jashtë bilancit të gjendjes. Llogaritë e librit kryesor përfshijnë të gjitha llogaritë e planit kontabël të njësisë ekonomike si dhe Statuti i Trepça SH.A Neni 13 kapitali themeltar dhe pasuria pika 1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10,000€ dhe është i ndarë në 10,000 aksione me vlerë nominale një (1) Euro. Kapitali i Shoqërisë është i derdhur dhe nënshkruar tërësisht si dhe pika 3 të gjitha ndryshimet e kapitalit themeltar, bëhen sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjin Nr. 04/L-006 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, ku përfshihet shuma, parapagimi, raporti me vlerën nominale, rritja e kapitalit themeltar, zvogëlimi i kapitalit themeltar, ndarja e aksioneve, rigrupimi i aksioneve, anulimet që nuk ndryshojnë kapitalin themeltar, riblerja ose revokimi i aksioneve etj. Në bazë nenit 15 pikat 1,2,3, të Statutit të “shoqërisë” saktësohet mënyra e evidentimit dhe transferimit të aksioneve. Po ashtu neni 4 pika 4 e Ligjit për Trepçën përcakton mënyrën e ndarjes së aksioneve të punëtorëve caktohet me akt të veçantë nënligjor.

Ndërmarrja në regjistrat e saj kontabël nuk posedon shënime për: rentën minerare, kapitalin aksionar, humbjet e akumuluar dhe fitimi/humbja e periudhës në nuk ishim në gjendje të verifikojmë saktësinë e këtyre zërave të prezantuar në PFV. Për më tepër vlerën e këtyre zërave e kishin vendosur manualisht në PFV.

Gjithashtu, statuti i ndërmarrjes përcakton se vlera e kapitalit themeltar dhe pasuria është 10,000 aksione me vlerë nominale një (1) € për aksion, që do të thotë 10,000 aksione në vlerë 10,000€, ndërsa në pasqyra financiare vlera e kapitalit aksionar është 596,084,306€. Pra ekziston një diferencë për 596,074,306€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve të menaxhmenteve ndër vite si dhe për shkak të mos funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme.

**Ndikimi**

Mungesa e dëshimve bindëse për kapitalin aksionar ndikon që pasqyrat financiare të prezantojnë gjendjen jo të drejtë dhe të saktë të llogarisë së kapitalit aksionar.

**Rekomandimi B8**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që janë marrë veprime konkrete përmirësuese për të trajtuar çështjen e kapitalit aksionar sipas kërkesave ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B9 - Mos përputhje e vlerës së pasurive në mes regjistrat analitik dhe pasurive të prezantuar në pasqyra financiare****Gjetja**

Sipas SNK 1, paragrafi 15, Pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë drejtë pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të një njësie ekonomike. Paraqitja e drejtë kërkon një përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve të tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet të përcaktuara në Kuadrin konceptual për raportimin financiar.

Ndërmarrja në PFV kishte prezantuar pasuritë afatgjata në vlerë totale 559,729,179€, prej të cilave vlera financiare prej 2,299,388€ i përkasin Njësisë Kopaonik Lepasaviq. Ne kemi identifikuar mospërputhje të rëndësishme në mes të regjistrat analitik të pasurisë dhe pasqyrave financiare. Mangësitë e identifikuar janë si në vijim:

Sipas regjistrat analitik të ndërmarrjes vlera e pasurive është 554,583,588€ (pa përfshirë Njësinë Kopaonik Lepasaviq), ndërsa në pasqyra financiare vjetore vlera e pasurive është 557,429,791€. Pra, ekziston një mospërputhje në raportim të vlerës së pasurisë për 2,846,203€. Pra, ndërmarrja nuk kishte harmonizuar vlerën e pasurive të prezantuara në pasqyrën e pozicionit financiar me regjistrat përkatës.

Përveç mospërputhjeve të cekura më lart janë identifikuar edhe mospërputhje në raportim të pasurive sa i përket regjistrat të pasurive si:

- Në vlerën e pasurive të njësisë të tjera janë përfshirë gabimisht edhe parcelat e Njësisë Kopaonik Lepasaviq në vlerë prej 144,906,894€;
- Vlera e inventarit në shumën 421,994€ nuk është prezantuar në pasqyrat financiare, ndonëse figuron në regjistrat analitik të pasurive;

Përderisa në softuerin e kontabilitetit në përdorim, ndërmarrja kishte arritur të regjistronte vetëm një pjesë të shënimeve në lidhje me parcelat e ndërmarrjes dhe jo kategoritë e tjera të aseteve. Për më tepër, vlera e tokave/parcelave në shumë prej 398,906,894€ është përcaktuar nga ndërmarrja bazuar në vlerësimet zonale të Ministrisë së Financave - Departamenti i Tatimit në Pronë, të përdorura për qëllime tatimore, dhe jo për qëllime të raportimit financiar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme efektive gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare dhe mungesës së një procesi të formalizuar për harmonizimin e të dhënave ndërmjet regjistrave kontabël dhe pasqyrave financiare.

**Ndikimi**

Mospërputhja ndërmjet regjistrat kontabël dhe pasqyrave financiare ndikon në paraqitjen jo të drejtë të pozitës financiare të ndërmarrjes dhe zvogëlon besueshmërinë e informacionit financiar për palët e interesit. Gjithashtu, rrit rrezikun e raportimit të pasaktë të vlerës së pasurive afatgjata.

**Rekomandimi B9**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që para miratimit të pasqyrave financiare vjetore, të kryhet një proces i detajuar i harmonizimit ndërmjet regjistrat analitik të pasurive dhe vlerës së tyre të prezantuar në pasqyrat financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B10 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme tregtare****Gjetja**

Sipas SNK 1 (paragrafët 15,31 dhe 125), pasqyrat financiare duhet të paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme pozicionin financiar të njësisë ekeonomike, duke përfshirë vetëm ato asete që janë realisht të rikuperueshme dhe të mbështetura me evidencë përkatëse. Po ashtu, informacioni shtesë duhet të shpaloset kur është i domosdoshëm për kuptimin e sistuatës financiare. Në përputhje me SNFR 9 (paragrafi 5.5.1), njësia duhet të vlerësojë në vazhdimësi humbjet e pritshme nga kreditimi dhe të njohë provizion për asetet financiare me rrezik real të mospagimit.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2025, kemi identifikuar se në pasqyrën e pozicionit financiar janë përfshirë disa llogari të arkëtueshme të vjetra që nuk përfaqësojnë më asete të rikuperueshme dhe për te cilat mungon provizionimi apo dokumentacioni mbështetës si dhe një llogari e arkëtueshme për te cilen nuk ishin zbritur pagesat e vitit 2025. Rastet janë si në vijim:

Në një rast është vërejtur se ndërmarrja kishte përfshirë si saldo të arkëtueshme shumën 38,199€ nga viti 2015, që buron nga një faturë e kontestuar. Edhe pse ekziston dokumentacioni mbështetës (faturë dhe kontratë), nuk ka prova që është ndërmarrë ndonjë veprim ligjor për arkëtim.

Për vlerë 15,274€ ndërmarrja e kishte përfshirë si saldo të arkëtueshme, mirëpo sipas dëshmive të barazimit me palën është vërejtur se nuk ekzistojnë obligime ndja njëra tjetrës.

Ndërmarrja kishte përfshirë si saldo të arkëtueshme edhe tri raste në vlerë totale prej 42,278€ që datonin që nga viti 2009, pa asnjë dokumentacion mbështetës dhe pa dëshmi për ndonjë përpjekje për arkëtim ligjor në të kaluarën apo në periudhën aktuale.

Në një rast është vërejtur se ndërmarrja kishte përfshirë si saldo të llogarive të arkëtueshme shumën prej 499,165€, e cila daton nga viti 2014 dhe për të cilën mungon kontrata si dhe dokumentacioni tjetër mbështetës. Për më tepër, kjo vlerë është shpalosur në pasqyrat financiare, përkatësisht në Shënimin 6 - "Të arkëtueshmet dhe të tjera", në kategorinë "Provizionet për borxhet e këqija". Këtë vlerë ndërmarrja e kishte paraqitur vetëm si shënim por nuk kishte zbritur llogaritë e arkëtueshme.

Rasti i llogarive të arkëtueshme që nuk ishin zbritur pagesat e realizuar gjatë vitit 2025 kishte të bënte me shpronësimin. Sipas kartelës së klientit për shpronësim, gjendja e llogarive të arkëtueshme reflektonte saktë transaksionet dhe pagesat e realizuara. Megjithatë, gjatë përpilimit të pasqyrave financiare, ndërmarrja kishte marrë për bazë gjendjen përfundimtare të llogarive të arkëtueshme më 31.12.2024 në vlerë prej 1,066,266€, që kishte të bënte me obligimin nga shpronësimi.

Gjatë analizës kemi konstatuar se në vitin paraprak ndërmarrja kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme për 162,839€, si rezultat i zbritjes së dyfishtë të një pagese. Ndërsa gjatë vitit 2025, ndërmarrja nuk kishte zbritur pagesat e pranuar në vlerë prej 653,939€.

Si rezultat i mosaplikimit të pagesave të pranuar gjatë vitit 2025 dhe bartjes së gjendjes së vitit paraprak pa korrigjime, ndërmarrja kishte mbivlerësuar llogaritë e arkëtueshme nga shpronësimi për 491,100€.

Gjithashtu, ndërmarrja gjatë përpilimit të pasqyrave financiare për vitin 2025, saldon e llogarive të arkëtueshme të vitit paraprak, e cila ishte prezantuar në pasqyrat financiare të vitit 2024 në vlerë prej 2,084,404€, e kishte mbivlerësuar për shumën prej 116,588€, duke e prezantuar në vlerë prej 2,200,992€. Kjo vlerë e pasaktë është bartur dhe reflektuar edhe në saldot e vitit 2025.

Vlera e mbivlerësimit të llogarive të arkëtueshme për vitin 2025 është 1,202,606€.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së procedurave efektive për rishikimin periodik të llogarive të arkëtueshme, si dhe mungesës së mbikëqyrjes adekuate nga menaxhmenti në ndjekjen dhe dokumentimin e borxheve të vjetra. Gjithashtu llogaria e arkëtueshme që ndërlidhet me shpronësimin kishte ndodhur për arsye se zyrtarët përgjegjës nuk kishin marrë për bazë gjendjen reale të llogarive të arkëtueshme të vitit 2024 dhe nuk kishin zbritur llogaritë e arkëtueshme për transaksionet që kanë ndodhur gjatë vitit 2025 e që ndërlidhen me obligimet e viteve paraprake. Si rezultat, obligimi ka mbetur i pazbritur në totalin e llogarive të arkëtueshme, duke ndikuar në mbivlerësimin e tyre në pasqyrat financiare.

#### **Ndikimi**

Mosvlerësimi, mos provizionimi i këtyre llogarive dhe mos verifikimi i pagesave që nderlidhet me obligime të viteve të kaluara ka rezultuar në mbivlerësim të aseteve në pasqyrat financiare në vlerë prej 1,202,606€, duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë dhe jo reale të pozicionit financiar të ndërmarrjes.

#### **Rekomandimi B10**

Bordit Mbikëqyrës duhet të forcojë kontrollet e brendshme në regjistrimin dhe verifikimin e lëvizjeve kontabël, duke përfshirë kontroll dhe verifikim periodik të llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, të sigurohet që të gjitha transaksionet të pasqyrohen njëherë dhe në periudhën e duhur, në përputhje me SNK 1, për të siguruar paraqitje të drejtë dhe të besueshme të pasqyrave financiare.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A1 - Mungesa e dokumentacionit mbështetës dhe llogaritja jo e saktë e të hyrave nga shërbimet****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr.06/L-032, neni 11, paragrafi 4 Libri kryesor është regjistër kronologjik kontabël i cili përdoret për të mbajtur gjurmët e transaksioneve financiare. Transaksionet kategorizohen dhe përmbliohen në llogaritë e Librit Kryesor. Llogaria është regjistër i veçantë për secilin lloj të pasurisë, detyrimit, kapitalit, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe zërave jashtë bilancit të gjendjes. Llogaritë e librit përfshijnë të gjitha llogaritë e planit kontabël të njësisë ekonomike, si dhe paragrafi 5 Dokumentacioni përkatës për librin kryesor përbëhet nga 5.1,5.2,5.3 dhe 5.4.

Sipas marrëveshjes mbi vendosjen e zyrës së brendshme doganore në hapësirën e Trepça sh.a Mitrovicë, kapitulli II Tarfia (Taksa) pika 2.1 Trepçës, përmes kësaj marrëveshje i lejohet vjelja (arkëtimi) e pagesës nga qarkullimi dhe bujtja e automjeteve (maunave) në zyrën e mbledhjes së taksave dhe objektet përcjellëse në ZBD të Mitrovicës, në vendin "Parku Industrial Mitrovicë", për mallrat të cilat i nënshtrohen procedurave doganore të zhdoganimit të mallrave. dhe pika 2.2 Lartësia e tarifës (taksës) nga pika 2.1 e kësaj marrëveshje do të caktohet sipas kësaj marrëveshje dhe nuk mund të jetë më e lartë se 5€ për qëndrim 24 orësh.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se ndërmarrja kishte prezantuar të hyrat nga qiraja 602,670€ ndërsa në Librin Kryesor kishte raportuar 846,242€. Pra ekziston një diferencë prej 243,572€ për të cilën ndërmarrja nuk kishte ofruar dëshmi mbështetëse.

Për më shumë, nga analiza e kryer është konstatuar se të gjitha faturat e qirasë, të cilat në Librin e Shitjes ishin regjistruar si fatura individuale në vlerë prej 602,682€, në Librin Kryesor ishin grumbulluar si një transaksion i vetëm në konton "Të hyrat nga qiraja" në vlerë prej 846,242€.

Po ashtu, kemi identifikuar se për të hyrat nga shërbimet ndërmarrja nuk kishte realizuar të hyrat sipas marrëveshjes. Në një rast kemi identifikuar se koha e qëndrimit të automjetit ishte nga data 30.09.2023 deri më 26.06.2025 që rezulton se automjeti kishte qëndruar 634 ditë në terminalin doganor të Trepça sh.a. Faturimi ishte bërë për vetëm për 268 ditë në shumë 1,340€ ndërsa në bazë të qëndrimit total do duhej të bëhej për 634 ditë në vlerë 3,170€. Pra ndërmarrja nuk ka faturuar vlerën prej 1,830€ dhe rrjedhimisht as nuk e ka arkëtuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak se libri kryesor dhe bilanci vërtetues janë në proces të harmonizimit si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve adekuate mbi regjistrimet në librin kryesor dhe mosverifikimit të transaksioneve të bartura nga libri i shitjes. Përderisa llogaritja e gabuar për të hyrat nga shërbimet kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në menaxhimin e terminalit doganor si dhe mungesa e verifikimit të saktë për hyrjen dhe daljen para lëshimit të faturës dhe arkëtitimit të mjeteve.

**Ndikimi** Mos harmonizimi i librit kryesor me librin e shitjes krijon pasaktësi dhe gabime të vazhdueshme edhe për periudhat e ardhshme, gjë që ndikon negativisht në raportimin e saktë të PFV-ve. Gjithashtu, sa i përket regjistrimit të të hyrave nga shërbimet, mos-kalkulimi i saktë i kohëqëndrimit të automjeteve sipas hyrje-daljeve reale krijon hapësirë për lëshime, të cilat ndikojnë drejtëpërdrejt në performancën financiare dhe në uljen e të hyrave të ndërmarrjes.

**Rekomandimi A1** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që ndërmarrja të forcojë kontrollet mbi regjistrimet në librin kryesor dhe bartjen e të dhënave nga libri i shitjes, në mënyrë që faturat e qirasë të regjistrohen me detaje të plota dhe të mundësohet verifikimi i secilit transaksion individual në evidencat kontabël.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B11 - Mos përjashtimi i transaksioneve brenda njësive gjatë konsolidimit financiar**

**Gjetja** Sipas IFRS 10 - Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, paragrafi B&6(c), gjatë përgaditjes së pasqyrave të konsoliduara, entiteti duhet të eliminojë plotësisht aktivet dhe detyrimet, kapitalin, të ardhurat, shpenzimet dhe rrjedhat monetare që rrjedhin nga trasaksionet ndërmjet njësive brenda grupit. Kjo kërkesë synon të sigurojë që pasqyrat e konsoliduara të paraqesin një pasqyrë të drejtë të pozitës financiare dhe performancës së grupit si një entitet i vetëm ekonomik.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të konsoliduara të ndërmarrjes për vitin 2025, identifikua se në procesin e inifikimit të të dhënave të njësive biznesore, është përfshirë edhe vlera 780,472€ si llogari e arkëtueshme që njësia "Minera me Flotacion Kopaonik - Leposaviç" (FI 804/89) ka raportuar ndaj Trepëa sh.a. Kjo shumë është përfshirë në pasqyrat e konsoliduara në zërin "Llogaritë e arkëtueshme tjera", duke e mbivlerësuar këtë zë.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së një procesi të qartë dhe efektiv për eliminimin e transaksioneve në mes të njësive gjatë përgaditjes së pasqyrave të konsoliduara financiare.

**Ndikimi** Mos eliminimi i kësaj vlere, e cila përfaqëson një transaksion ndërnjësie brenda të njëjtit entitet ekonomik, kishte rezultuar në mbivlerësim të zërit "llogaritë e arkëtueshme tjera" në pasqyrat financiare të konsoliduara në vlerë prej 780,472€, duke ndikuar negativisht në besueshmërinë dhe saktësinë e informacionit financiar të prezantuar.

**Rekomandimi B11** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që gjatë procesit të konsolidimit të pasqyrave financiare, të aplikohen në mënyrë rigoroze kërkesat e IFRS 10, duke eliminuar të gjitha transaksionet dhe bilancet ndërmjet njësive të të njëjtit entitet. Kjo do të ndihmojë në përgatitjen e pasqyrave që reflektojnë drejt gjendjen reale financiare të ndërmarrjes.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A2 - Regjistrim i gabuar i investimeve kapitale si shpenzime operative****Gjetja**

Sipas (SNK 38 - Pasuritë Jo-materiale) paragrafit 13: Njësia ekonomike kontrollon një aktiv nëqoftëse ka zotësinë për të marrë përfitimet ekonomike në të ardhmen që rrjedhin nga burimi i dhënë dhe të kufizojë hyrjen e të tjerëve tek këto përfitime, ndërsa sipas Paragrafit 21: Një aktiv jo-material njihet nëqoftëse, e vetëm nëqoftëse:

(a) është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe

(b) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri. Sipas SNK 16 - Pasuritë materiale: Paragrafit 7, Kosto e një zëri të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) do të njihet si aktiv nëse dhe vetëm nëse: (a) është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij aktivi do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe (b) kosto e aktivit mund të matet me besueshmëri.

Ndërmarrja gjatë vitit 2025 kishte bërë furnizime të ndryshme përmes kontratave publike si: furnizimi me aplikacion për nevojat e Trepça Sh.a në vlerë 9,208€, furnizim me aparate për frymëmarrje me qark të mbyllur vlerë 119,829€ dhe furnizim me hidro pompe vlerë 11,378€. Këto furnizime ishin regjistruar si shpenzime operative në vend që të regjistrohen si investime kapitale

Edhe pse këto furnizime janë regjistruar si shpenzime në regjistrat kontabël, menaxhmenti ka mbajtur manualisht një regjistër të aseteve, ku këto tri investime janë paraqitur si asete dhe për to është njohur zhvlerësim në vlerë totale prej 23,578€.

Ky regjistrim ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve efektive në departamentin e financave lidhur me trajtimin kontabël të investimeve.

**Ndikimi**

Regjistrimi i këtyre furnizimeve si shpenzime operative të tyre ka rezultuar në mbivlerësim të shpenzimeve operative, duke ndikuar në paraqitjen jo të saktë të rezultatit financiar dhe të gjendjes financiare të ndërmarrjes.

**Rekomandimi A2**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve efektive për regjistrimin e saktë të transaksioneve financiare, të sigurojë që investimet kapitale të identifikohen dhe regjistrohen si pasuri në përputhje me standardet e kontabilitetit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A3 - Mbivlerësim i të hyrave nga shitja si pasojë e mosregjistrimit të faturave finale****Gjetja**

Sipas SNRF 15 Të ardhurat me kontratat me klientët , konkretisht Ndryshimet në çmimin e transaksionit paragrafi 87 Pas momentit të krijimit të kontratës, çmimi i transaksionit mund të ndryshojë për arsye të ndryshme për fshirë zgjidhjen e disa ngjarjeve të pasigurta ose ndryshime në rrethana të cilat ndryshojnë shumën korresponduese që njësia ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të mallrave apo shërbimeve të premtuara dhe paragrafit 88 Njësia ekonomike duhet të shpërndajë tek kushtet e performancës në kontratë çdo ndryshim pasues në çmimin e transaksionit mbi të njëjtat baza shpërndarjeje si në momentin e krijimit të kontratës. Për pasojë, njësia ekonomike nuk duhet të rishpërndajë çmimin e transaksionit për të pasqyruar ndryshimet në çmimet specifike të shitjes pas momentit të krijimit të kontratës. Shumat e shpërndara për të plotësuar kushtin e performancës duhet të njihen si të ardhura ose si një pakësim i të ardhurave në periudhën në të cilën ndryshon çmimi i transaksionit.

Sipas Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH Nenit 54 Deklarata e Tvsh-së, dorëzimi dhe pagesa paragrafi 1 Një person i tatueshëm duhet të dorëzojë një deklaratë tatimore dhe të bëjë pagesën përkatëse më së voni deri në datën 20 të muajit kalendarik që pason pas fundit të secilës periudhë tatimore. Deklarata Tatimore duhet të përmbajë: 1.1 shumën e të gjitha furnizimeve të tatueshme dhe të liruara, eksportimeve dhe furnizimeve të trajtuara si eksporte, si dhe obligimin e tatimit të llogaritur në furnizimet e tatueshme të bëra nga ai gjatë periudhës; dhe paragrafit 1.4. çdo ngritje dhe zbritje në lidhje me shumën e përmendur në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3., të paragrafit 1 të këtij neni para se rezultati i çdo rregullimi të shumës së tatueshme duke u bazuar në notë debiti dhe notë krediti,

Gjatë vitit 2025, Ndërmarrja Trepça nuk kishte kryer regjistrimet e nevojshme kontabël që rrjedhin nga kontrata e shitjes me koncentrat, sipas kushteve Ex Works (EXW - Incoterms 2020). Sipas kontratës, ndërmarrja fillimisht lëshon një profaturë bazuar në vlerësimin preliminar të koncentratit, ndërsa blerësi obligohet të paguajë 95% të vlerës së vlerësuar. Pas pagesës dhe doganimit të mallit, pronësia kalon te blerësi. Në fazën finale, pas matjeve përfundimtare nga blerësi, lëshohet fatura finale, e cila mund të rezultojë me ndryshim të vlerës fillestare të faturimit.

Megjithatë, ndërmarrja kishte regjistruar vetëm Dokumentin Unik Doganor (DUD), pa reflektuar ndryshimet që rrjedhin nga faturat finale përmes debit notës apo kredit notës. Si rezultat, gjendja reale e shitjeve sipas faturave finale nuk ishte pasqyruar në regjistrat kontabël.

Ndërmarrja në PFV kishte raportuar të hyra nga shitja e koncentratit në shumën prej 11,950,648€. Nga testimet tona në dy raste, kemi identifikuar se shitjet ishin regjistruar sipas DUD-it në vlerë prej 88,947€ dhe 560,794€. Për të dy rastet ishin lëshuar faturat finale, ku vlera përfundimtare e shitjeve kishte rezultuar 84,671€ dhe 506,021€. Megjithatë, ndërmarrja nuk kishte kryer regjistrimet korigjuese sipas faturave finale, përkatësisht nuk kishte zvogëluar shitjet për diferencën prej 4,276€ në rastin e parë dhe 54,773€ në rastin e dytë. Si rezultat, shitjet janë mbivlerësuar për gjithsej 59,049€.

Mosregjistrimi i notave të kreditit në librat e shitjes dhe në kontabilitet ka ndodhur si rezultat i mungesës së procedurave të qarta dhe të standardizuara për trajtimin e dokumenteve korigjuese pas faturimit, si dhe mungesës së kontrollit të brendshëm për verifikimin e regjistrimit të tyre në evidencat përkatëse.

Gjithashtu, nuk është siguruar ndërlidhja sistematike ndërmjet procesit të faturimit, kontabilitetit dhe raportimit tatimor, duke rezultuar në mosreflektim të plotë të korigjimeve në regjistrimet zyrtare.

#### **Ndikimi**

Mos regjistrimi i notave të kreditit apo debitit dhe mosreflektimi i tyre në librat e shitjes dhe në evidencat kontabël ka rezultuar në paraqitje të pasaktë të të ardhurave nga shitjet e realizuara gjatë vitit 2025. Si pasojë, shitjet bruto janë mbivlerësuar, duke mos reflektuar korrektësisht korigjimet pas faturimit.

#### **Rekomandimi A3**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë regjistrimin e plotë dhe të saktë të të gjitha notave të kreditit apo debitit në momentin e lëshimit të tyre, duke i reflektuar ato në mënyrë të menjëhershme në librat e shitjes dhe në evidencat kontabël përkatëse.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A4 - Trajtimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme të bartura nga vitet e kaluara dhe nënvlersim i llogarive të arkëtueshme**

##### **Gjetja**

Sipas SNK 8 - politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet paragrafi 41 Gabimet ndodhin në lidhje me njohjen, matjen, paraqitjen ose dhënien e informacioneve shpjeguese të elementëve të pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare nuk janë në pajtim me SNRF-të në se ato përmbajnë ose gabime materiale ose gabime jo materiale të bëra qëllimisht për të arritur një paraqitje të veçantë të gjendjes financiare, rezultatit financiar ose flukseve të parasë së njësisë ekonomike. Gabimet e mundshme të periudhës aktuale të zbuluara në këtë periudhë korigjohen para se pasqyrat financiare të autorizohen për publikim. Por gabimet materiale ndonjëherë mbeten të pazbuluara deri në periudhat e mëpasshme dhe këto gabime të periudhave paraardhëse korigjohen në informacionin krahasues të paraqitur në pasqyrat financiare për periudhat e mëpasshme (shih paragrafët 42-47).

Sipas ligjit mbi tatimin mbi vlerën e shtuar Nr.05/L-037 neni 22, paragrafi 1 Momenti i lindjes së detyrimit ndodhë dhe TVSH-ja bëhet e ngrakueshme kur bëhet furnizimi i mallrave dhe shërbimeve si dhe paragrafi 2.2 furnizimi i vazhdueshëm i mallrave dhe shërbimeve gjatë një periudhe kohore duhet të konsiderohet se është përfunduar në intervalet prej një (1)muaji.

Sipas SNK 1 - Paraqitja e Pasyrave Financiare, paragrafi 15, pasqyrat financiare duhet të pasqyrojnë me drejtësi pozitën financiare, performancën dhe flukset monetare të një njësie ekonomike. Kjo kërkon përfaqësim të besueshëm të efekteve të transaksioneve në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet dhe detyrimet, sipas Kuadrit Konceptual për raportim financiar.

Nga analiza e mostrave kemi konstatuar se ndërmarrja nuk kishte trajtuar

në mënyrë të drejtë obligimet e bartura nga vitet paraprake në regjistrat kontabël dhe kartelat e klientëve dhe njëkohësisht kishte nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme për një rast tjetër. Rastet e identifikuar janë si në vijim:

- Në rastin e parë klienti me të cilin ndërmarrja kishte lidhur kontratë mbi qeranë me datë 30.01.2025 me nr. protokoli 671 ku pjesë e kontratës ishte edhe një borxh i viteve të kaluar e cila specifikohet në nenin 4 - Borxhi janar 2022 deri fund të janarit 2025 që vlera e borxhit për këtë periudhë ishte 125,848€, dhe që ndërmarrja në bazë të këtij nenin ka specifikuar që ky borxh do të paguhet për një periudhë prej 24 muaj, në vazhdim është cekur që ky borxh do të faturohet në mënyrë të rregullt në vlerë mujore prej 4,844€. Ndermarrja në emer të borxhit të vjetër gjatë vitit 2025 kishte regjistruar 11 fatura në vlerë totale 53,281€ si shitje të vitit aktual, duke mos regjistruar borxhin e plotë të bartur nga vitet paraprake ashtu siq kërkohet me SNK8. Si rezultat, borxhi në vlerë prej 72,567€ kishte mbetur i paregjistruar. Për pasojë, shitjet e vitit 2025 janë mbivlerësuar për 53,281€, ndërsa llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar për 72,567€.
- Në mënyrë të njëjtë ndërmarrja kishte vepruar edhe për një klientë tjetër me të cilin po ashtu kishte lidhur kontratë me datë 24.02.2025 me nr. protokoli 1196 ku pjesë e kontratës ishte po ashtu një borxh i vjetër i specifikuar në nenin 4 - borxhi 01 shkurt deri fund të 28 shkurt 2025, vlera totale për këtë borxh është 87,688€, ku ndërmarrja në bazë të këtij neni ka specifikuar që ky borxh do të paguhet për 36 muaj, duke u faturuar në mënyrë të rregullt në vlerë 2,250€. Ndërmarrja në emër të borxhit të vjetër kishte regjistruar 10 fatura në vlerë prej 22,500€ si shitje të vitit 2025, pa e bartur borxhin si gjendje fillestare të llogarive të arkëtueshme ashtu siq kërkohet me SNK8. Si rezultat, shitjet e vitit 2025 janë mbivlerësuar për 22,500€, ndërsa llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar për 65,188€.
- Në një rast tjetër ndërmarrja kishte regjistruar dy fatura në vlerë prej 293,137€ për shitjen e koncentratit, ndërsa në PFV për këtë klientë kishte raportuar si llogari të arkëtueshme zero. Ne kemi identifikuar se ndërmarrja nuk kishte raportuar saktë gjendjen e llogarive të arkëtueshme për faktin se gjatë vitit 2025 për shitjet e tilla kishte pranuar mjete në vlerë 278,719€. Pra nënvlersimi i llogarive të arkëtueshme është 14,419€

Si rrjedhojë e mosbartjes së saktë të gjendjeve fillestare dhe regjistrimit jo të duhur të borxheve të viteve të kaluara, ndërmarrja nuk ka prezantuar drejt llogaritë e arkëtueshme dhe të hyrat nga shitjet, në përputhje me standardet kontabël dhe kërkesat e raportimit financiar.

Për më tepër, ndërmarrja për dy rastet e para nuk kishte zbatuar thyerjen e borxhit në përputhje me urdhëresat financiare dhe miratimet e komisionit të Trepça Sh.A sipas kërkesës së nenit 4 ne kontratat e qerasë.

Trajtim jo i duhur i faturimit retrospektiv në vitin aktual ka rezultuar në mbivlerësim të shitjeve për vitin 2025, duke mos prezantuar në mënyrë të drejtë gjendjen reale financiare të ndërmarrjes. Njëkohësisht, kjo praktikë përbën keqdeklarim në aspektin tatimor dhe nuk është në përputhje me Nenin 22 të Ligjit Nr. 05/L-037 për TVSH-në, pasi detyrimi tatimor nuk është deklaruar në periudhën kur është kryer shërbimi, respektivisht muaj për muaj në vitet përkatëse.

Si rezultat, është shtyrë deklarimi i detyrimeve tatimore, duke ndikuar potencialisht në dëmtimin e buxhetit të shtetit. Për më tepër, një kontroll eventual nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) mund të rezultojë me korrigjime retroaktive të deklaratave tatimore, si dhe me vendosjen e gjobave, ndëshkimeve dhe interesit ligjor për mosdeklarim me kohë të obligimeve tatimore.

Kjo kishte ndodhur për shkak të trajtimit jo të duhur sipas standardeve dhe mangesive se si janë trajtuar borxhet e viteve të kaluara në kontratë. Gjithashtu mungesa e verifikimit për borxhe ndaj klienteve kishte shkaktuar nënvlersim të llogarive të arkëtueshme.

#### **Ndikimi**

Si rezultat i trajtimit jo të duhur kontabël të borxheve të bartura nga vitet paraprake, ndërmarrja ka mbivlerësuar të hyrat/shitjet e vitit 2025 dhe njëkohësisht ka nënvlerësuar llogaritë e arkëtueshme. Për më tepër edhe mos verifikimi i rregullt i llogarive të arkëtueshme ka ndikuar në nënvlersimin e llogarive të arkëtueshme.

#### **Rekomandimi A4**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë forcimin e kontroleve lidhur me bartjen dhe harmonizimin e gjendjeve fillestare të llogarive të arkëtueshme, si dhe trajtimin e drejtë kontabël të obligimeve të bartura nga vitet paraprake. Ndërmarrja duhet të sigurojë që obligimet e viteve të kaluara të regjistrohen si saldo fillestare të llogarive të arkëtueshme dhe të mos trajtohen si të hyra të vitit aktual, në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë drejt dhe saktë gjendjen financiare në përputhje me standardet kontabël dhe legjislacionin tatimor në fuqi. Gjithëashtu duhet të kryhen verifikime periodike me klientë në mënyrë që PFV të përmbajnë shenime të verteta dhe konform standardeve.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B12 - Mangësi në njohjen e shpenzimeve**

##### **Gjetja**

Korniza konceptuale specifikon se në mënyrë që të plotësojnë objektivat e tyre, pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Sipas kësaj baze, efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të tjera njihen kur ato ndodhin (dhe jo kur mjetet monetare ose ekuivalentët e tyre janë arkëtuar ose paguar) dhe ato regjistrohen në regjistrat kontabël dhe raportohen në pasqyrat financiare të periudhave me të cilat ato lidhen.

Gjatë auditimit kemi identifikuar që ndërmarrja nuk kishte regjistruar në tre raste shpenzimet sipas parimit akrual, rastet janë si në vijim:

- Ndërmarrja gjatë vitit 2025 kishte regjistruar shpenzime në shumën prej 140,000 €, në bazë të pagesave/daljeve nga banka, ndërsa sipas dëshmive kemi vërejtur se obligimi rrjedh nga viti 2017. Si rrjedhojë, shpenzimi dhe detyrimi nuk janë njohur në periudhën kur ka lindur obligimi, por vetëm në momentin e pagesës;
- Një faturë në vlerë prej 119,892€ (me TVSH), ishte pranuar dhe protokolluar në prill 2024, është regjistruar në sistemin kontabël në mars 2025, duke rezultuar në njohje të vonuar të shpenzimit dhe në mosrespektim të parimit të ndarjes së shpenzimeve sipas periudhave raportuese;
- Shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit për muajin dhjetor 2025, në vlerë totale prej 380,516€ (shpenzime të rrymës 370,048€ dhe shpenzime të ujit 10,467€), megjithëse i përkisnin periudhës raportuese të vitit 2025, janë regjistruar në regjistrat kontabël gjatë muajit janar 2026;

Vlen të theksohet se gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, ndërmarrja ka prezantuar si shpenzime akruale vetëm shpenzimet e energjisë elektrike në vlerë prej 370,048€, ndërsa shpenzimet e ujit nuk janë përfshirë në PFV, duke rezultuar në nënvlerësim të shpenzimeve dhe detyrimeve të periudhës raportuese.

Kjo ka ndodhur pasi nuk është zbatuar me kujdes parimi akrual, si dhe mungesa e kujdesit në identifikimin dhe regjistrimin në kohë të shpenzimeve në periudhën përkatëse kontabël.

#### **Ndikimi**

Kjo ka ndodhur për shkak të moszbatimit të parimit akrual dhe mosregjistrimit në kohë të shpenzimeve për periudhën përkatëse kontabël.

#### **Rekomandimi B12**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që të bëhet regjistrimi i transaksioneve në kontabilitet duke u bazuar në parimin akrual, në mënyrë që të gjitha shpenzimet të regjistrohen në periudhën përkatëse

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B13 - Mungesa e dëshmive për grantet**

##### **Gjetja**

SNK 20 përcakton se Grantet qeveritare që lidhen me pasuritë, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, duhet të paraqiten në pasqyrë e pozicionit financiar ose duke njohur grantin si të ardhur të shtyrë- detyrime ndaj grantit ose duke zbritur grantin që merret nga vlera e bartur e pasurisë. Për më tepër, grantet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet zhvlerësimi për ato mjete.

Ndërmarrja në pasqyrën e pozicionit financiar tek detyrimet afatgjata kishte prezantuar detyrimet ndaj granteve në vlerë 3,071,409€. Ne kemi kërkuar dëshmitë përkatëse por ndërmarrja nuk kishte arritur të na ofrojë dëshmitë e tilla dhe si rrjedhojë e kësaj nuk kemi mundur të vërtetojmë vlerën e prezantuar.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së data bazës së shënimeve për pasuritë të cilat janë të financuara nga grantet.

- Ndikimi** Prezantimi i granteve pa pasur dëshmi mbështetëse, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e granteve, investimeve në vijim dhe të hyrave të njohura nga grantet.
- Rekomandimi B13** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë krijimin e një regjistri të plotë me dëshmi relevante me rastin e regjistrimit të detyrimeve ndaj granteve me qëllim që prezantimi në pasqyra financiare të jetë i plotë dhe i saktë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B14 - Përfshirja e pasaktë e parapagimeve të klientëve në analitikën e llogarive të arkëtueshme**

- Gjetja** Sipas SNK1 (par. 32 dhe 54), aktivet dhe detyrimet duhet të paraqiten ndaras dhe nuk duhet të kompensohen me njëra-tjetrën, përveç kur kjo lejohet nga një standard tjetër.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare, kemi identifikuar se në saldo e llogarive të arkëtueshme vazhdojnë të jenë të përfshira vlera negative në shumën prej 456,745 €, të cilat në substancë përfaqësojnë parapagime të pranuar nga klientët dhe jo llogari të arkëtueshme. Kjo çështje ishte raportuar edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak, megjithatë ndërmarrja nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme për analizimin, rakordimin dhe riklasifikimin e këtyre saldove.

Për më tepër, gjendja e llogarive të arkëtueshme me datë 31 dhjetor 2024 është bartur në vitin 2025 pa u bërë ndarja e duhur midis llogarive të arkëtueshme dhe parapagimeve, si dhe pa u reflektuar transaksionet e realizuara gjatë vitit 2025 që lidhen me shlyerjen ose përdorimin e këtyre saldove. Si rrjedhojë, parapagimet kanë mbetur të paidentifikuara dhe të klasifikuara në mënyrë jo të duhur edhe në periudhën aktuale raportuese.

Gjithashtu, në pasqyrat financiare parapagimet janë prezantuar si një zë i veçantë në kuadër të detyrimeve afatshkurtra në vlerë prej 374,106€, duke mos përfshirë tërë shumën e parapagimeve prej 456,745€. Rrjedhimisht, është evidentuar një diferencë prej 82,639€ ndërmjet gjendjes së parapagimeve të identifikuar dhe vlerës së prezantuar në pasqyrat financiare.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i klasifikimit jo të duhur të transaksioneve kontabël, përkatësisht mungesës së dallimit të qartë ndërmjet parapagimeve të klientëve dhe llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, ka munguar kontrolli dhe rishikimi i rregullt i analitikave, duke çuar në përfshirjen e gabuar të këtyre zërave.

**Ndikimi** Klasifikimi i gabuar i parapagimeve të klientëve në kuadër të llogarive të arkëtueshme ka rezultuar në paraqitje jo të saktë të këtyre zërave në pasqyrat financiare. Për shkak të përfshirjes së shumave me shenjë negative (parapagimeve), llogaritë e arkëtueshme janë nënvlerësuar, ndërsa detyrimet ndaj klientëve nuk janë paraqitur në mënyrë të duhur. Si rrjedhojë, pozicioni financiar i ndërmarrjes është pasqyruar në mënyrë jo reale dhe jo të besueshme.

**Rekomandimi B14** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që menaxhmenti të përmirësojë kontrollet mbi ndarjen dhe klasifikimin e të dhënave analitike, duke eliminuar përfshirjen e parapagimeve në analitikën e llogarive të arkëtueshme dhe duke garantuar përputhshmëri të plotë me standardet përkatëse kontabël.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B15 - Mos përputhje e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël me gjendjen e obligimeve në ATK**

**Gjetja** Sipas Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12.1, kërkohet që Shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Neni 2 Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratura nga organi drejtues i shoqërisë tregtare. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Ndërmarrja në PFV kishte raportuar obligimet ndaj tatimit në burim 5,929,813€ ndërsa sipas gjendjes nga ATK obligimet e tilla ishin 5,967,038€, pra obligimet ishin të nënvlerësuar në pasqyrat financiare për vitin 2025 për 37,225€.

Ndërsa obligimet ndaj kontributeve pensionale në PFV ishin raportuar 9,425,275€ kurse sipas ATK-së ishin 9,373,660€ pra, ekziston një mbivlerësim për 51,615€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të obligimeve tatimore të ndërmarrjes me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK.

**Ndikimi** Mos barazimi periodik i detyrimeve ka ndikuar që prezantimi i obligimeve tatimore të mos është i saktë në pasqyrat financiare vjetore duke i nënvlerësuar/mbivlerësuar obligimet afatshkurtra të ndërmarrjes dhe kjo reflekton me pasqyrim të gjendjes jo reale (çorientuese) të pozicionit financiar të ndërmarrjes.

**Rekomandimi B15** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që obligimet tatimore të ndërmarrjes të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK dhe të prezantohen saktë në pasqyrat financiare vjetore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B16 - Mos harmonizimi i detyrimeve afatshkurtra ndërmjet shënimeve kontabël dhe PFV****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet raportim financiar dhe auditim Neni 11 regjistrat kontabël dhe librat e llogarive pika 4 libri kryesor është regjistër kronologjik kontabël i cili përdoret për të mbajtur gjurmët e transaksioneve financiare. Transaksionet kategorizohen dhe përmbledhen në llogaritë e Librit Kryesor. Llogaria është regjistër i veçantë për secilin lloj të pasurive, detyrimeve, kapitalit, të ardhurave dhe shpenzimeve dhe zërave jashtë bilancit të gjendjes. Llogaritë e librit kryesor përfshijnë të gjitha llogaritë e planit kontabël të njësisë ekonomike.

Po ashtu, neni 12, kërkon që Shoqëritë tregtare, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Po ashtu ndër tjera, neni 2, përcakton se inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Ndërmarrja në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në kuadër të detyrimeve afatshkurtra, ka prezantuar interes të pagueshëm për rentën minerare në vlerë prej 5,183,571€, ndërsa sipas evidencave kontabël (kartelave të llogarive) ky detyrim figuron në vlerë prej 1,607,269€, duke rezultuar në një mospërputhje prej 3,576,302€ ndërmjet vlerave të prezantuara në pasqyrat financiare dhe shënimeve kontabël.

Për më tepër, janë identifikuar mospërputhje të theksuara sa i përket llogarive të pagueshme si në vijim:

Në PFV ndërmarrja kishte prezantuar llogari të pagueshme në vlerë 7,165,910€ për njësinë e Trepçës-Jug, ndërsa sipas regjistrat të brendshëm gjendja e LLP-ve është në vlerë prej 7,752,197€, duke rezultuar në një diferencë prej 586,287€ ndërmjet evidencave kontabël dhe pasqyrave financiare;

Për verifikimin e saktësisë dhe plotësisë së llogarive të pagueshme janë dërguar 19 letër konfirmime tek operatorët ekonomikë dhe janë pranuar 11 prej tyre (10 nga njësia jug dhe 1 nga njësia veri). Në njësinë jug, sipas dëshmime të siguruara, në tetë raste janë identifikuar mospërputhje të llogarive të pagueshme. Në katër raste vlera financiare për 175,826€ është raportuar më e lartë në kartelat kontabël krahasuar me letër konfirmimet, ndërsa në 4 raste të tjera vlera financiare për 68,595€ është raportuar më e ulët krahasuar me letër konfirmimet e pranuar.

Gjithashtu në një rast, saldoja në vlerë prej 118,029€, e paraqitur në kartelën kontabël si detyrim ndaj një operatori ekonomik, përfaqëson një borxh të bartur nga viti 2009, për të cilin ndërmarrja nuk ka ofruar dokumentacion apo dëshmi mbështetëse që vërtetojnë bazën, vlefshmërinë ose ekzistencën e detyrimit.

Sa i përket Njësisë Kopaonik-Leposaviç, për katër operatorë ekonomikë që nuk janë pranuar letër konfirmime. Sipas evidencave kontabël, këto saldo përfaqësojnë detyrime të vjetra në vlerë totale prej 4,803,981€, ndërsa zyrtarët përgjegjës kanë deklaruar se nuk mund të ofrojnë dëshmi, pasi disa operatorë e kanë mbyllur aktivitetin, ndërsa disa të tjerë janë larguar nga Kosova.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mos harmonizimit të gjendjeve me klientë në baza periodike.

**Ndikimi**

Mos harmonizimi periodik me klientët kishte ndikuar në prezantimin e pasaktë të gjendjes së obligimeve të ndërmarrjes në pasqyra financiare vjetore. Po ashtu, prezantimi i një shume në pasqyrat financiare pa evidencë kontabël përkatëse cenon besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare. Kjo krijon rrezik për pasqyrim të pasaktë të pozitës financiare të ndërmarrjes, si dhe mund të ndikojë në vendimmarrjen e palëve të interesit.

**Rekomandimi B16**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që janë bërë harmonizimet periodike të llogarive me klientët dhe gjithashtu të rishqyrtoj regjistrin e obligimeve në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë sa më saktë dhe drejt gjendjen e ndërmarrjes.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A5 - Mungesë e dëshmisë së regjistrimit sipas kërkesës së Ligjit të Prokurimit Publik

#### Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, neni 66 paragrafi 1. Kur një operator ekonomik që kërkon të merr pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në përmbushjen e kontratës publike duhet të regjistrohet në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në mënyrë që të zbatohet aktivitetet për të cilat një regjistrim i tillë kërkohet, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatori ekonomik që të paraqesë dokumentin e lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend.

Po ashtu sipas nenit 4 pika 7 e Ligjit Nr.08/L-257 Për Administrimin e Procedurave Tatimore Çdo person jo-rezident i cili sipas legjislacionit tatimor në Republikën e Kosovës nuk kërkohet të regjistrojë biznes në Republikën e Kosovës, por i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Republikën e Kosovës në pajtim me legjislacionin tatimor të Republikës së Kosovës, me përjashtim të rasteve kur u mbahet tatimi në burim për jo rezident dhe transaksioni i nënshtrohet ngarkesës së kundërt nga kompania rezidente e Republikës së Kosovës, cakton një përfaqësues fiskal përpara se të fillojë ndonjë veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës. Përfaqësuesi fiskal regjistrohet në ATK brenda pesë (5) ditëve pasi të jetë emëruar. Forma e regjistrimit dhe procedurat e regjistrimit përcaktohen me akt nënligjor.

Në procedurën e prokurimit me numër 12054-25-9007-1-3-6, me titull “Furnizimi i pjesëve për mirëmbajtjen e rregullt të kompresorëve GA 200 dhe GA 250 në minierën Belo Brdo”, operatori ekonomik i shpallur fitues ka dorëzuar certifikatën e biznesit, numrin fiskal dhe dëshminë për TVSH të vendit të themelimit. Megjithatë, nuk është ofruar dëshmi specifike që operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin profesional, komercial dhe/apo në regjistrin e ndërmarrjeve për ushtrimin e aktivitetit përkatës, siç kërkohet nga dispozitat ligjore në fuqi.

Kjo ka ndodhur pasi Komisioni i Vlerësimit nuk i ka kushtuar kujdes të veçantë dhe të mjaftueshëm shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik, duke mos verifikuar plotësisht përmbushjen e kërkesave të nenit 66 të LPP-së.

#### Ndikimi

Kjo mangësi ul sigurinë që operatori i plotëson kushtet ligjore për kualifikim dhe rrit rrezikun që të pranohet një operator pa i përmbushur të gjitha kërkesat. Kjo ndikon negativisht në transparencën, barazinë dhe rregullsinë e procesit të prokurimit.

**Rekomandimi A5** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që në të gjitha procedurat e prokurimit të kërkohen dhe të verifikohen në mënyrë të plotë dëshmitë për regjistrimin profesional, komercial dhe/apo në regjistrin e ndërmarrjeve, në përputhje me ligjet në fuqi. Po ashtu, duhet të përmirësohen kontrollat gjatë fazës së vlerësimit të ofertave për të shmangur pranimin e operatorëve që nuk i përmbushin plotësisht kërkesat ligjore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A6 - Pranimi i softuerit pa verifikimin e përmbushjes së specifikave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe kontratë**

**Gjetja** Sipas kontratës: Kontratë publike kornizë T-002/25, Furnizim me aplikacion për nevojat e Trepça sh.a, në vazhdim Ankesi 1. Specifikimet teknike të detyrueshme, Moduli i shitjes, pika 8 dhe 10: Lëvizjet interne në mes depos dhe Dalja e artikullit nga depo të ketë mundësin e lidhjes me qendrën e kostos: shpenzim, prodhim, investim, shitje, shërbim etj

Në kontratën “Furnizimi dhe Mirëmbajtja e Aplikacionit për nevojat e Trepça sh.a.”, si dhe specifikimeve teknike të detyrueshme janë parapar të gjitha modulet në sistemin për menaxhimin e proceseve të prodhimit dhe financave.

Ne kemi vërejtur se sipas kontratës moduli i shitjeve dhe menaxhimit të stoqeve është dashur të mundësojë lëvizjen interne ndërmjet depove, si dhe daljen e artikujve nga depoja me mundësi të lidhjes me qendrën e kostos, përkatësisht: shpenzim, prodhim, investim, shitje, shërbim, etj. Mirëpo gjatë vitit 2025 ndërmarrja nuk kishte arritur të funksionalizoj këtë modul. Po ashtu edhe moduli i aseteve (përveç tokave) ishin menaxhuar jashtë sistemit KIT.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mospërdorimit të moduleve përkatëse nga zyrtarët e ndërmarrjes, duke pamundësuar paraqitjen e një gjendjeje reale, të saktë dhe të kontrollueshme të stoqeve dhe aseteve.

**Ndikimi** Mosfunksionimi dhe mospërdorimi i moduleve të stoqeve dhe aseteve ndikon në mosparaqitjen e saktë të gjendjes së stoqeve dhe aseteve në pasqyrat financiare, duke rritur rrezikun për pasqyrim të gabuar të gjendjes financiare, mungesë të evidencës së plotë të transaksioneve dhe vështirësi në verifikimin dhe kontrollin e lëvizjeve të stoqeve dhe aseteve

**Rekomandimi A6** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë funksionalizimin dhe përdorimin e plotë të moduleve të stoqeve dhe aseteve, me qëllim të evidentimit të saktë dhe të kontrollueshëm të lëvizjeve dhe gjendjes së tyre, në mënyrë që pasqyrat financiare të paraqesin drejt gjendjen reale të ndërmarrjes.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A7 - Mos protokollimi i faturave në mënyrë zyrtare****Gjetja**

Ligji nr. 04/L-184 për administrimin e punës në zyrë, neni 3, pika 4, në njësinë e administrimit të dokumenteve bëhet hapja e dokumenteve të pranuar, vënia e vulës së protokollit, data, evidentimi në evidencën themelore apo ndihmëse, dërgimi në njësinë e caktuar dhe pas përfundimit brenda institucional bëhet kthimi i lëndës në njësinë e administrimit të dokumenteve. Ndërsa neni 5, pika 1, përcakton se: Aktet e pranuar dhe të ndara protokollohen në evidencën themelore, me numër të protokollit në të njëjtën ditë në të cilën janë pranuar.

Përmes testimit të pagesave, kemi identifikuar se faturat ishin pranuar, mirëpo nuk ishin trajtuar përmes procedurës së rregullt të protokollimit sipas praktikave të përcaktuara.

Gjatë auditimit të procesit të pranimi dhe administrimit të faturave për vitin 2025 në Njësinë Kopaonik-Leposaviç, kemi shqyrtuar mënyrën e evidentimit dhe trajtimit të dokumentacionit financiar. Nga auditimi u konstatua se faturat e pranuar nga furnitorët nuk ishin regjistruar përmes sistemit zyrtar të protokollit, por ishin evidentuar në një regjistër të brendshëm të njësisë.

Konkretisht, faturave nuk u është vendosur vula e protokollit me datën e pranimi dhe nuk u është caktuar numër unik protokollit në datën e pranimi. Në vend të kësaj, njësia ka përdorur një libër të brendshëm evidencues për regjistrimin e faturave. Ky regjistër nuk përmban të gjitha elementet formale të administrimit të dokumenteve dhe nuk siguron gjurmë të plotë administrative për pranimin dhe trajtimin e tyre.

Për më tepër, mungesa e protokollimit zyrtar ka qenë praktikë e vazhdueshme në këtë njësi, duke bërë që ndërmarrja të mos ketë dëshmi të plota dhe të verifikueshme për datën e pranimi dhe trajtimin e dokumenteve financiare sipas kërkesave ligjore.

Kjo ka ndodhur pasi ndërmarrja ka mbajtur një libër të brendshëm për evidentimin e faturave, duke mos i trajtuar ato përmes procedurës zyrtare të protokollimit dhe administrimit të dokumenteve.

**Ndikimi**

Mosprotokollimi i faturave në mënyrë zyrtare rrit rrezikun e humbjes së dokumenteve, vonesave në trajtim, mungesës së gjurmës administrative dhe dobësimi të kontrollit të brendshëm mbi dokumentacionin financiar.

**Rekomandimi A7**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të protokollohen në mënyrë zyrtare, me vulë, datë dhe regjistrim në evidencën themelore, në pajtim me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-184 për Administrimin e Punës në Zyrë.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A8 - Trajtim i pasaktë i shtesave për punonjësit si shpenzim dhe mospërfshirje në pagën bruto****Gjetja**

Sipas Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, neni 9 “Të ardhurat nga pagat”, paragrafi 1, në të ardhurat bruto nga pagat përfshihen: paragrafi 1.2. bonuset, provizionet, mëditjet dhe format e tjera të kompensimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit, ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës.

Nga testimi i dy mostrave, kemi konstatuar se Njësia Kopaonik-Leposaviq, në rastin e parë, me vendim të drejtorit të kësaj njësie në bazë të kërkesës së sindikatës dhe menaxhmentit, janë realizuar pagesa për punonjësit në vlerë prej 50€, ku kanë përfituar 1535 punëtorë gjithsej, në vlerë totale financiare 81,000€ për festën e fundvitit. Në rastin e dytë, përsëri me kërkesë të sindikatës, drejtori i kësaj njësie kishte marrë vendim që si ndihmë për një festë zyrtare t’u jep punëtorëve nga 30€, ku kanë përfituar 1555 punëtorë gjithsej, në vlerë financiare 47,310€. Të dy këto raste kapin shumën totale prej 128,410€. Këto pagesa janë regjistruar në llogarinë e shpenzimeve 5292 “Ndihmë për punonjësit në familje”, e cila nuk është adekuate për natyrën e këtyre shpenzimeve, pasi ato përfaqësojnë përfitime që burojnë nga marrëdhënia e punës dhe jo ndihmë sociale individuale.

Pra këto pagesa nuk janë trajtuar si pjesë e pagës bruto dhe ndaj tyre nuk janë aplikuar tatimi në të ardhura personale dhe kontributet pensionale, siç kërkohet me legjislacionin në fuqi.

Kjo ka ndodhur si rezultat i trajtimit jo të saktë të këtyre pagesave si përfitime që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe mosaplikimit të tatimeve dhe kontributeve përkatëse, për shkak të mënyrës së paqartë të trajtimit të tyre kontabël dhe tatimor.

**Ndikimi**

Si rezultat, shpenzimet nuk janë klasifikuar në mënyrë të saktë në pasqyrat financiare dhe pagesat ndaj punonjësve nuk janë trajtuar si të ardhura të tatueshme. Kjo ka ndikuar në mosllogaritjen dhe mospagimin e tatimit në të ardhura personale dhe kontributeve pensionale, si dhe në paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare.

**Rekomandimi A8**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që të gjitha pagesat dhe përfitimet për punonjësit të trajtohen si pjesë e pagës bruto dhe t’i nënshtrohen tatimit në të ardhura personale dhe kontributeve pensionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, duhet të sigurohet klasifikim i drejtë i shpenzimeve në llogaritë përkatëse kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A9 - Kontrata të punës të punonjësve të Njesisë Kopaonik-Leposaviq të pa azhurnuara me ndryshimet ligjore****Gjetja**

Ligji Nr. 05/L-120 për Trepçën, neni 6 paragrafi 1 Struktura organizative, kapitali themeltar, menaxhimi dhe çështjet tjera organizative specifike të Trepça Sh.A, përcaktohen në statutin e shoqërisë aksionare sipas ligjit.

Gjatë auditimit kemi konstatuar se kontratat e punës të punonjësve të Njesisë Kopaonik-Leposaviq janë ende të nënshkruara në emër të “Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP-së”, subjekt juridik i cili është shuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Trepçën dhe transformimit të ndërmarrjes në “Trepça” Sh.A.

Kjo praktikë është identifikuar në të gjitha kontratat e testuara të punonjësve të kësaj njësie, duke reflektuar se kontratat nuk janë azhurnuar në përputhje me statusin aktual juridik dhe organizativ të ndërmarrjes.

Për më tepër, gjatë vitit 2025 është konstatuar se mesatarisht 19 punëtorë janë paguar përmes arkës, në mungesë të llogarive bankare. Sipas njësisë, kjo është arsyetuar me pamundësinë për të siguruar llogari bankare për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës në Kosovë.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve adekuate nga menaxhmenti për harmonizimin dhe azhurnimin e dokumentacionit të burimeve njerëzore me ndryshimet ligjore dhe organizative të ndërmarrjes. Po ashtu, mungesa e rishikimit periodik të kontratave të punës dhe akteve të brendshme ka ndikuar që kontratat të vazhdojnë të mbeten në emër të subjektit juridik të shuar.

**Ndikimi**

Mosazhurnimi i kontratave të punës me statusin aktual juridik të ndërmarrjes krijon paqartësi juridike në marrëdhëniet e punës dhe rrit rrezikun e kontesteve ligjore lidhur me vlefshmërinë e kontratave dhe të drejtave e obligimeve të palëve. Gjithashtu, kjo situatë tregon mungesë të harmonizimit të dokumentacionit të personelit me kërkesat ligjore dhe organizative në fuqi.

**Rekomandimi A9**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë rishikimin dhe harmonizimin e dokumentacionit të burimeve njerëzore me statusin aktual juridik dhe organizativ të Trepça Sh.A. Gjithashtu, duhet të ndërmerren veprime për azhurnimin e kontratave të punës dhe akteve të brendshme, në mënyrë që të gjitha marrëdhëniet e punës të jenë të rregulluara në përputhje me legjislacionin dhe strukturën aktuale të ndërmarrjes.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja A10 - Dobësi në inventarizimin e pasurive****Gjetja**

Ligji nr.06/L-032 neni 12 Inventarizimi i pasurisë dhe detyrimeve:

1. Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive së tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.
2. Inventarizimi i pasurive dhe detyrimeve kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara nga organi drejtues i shoqërive tregtare. Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.
3. Nëse për shkak të rrethanave të ndryshme, gjendja fillestare (historike) e pasurisë nuk posedon dokumente burimore ose inventari i pasurive është i panjohur, vlefshmëria e tyre për qëllime të regjistrimit dhe qëllimeve tatimore vlerësohet nga vlerësues të licencuar vendor apo të huaj të pasurive të patundshme për vlerësim dhe regjistrim të pasurive.

Rregullorja e ndërmarrjes për menaxhimin e pasurisë jo financiare me nr protokoli 733 , neni 12 përcakton se përgjegjësitë e Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë Jo Financiare janë: inventarizimi i të gjithë pasurisë jo financiare që është në pronësi dhe në kontroll të Trepça Sh. A, verifikimi fizik dhe cilësor i gjendjes së pasurisë jo financiare, krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurisë, identifikimi i pasurisë që nuk ka vlerë të bartur, Identifikimi i pasurive të dëmtuara dhe jashtë përdorimit, Hartimi i raportit të përgjithshëm bazuar në raportet individuale.

Gjatë ekzaminimit të procesit të inventarizimit të pasurive fikse për periudhën nën auditim, u konstatua se inventarizimi nuk është kryer në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 06/L-032, Neni 12, si dhe me procedurat e brendshme të miratuara nga Bordi konkretisht:

- Komisioni Qendror i Inventarizimit nuk kishte përgatitur raport përmbledhës narrativ mbi rezultatet e inventarizimit, i cili do të duhej të përmbante gjetjet, analizat, konkluzionet dhe rekomandimet për menaxhmentin dhe Bordin Mbikëqyrës;
- Në procesin e inventarizimit nuk ishin përfshirë të gjitha kategoritë e pasurive dhe detyrimeve, përfshirë LLA dhe LLP, duke mos siguruar verifikim të plotë të ekzistencës të ekzistencës së tyre;
- Nuk ishte kryer identifikimi i saktë dhe sistematik i pajisjeve të vjetra, jashtë përdorimit dhe të dëmtuara. Si pasojë, një numër i konsiderueshëm pajisjesh të tilla janë jashtë listave të evidentimit dhe një numër i konsiderueshëm vazhdojnë të figurojnë në regjistrat kontabël si pasuri aktive, duke çuar në mbivlerësim të bilancit të pasurive fikse;
- Gjithashtu, nuk u krye asnjë krahasim midis rezultateve të inventarizimit fizik dhe shënimeve kontabël (librave të inventarit dhe regjistrave kryesorë). Ky krahasim është një kërkesë themelore e procedurave të inventarizimit për të identifikuar dallimet, për të sqaruar arsyet e tyre dhe për të kryer rregullimet e nevojshme kontabël.

Mungesa e mbikëqyrjes efektive dhe e zbatimit të procedurave të miratuara për inventarizimin nga ana e menaxhmentit dhe Bordit Mbikëqyrës, Komisionet e inventarizimit (përfshirë Komisionin Qendror) nuk kanë marrë udhëzime të qarta, të detajuara lidhur me kërkesat ligjore; Ka pasur një qasje formale dhe jo-substanciale ndaj procesit, pa mekanizma kontrolli që të sigurojnë përfshirjen e të gjitha kategorive të pasurive, identifikimin e pajisjeve të dëmtuara, përgatitjen e raportit përmbledhës dhe krahasimin me librat kontabël, duke bartur shënimet e njejta nga viti në vitë.

#### **Ndikimi**

Mungesa e një inventarizimi të plotë, të saktë dhe të mirëdokumentuar komprometon besueshmërinë e informacionit kontabël mbi pasuritë fikse, rrezikon mbivlerësimin ose nënvlerësimin e tyre në bilancin e gjendjes, dhe pengon menaxhimin e duhur të pasurive (përfshirë shitjen, çregjistrimin ose riparimin e pajisjeve të dëmtuara/jashtë përdorimit). Si rezultat, Bordi dhe menaxhmenti nuk kanë një pamje të saktë dhe të plotë të gjendjes reale të pasurive, çka mund të ndikojë negativisht në vendimmarrje strategjike dhe në raportimin financiar.

#### **Rekomandimi A10**

Bordi Mbikëqyrës të sigurojë që të përfshihen LLA dhe LLP-të në procesin e ardhshëm të inventarizimit, të kryhet identifikimi i detajuar, klasifikimi dhe vlerësimi i pajisjeve të vjetra, jashtë përdorimit dhe të dëmtuara, me propozime konkrete për çregjistrim ose shitje. Po ashtu Bordi të sigurojë se Komisioni Qendror të përgatisë një raport përmbledhës narrativ (në formë të shkruar) që përmbledh të gjitha gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet me afate zbatimi, për t'ia përcjellë menaxhmentit dhe Bordit Mbikëqyrës dhe të kryhet krahasimi sistematik midis inventarit fizik dhe shënimeve kontabël, me regjistrimin e dallimeve dhe korrigjimet përkatëse kontabile.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B17 - Mangësi në procedurat e transferimit të punonjësve**

##### **Gjetja**

Sipas Ligjit të punës Nr. 03/L-212 Nenit 17 Caktimi i të punësuarit në vendin e punës pika 1 I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilën ka lidhur Kontratë Pune dhe pika 2 Në rast të nevojës për ristrukturimin apo organizim të ri të punës, i punësuarit në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja kishte realizuar 119 raste transferimesh të punonjësve nga një pozitë në një tjetër vetëm me vendim të Kryeshefit Ekzekutiv, pa përditësuar kontratat e punës apo pa përpiluar anekse kontrata. Prej tyre sipas evidencave të ndërmarrjes: në 28 raste është evidentuar rritje e pagës, në 52 raste ulje e pagës, dhe në 39 raste nuk ka pasur ndryshime në pagë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mangësive në rregullorën për sistematizimin e vendeve të punës, si dhe moszbatimit të praktikave të rregullta të menaxhimit të burimeve njerëzore nga personat përgjegjës.

**Ndikimi** Transferimi nga një pozitë në tjetrën mund të ndikojë në ulje të efikasitet të punonjësve si dhe rritjes së pakënaqësisë dhe mund të rezultojë në pasoja ligjore.

**Rekomandimi B17** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme atëherë kur për çdo ndryshim të pozitës, pagës apo kushteve të tjera të punës të formalizohet përmes nënshkrimit të kontratës së re apo aneksit të saj, në përputhje me kërkesat ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B18 - Prezantim jo i plotë dhe i saktë i shënimeve shpjeguese**

**Gjetja** Sipas SNK1 paragrafi 113, n.jë njësi ekonomike duhet të paraqesë shënimet shpjeguese në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Kur përcakton një mënyrë organizimi, njësi ekonomike duhet të marrë në konsideratë efektin në kuptueshmërinë dhe krahasueshmërinë e pasqyrave të saj financiare. Çdo zë në pasqyrat e pozicionit financiar dhe të ardhurave gjithëpërfshirëse, në pasqyrën e të ardhurave individuale (nëse paraqitet), dhe në pasqyrën e ndryshimeve në kapital neto dhe në pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese

Ndërmarrja kishte përpiluar shënimet shpjeguese si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare, megjithatë informacioni i dhënë nga ndërmarrja në shënimet shpjeguese nuk ofron detaje në lidhje me:

Shpalosjet e bëra për PFV-të nuk kanë prezantuar detajet e përbërjes së zërave përkatës si dhe nuk ofrojnë sqarime narrative lidhur me zëra: pasuritë afatgjata, të arkëtueshmet dhe të tjera, pasuritë tjera afatshkurtëra, grantet dhe të hyrat e shtyera, llogaritë e pagueshme, detyrimet e pagueshme dhe akrualet, ekuiteti, detyrimet afatgjata, detyrimet tjera afatshkurtëra, kostoaj e mallit të shitur, shpenzimet operative, të hyrat dhe të hyrat e tjera.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtarët e ndërmarrjes i kishin konsideruar si të mjaftueshme informacionet e prezantuara në shënimet shpjeguese.

**Ndikimi** Informacionet e shpalosura në shënimet shpjeguese, ndikojnë në cilësinë e pasqyrave financiare duke shkaktuar paqartësi në kuptueshmërinë e informatave, si dhe ndikon që informacionet financiare të mos jenë të plota për përdoruesit e pasqyrave financiare.

**Rekomandimi B18** Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B19 - Mospërmbushja e kriterëve të përshtatshmërisë profesionale****Gjetja**

Sipas dosjes së tenderit, në kuadër të përshtatshmërisë profesionale, pika 4, është kërkuar që operatori ekonomik të dorëzojë si dëshmi dokumentare kopjen e certifikatës dhe lejeve nga institucionet kompetente për kryerjen e punëve minerare të përmendura. Sipas nenit 45.35 të Rregullores 002/2024 me plotësim-ndryshimin Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, dosja e tenderit, duke përfshirë edhe anekset, përcakton të gjitha kushtet materiale të kontratës dhe për rrjedhojë nuk ka hapësirë për ndonjë negociim të kushteve të kontratës para nënshkrimit të saj.

Nga testimi i procedurës së prokurimit nr. 12054-25-3588-5-2-1, "Gërmimi i xeherores dhe hapja e hapësirave horizontale dhe vertikale në minierën Belo Brdo", është konstatuar se kontrata e nënshkruar nuk ishte në përputhje të plotë me tenderin e shpallur fitues dhe ofertën e vlerësuar.

Operatori ekonomik fitues nuk kishte përmbushur kriteret e përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, pasi nuk kishte dorëzuar dëshmitë e kërkuara, respektivisht kopjet e certifikatave dhe lejeve të lëshuara nga institucionet kompetente për kryerjen e punëve minerare, siç ishte përcaktuar në kushtet e tenderit.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i interpretimit të paqartë të kushteve të dosjes së tenderit lidhur me kërkesën për posedimin e licencës.

**Ndikimi**

Kjo situatë mund të rezultojë në përzgjedhje të papërshtatshme të operatorit ekonomik dhe rrezikon parimet e transparencës, barazisë dhe konkurrencës së drejtë në procedurën e prokurimit.

**Rekomandimi B19**

Bordi mbikëqyrës të sigurojë që procedurat e prokurimit në ndërmarrje të zhvillohen në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe legjisllacionin sekondar.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B20 - Mos aplikimi i provizionimit për llogaritë e arkëtueshme tregatre****Gjetja**

Sipas IFRS 9, paragrafët 5.51, 5.5.15 dhe B5.5.35, kërkojnë që ndërmarrja të njohë humbjet e pritshme nga klientët që nga momenti i njohjes së llogarive të arkëtueshme dhe të përdorë metoda si matrica e provizionimit për të llogaritur këto humbje.

Gjatë auditimit është vërejtur se ndërmarrja nuk ka aplikuar fare metoda për vlerësimin e humbjeve të pritshme nga llogaritë e arkëtueshme dhe nuk ka krijuar provizione për rrezikun e mosarkëtimit, me ç'rast llogaritë e arkëtueshme paraqiten pa korrigjim përkatës.

Mungesa e një politike të brendshme të formalizuar për vlerësimin e rrezikut nga klientët debitorë dhe mospërdorimi i metodave të pranueshme për matjen e humbjeve të pritshme, në përputhje me IFRS 9.

**Ndikimi**

Mosprovizionimi i këtyre llogarive rrit vlerën e pasqyrës së aktiveve dhe rezulton në mbivlerësim të fitimit neto dhe kapitalit të ndërmarrjes. Kjo mund të ndikojë në mënyrë jo të drejtë në vendimarrjen e palëve të interesit.

**Rekomandimi B20**

Bordi mbikëqyrës duhet të zhvillojë dhe zbatojë një politikë të qartë për provizionimin e llogarive të arkëtueshme në përputhje me kërkesat e IFRS 9, duke përdorur modelin e humbjes së pritshme. Kjo përfshin ndarjen e debitorëve sipas periudhës së vonësës, historikut të pagesave dhe rrezikut të kreditit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B21 - Mungesa e vlerësimit të pasurive dhe mbetjeve teknologjike**

**Gjetja**

Bazuar në nenin 5 pika 5 e Ligjit për Trepçën, Trepça Sh. A. trashëgon të drejtën e valorizimit të mbetjeve teknologjike nga e kaluara dhe trajtimin e tyre në përputhje me standardet mjedisore dhe studimin e fizibilitetit. Po ashtu, bazuar në nenin 6 pika 3 pasuritë e Trepça Sh. A. përbëhen nga pasuritë e njësive biznesore të përcaktuara me këtë ligj dhe vlera e tyre përcaktohet në statut, duke u bazuar në studimin e fizibilitetit dhe me metodat standarde të vlerësimit.

Ndërmarrja nuk ka realizuar ndonjëherë vlerësimin e pasurive në pronësi të saj dhe as vlerësimin e mbetjeve teknologjike me qëllim të përcaktimit të një vlere të realizueshme për to.

Kjo situatë është ndikuar nga kufizimet financiare të ndërmarrjes për angazhimin e ekspertëve profesionalë të fushës, çka ka bërë që procesi i vlerësimit të pasurive dhe mbetjeve teknologjike të shtyhet në mënyrë të vazhdueshme, pa u adresuar në mënyrë të duhur nga menaxhmenti.

**Ndikimi**

Mungesa e vlerësimit të pasurive dhe mbetjeve teknologjike ndikon në besueshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, pasi nuk reflektohet vlera reale e aseteve të ndërmarrjes.

**Rekomandimi B21**

Bordi Mbikëqyrës duhet të shqyrtoj mundësinë e rivlerësimit të pasurive të ndërmarrjes që të sigurohet se vlera e prezantuar e pasurive në pasqyra financiare nuk ndryshon materialisht nga vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Po ashtu të bëhet një vlerësim profesional i vlerës dhe formës më profitabile për trajtimin të mbetjeve/sterilit për ndërmarrjen.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B22 - Vonesa në aprovimin e Pasqyrave Financiare dhe Raportit Vjetor të Menaxhmentit****Gjetja**

Sipas Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 31.3, përcakton se brenda 45 ditëve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, Zyrtarët e NP-së, në përputhje me Nenin 14.1, do të përgatisin dhe dorëzojnë Bordit të Drejtorëve të NP-së, një raport vjetor për vitin kalendarik të sapo përfunduar, në të cilin përshkruhen veprimet e marra, rezultatet financiare të arritura si dhe efektshmëria e përgjithshme në realizimin e caqeve të vendosura në Planin e Biznesit. Brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor, Bordi i Drejtorëve të NP do ta shqyrtojë, ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ta miratojë dhe dorëzojë, secilin raport të këtillë vjetor tek Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve, e cila e publikon atë në faqen e saj zyrtare në internet dhe sipas rastit, Qeverisë ose Komisionit (eve) Komunal të Aksionarëve.

Ndërmarrja kishte përpiluar me vonesë prej 46 ditë pasqyrat financiare vjetore për vitin 2025. Si rrjedhojë e kësaj, ndërmarrja kishte finalizuar pasqyrat financiare për vitin 2025 me datën 30 prill 2026.

Për më tepër, ndërmarrja nuk kishte përmbushur kërkesat ligjore sipas kërkesave të ligjit për Minierat dhe Mineralet, paragrafit 4.2.3, për përgatitjen e deklaratës së audituar mbi shumën e rentës minerare, dhe të paragrafit 4.2.4, për raportin financiar të audituar mbi përfitimet, humbjet dhe gjendjen financiare të ndërmarrjes.

Kjo kishte ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk kishte arritur të finalizonte me kohë dhe ti dërgonte për aprovim tek bordi mbikëqyrës, si dhe për shkak të ndryshimeve në menaxhment gjatë kohës së përpilimit të PFV-ve.

**Ndikimi**

Mos hartimi dhe aprovimi me kohë i pasqyrave financiare finale, ndikon në mos përmbushjen e kërkesave ligjore, si dhe mos informimin e shfrytëzuesve të pasqyrave financiare në afatin e paraparë.

**Rekomandimi B22**

Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur, shqyrtuar dhe aprovuar në afatet e përcaktuara ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B23 - Mungesa e dokumentimit të certifikimit të pagesave nga zyrtari certifikuesi****Gjetja**

Ligji Nr. 05/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjet Nr. 03/L-221, Nr.04/L-116 dhe Nr.04/L-194, Neni 14 zyrtari certifikues, çdo organizatë buxhetore, agjenci autonome ekzekutive dhe ndërmarrje publike duhet të ketë Zyrtarin Certifikues.

Ndërmarrja kishte të përcaktuar në organogram pozitën e zyrtarit certifikues si pjesë të strukturës së saj organizative, mirëpo gjatë auditimit është konstatuar se, për periudhën deri më 24.09.2025, pagesat janë realizuar pa u dokumentuar certifikimi i tyre nga zyrtari certifikues, për shkak se personi përgjegjës ka qenë në pushim të lehonisë.

Ndërsa pas kthimit nga pushimi i lehonisë (nga 24.09.2025 e tutje), është konstatuar se ka filluar certifikimi i pagesave nga zyrtari certifikues.

Për njësinë Kopaonik Leposaviç, është konstatuar se nuk është bërë certifikimi i pagesave dhe nuk ekziston formë zyrtare e dokumentimit të certifikimit të tyre.

Kjo ka ndodhur për shkak të mbikëqyrjes së pamjaftueshme nga menaxhmenti dhe për shkak se ndërmarrja nuk posedon një procedurë operacionale për zëvendësimin dhe dokumentimin e certifikimit të pagesave në raste mungese të zyrtarit certifikues.

**Ndikimi**

Mungesa e një procedure të dokumentuar për certifikimin e pagesave nga zyrtari certifikues sjell mungesë gjurmueshmërie dhe transparence në procesin e pagesave dhe ndikon në kryerjen e pagesave pa kontroll adekuat, pagesa të paautorizuara dhe përgjegjësi të paqartë.

**Rekomandimi B23**

Bordi Mbikëqyrës duhet të siguroj që janë zhvilluar dhe zbatohen procedura të qarta dhe të dokumentuara për të siguruar kontroll të duhur dhe transparencë në proceset e brendshme financiare, duke përfshirë certifikimin e pagesave nga zyrtari certifikues, si dhe të sigurojë zëvendësim adekuat gjatë mungesës së tij. Gjithashtu, të sigurohet implementimi i procesit të certifikimit të pagesave dhe formalizimi i formës zyrtare të dokumentimit në njësinë Kopaonik Leposaviç.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B24 - Funksonimi i njësisë “Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç”, jo në përputhje me kërkesat ligjore****Gjetja**

Sipas Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, neni 2 pika 2 Njësitë biznesore të Trepça Sh.A janë:

- 2.1. Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89);
- 2.2. Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88);
- 2.3. Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç (Fi 804/89).

Bazuar në studimin e fizibilitetit dhe arsyeshmërinë ekonomike e financiare, në përbërje të Trepça Sh.A. formohen edhe këto njësi biznesore:

Metalurgjia e Plumbit, Metalurgjia e Zinkut, Industria Kimike. Sipas nenit 6 pika 1 Struktura organizative, kapitali themeltar, menaxhimi dhe çështjet tjera organizative specifike të Trepça Sh.A, përcaktohen në statutin e shoqërisë aksionare sipas ligjit. Statuti i ndërmarrjes neni 12 përcakton mënyrat e funksionimit të njësive biznesore si funksionimi i njësive në bazë të ligjit për Trepçën, sa i përket aktiviteteve, propozimi i planeve dhe projekteve për aprovim tek bordi.

Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton se ndërmarrjet publike duhet të organizohen dhe të operojnë në bazë të qeverisjes korporative dhe strukturës statutare, duke siguruar integritet ligjor, transparencë, llogaridhënie dhe kontroll të brendshëm. Nenët 4, 6, 7, 18, 20, 22, 27 dhe 29 të këtij ligji ndalojnë funksionimin jashtë strukturave të miratuara dhe kërkojnë që të gjitha funksionet menaxheriale, financiare dhe operative të jenë pjesë përbërëse e sistemit unik të ndërmarrjes.

Miniera me Flotacion Kopaonik - Leposaviç (FI 804/89), si njësi biznesore e Trepça sh.a., ushtron veprimtari në mospërputhje me kornizën ligjore dhe organizative të ndërmarrjes, si në vijim:

Përdor dy numra unik të identifikimit të biznesit (NUI) në aktivitete të ndryshme: NUI i Trepça Sh.A. (811278747), i përdorur për licencim dhe obligime tatimore, si dhe NUI i subjektit “Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP-së” (810356932), i cili është juridikisht i shuar sipas Ligjit për Trepçën, por ende figuron në përdorim për disa aktivitete operative, përfshirë prokurimin dhe shitjet. Megjithëse në pjesën e fundit të vitit 2025 janë ndërmarrë hapa drejt unifikimit të kontratave të eksportit dhe prokurimit në emër të Trepça Sh.A., përdorimi i dy identiteteve vazhdon të jetë i pranishëm në disa procese.

Po ashtu, është konstatuar se njësia nuk është plotësisht e integruar në sistemin unik të kontabilitetit dhe raportimit financiar të Trepça Sh.A., si dhe operon me llogari bankare të lidhura me subjektin e mëparshëm administrativ, jashtë sistemit bankar të centralizuar të ndërmarrjes.

Gjithashtu, rregulloret e brendshme të njësisë nuk janë të miratuara nga Bordi Mbikëqyrës, ndërsa mekanizmat e raportimit dhe kontrollit mbi stafin, vijueshmërinë në punë, raportet ditore të prodhimit, si dhe analizat teknike të proceseve të flotimit dhe xehes, nuk janë të standardizuara dhe të integruara në mënyrë të rregullt në sistemin raportues të Trepça Sh.A.

Shkaku i kësaj gjendjeje lidhet me moszbatimin e kërkesave ligjore që burojnë nga Ligji për Trepçën dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike, mungesa e mbikëqyrjes efektive nga ana e Bordit Mbikëqyrës dhe mungesës së llogaridhënies nga ana e Njesisë Kopaonik Leposaviç, si dhe me vazhdimësinë e praktikave të trashëguara nga strukturat e mëhershme (si AKP-ja) që nuk janë adresuar në kohë, kanë ndikuar që njësia të veprojë jashtë kontrollit të ligjshëm të ndërmarrjes.

**Ndikimi** Funkcionimi i kësaj njësie jashtë strukturës organizative dhe ligjore të Trepça sh.a. përbën mospërputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe rrezikon deformimin e pasqyrës reale financiare të ndërmarrjes, mungesën e transparencës, keqmenaxhimit e fondeve dhe burimeve publike, si dhe krijimin e rrethanave që cenojnë integritetin e ndërmarrjes.

**Rekomandimi B24** Bordi Mbikëqyrës, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndërprerjen e përdorimit të numrit unik të identifikimit (NUI) që nuk është në përputhje me dispozitat ligjore dhe harmonizimin e të gjithë veprimtarisë me identitetin juridik të ndërmarrjes. Po ashtu, Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë integrimin e njësisë “Miniera me Flotacion Kopaonik - Leposaviç” në sistemin e kontabilitetit, prokurimit, kontrollit financiar dhe auditimit të Trepça sh.a., llogaritë bankare të jenë brenda sistemit unik financiar të Trepça sh.a, si dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme dhe raportimin e rregullt dhe funksional të njësisë ndaj Bordit.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B25 - Mungesa e rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes**

**Gjetja** Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike Neni 34.1 të gjitha NP do t'i përgatisin dhe vënë në fuqi rregulloret të cilat kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare si dhe Neni 8 të statutit për Trepça SH.A. shoqëria duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë, sipas Ligjeve të Republikës së Kosovës.

Ndërmarrja nuk ka të hartuar dhe miratuar rregullore sipas kërkesave ligjore. Mangësitë e tilla janë si në vijim:

Mos hartimi i rregullores apo udhëzuesit për administrimin dhe funksionimin e procesit të të hyrave të tjera ku përfshihen: të hyrat nga shitja e mbetjeve dhe alumin sulfatit;

Ndërmarrja kishte hartuar rregulloret për sistematizimin e vendeve të punës për disa njësi mirëpo nuk ishin të përfshirë të gjitha njësitë e Trepça SH.A Ndërmarrja nuk ka hartuar dhe miratuar rregullore apo udhëzime për administrimin dhe funksionimin e procesit të shpenzimeve dhe furnizimeve sipas kërkesave ligjore;

Njësia Biznesore në Kopaonik - Leposaviç i aplikon rregulloret të cilat janë të pa azhurnuara që nga viti 2007, ku të njëjtat nuk janë të aprovuara nga Bordi Mbikëqyrës i Trepça Sh. A.

Vlen të theksohet se gjatë vitit ndërmarrja kishte hartuar projekt rregulloret në fjalë mirëpo nuk kishte arritur ti finalizoj dhe aprovoj deri sa ishim ne proces të auditimit.

Këto mangësi kanë ndodhur për shkak se ndërmarrja nuk e kishte konsideruar si të nevojshme aprovimin e rregullores për e procesin e të hyrat dhe shpenzimeve ndërsa mos azhurnimi i rregullores kishte ndodhur për shkak mos veprimeve konkrete ndër vite nga bordi mbikëqyrës.

**Ndikimi** Mungesa e rregullores dhe mos azhurnimi i tyre mund të ndikoj që trajtimi i çështjeve për rastet e natyrës së njëjtë të jetë i ndryshëm. Kjo reflekton në aktivitetet operacionale dhe financiare të ndërmarrjes.

**Rekomandimi B25** Bordi Mbikëqyrës të sigurojë hartimin dhe miratimin e rregullores të cilat janë të nevojshme për afarizmin e ndërmarrjes duke siguruar aplikimin e tyre në të gjitha njësitë biznesore.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B26 - Mos pagesa e kontributeve dhe tatimit në pagë për punëtorët**

**Gjetja** Sipas Ligjit Nr. 05/L-028 për tatimin në të ardhurat personale ndryshohet dhe plotësohet me Ligjin Nr.08/L-142 Neni 38.1 thekson se secili punëdhënës është përgjegjës të mbajë në burim tatimin nga pagat e tatueshme të paguara të punëtorëve. Udhëzimi administrativ Nr 01/2016 për zbatimin e ligjit Nr. 05/L-28 për tatimin në të ardhurat personale Neni 42 Dispozitat e përgjithshme që aplikohen për tatimet e mbajtura në burim përcakton se Tatimpaguesi i cili është i obliguar të mbaj tatimin në burim, dorëzon pasqyrën e mbajtjes së tatimit në burim dhe transferon shumën në një llogari të caktuar nga ATK, në njërin nga bankat apo institucionet financiare të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës, Brenda 15 ditëve pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik, në përputhje me aktin nënligjor të lëshuar nga Ministri. Po ashtu, Ligji NR. 05/L-116 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115 dhe Ligjin Nr, 04/L-168. kërkohet që punëdhënësi të zbret kontributin pensional të punonjësve nga rrogat e punonjësve dhe të bartë në llogarinë e posaçme të fondit bashkë me kontributin e punëdhënësit në afatin e duhur në përputhje me rregullat që do të nxirren në mënyrën që e cakton Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

Ndërmarrja, në kuadër të detyrimeve të tjera afatshkurtra, kishte prezantuar tatim në paga të pagueshëm në vlerë prej 5,618,593 €, kontribute pensionale të pagueshme në vlerë prej 8,431,198 €, si dhe interes dhe ndëshkime të pagueshme lidhur me tatimet dhe kontributet në vlerë prej 955,486 €.

Nga analiza e kryer është konstatuar se ndërmarrja, që nga viti 2020, nuk ka kryer pagesën e tatimit në paga dhe kontributeve pensionale për punonjësit e saj. Përfundim bëjnë nëntë (9) muaj të vitit 2022, për të cilët obligimet janë shlyer nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) përmes kompensimit me rimbursimet tatimore. Si rezultat i mospagesës së obligimeve bazë, nuk janë shlyer as interesat dhe ndëshkimet e akumuluar për këto detyrime.

Gjithashtu, kemi konstatuar se në deklaratat tatimore për muajin prill 2025 nuk janë përfshirë punonjësit e Njesisë Biznesore Miniera me Flotacion Kopaonik-Leposaviç. Për më tepër, nga krahasimi i regjistrit të personelit me të dhënat e deklaruara në ATK është evidentuar një mospërputhje prej rreth 107 punonjësish, për të cilët nuk janë deklaruar tatimet në paga.

Po ashtu, gjatë vitit 2025, Njësia Biznesore Kopaonik-Leposaviç ka kryer pagesën e pagave për mesatarisht 19 punonjës përmes arkës. Sipas shpjegimeve të menaxhmentit të njesisë, këta punonjës nuk kishin llogari bankare për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm për hapjen e tyre.

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së likuiditetit financiar dhe dobësive në kontrollin dhe monitorimin e përmbushjes së obligimeve ligjore lidhur me deklarimin dhe pagesën e tatimeve dhe kontributeve.

#### **Ndikimi**

Mos kryerja e pagesave për kontributet dhe tatimet ndaj punonjësve ndikon në rritjen e obligimeve ndaj punonjësve dhe ATK-së dhe krijon detyrime shtesë nga ndëshkimi, interesi dhe paditë të cilat shkaktojnë në vazhdimësi rritje të këtyre borxheve.

#### **Rekomandimi B26**

Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë masat e menjëhershme për shlyerjen e obligimeve ndaj punonjësve dhe ATK-së në mënyrë që të shmangët rritja e vazhdueshme e kostove shtesë që rrjedhin nga këto obligime, si dhe të trajtoj rastet e punëtorëve të pa deklaruar.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2024 të Trepça Sh.a ka rezultuar në 34 rekomandime kryesore.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2025, (5) pesë rekomandime janë zbatuar plotësisht, (3) tre nuk janë të aplikueshëm më si dhe 26 rekomandime nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 1 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2024	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të forcojë kontrollimet e brendshme në regjistrimin dhe verifikimin e lëvizjeve kontabël, duke përfshirë kontroll dhe verifikim periodik të llogarive të arkëtueshme. Gjithashtu, të sigurohet që të gjitha transaksionet të pasqyrohen njëherë dhe në periudhën e duhur, në përputhje me SNK 1, për të siguruar paraqitje të drejtë dhe të besueshme të pasqyrave financiare.	Rekomandimi nuk ishte implementuar nga ndërmarrja.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që gjatë procesit të konsolidimit të pasqyrave financiare, të aplikohen në mënyrë rigorozë kërkesat e IFRS 10, duke eliminuar të gjitha transaksionet dhe bilancet ndërmjet njërive të të njëjtit entitet. Kjo do të ndihmojë në përgatitjen e pasqyrave që reflektojnë drejt gjendjen reale financiare të ndërmarrjes.	Nuk ishin marr veprime nga ndërmarrja, si rrjedhojë rekomandimi nuk ishte zbatuar	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që personat përgjegjës aplikojnë regjistrimin e transaksioneve në kontabilitet duke u bazuar në parimin aktual, në mënyrë që të gjitha shpenzimet të regjistrohen në periudhën përkatëse.	Gjatë testimeve tona kemi hasur prap në raste tilla. Si rrjedhojë rekomandimi është i përsëritur.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që menaxhmenti të përmirësojë kontrollet mbi ndarjen dhe klasifikimin e të dhënave analitike, duke eliminuar përfshirjen e parapagimeve në analitikën e llogarive të arkëtueshme dhe duke garantuar përputhshmëri të plotë me standardet përkatëse kontabël.	Nuk ishin marr veprime nga ndërmarrja, si rrjedhojë rekomandimi nuk ishte zbatuar.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të ndërmerrë veprime në rivlerësimin e plotë të llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare, dhe të sigurojë njohjen e humbjeve të mundshme për zërat jo të rikuperueshëm, në përputhje me kërkesat e SNRF 9 dhe SNK 1.	Kjo çështje është trajtuar te gjetja B10 Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme tregate.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që menaxhmenti i ndërmarrjes të zbatojë në mënyrë të saktë dhe të plotë kërkesat e konsolidimit sipas IFRS 10, duke përjashtuar të gjitha transaksionet e brendshme ndërmjet njësisë të grupit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, me qëllim të paraqitjes së drejtë të të hyrave dhe performancës reale financiare të grupit.	Ndërmarrja gjatë vitit 2025 nuk ka pasur transaksione ndërmjet njësisë së Jugut dhe njësisë së Veriut.	Nuk është i aplikueshëm më
7.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që bëhen regjistrime kontabël të sakta në përputhje me kushtet ExWorks (EXW), dhe duhet të zbatojë një proces tre hapa: parapagimi prej 95% të regjistrohet si detyrim (të hyrat e shtyra), më pas në fazën e doganimit të njihën të hyrat akuale dhe të hapet llogaria e arkëtueshme e mbetjes bazuar në Dokumentin Unik Doganor ndaj parapagimit, dhe në fund në faturën finale të debitohet tërë shuma e të hyrave akuale, të kreditohet të hyra reale dhe të përditësohet llogaria e arkëtueshme sipas diferencës me faturën finale. Për të parandaluar gabime, rekomandohet, trajnimi i stafit dhe forcimi i kontrolleve të brendshme.	Rekomandimi nuk ishte zbatuar.	Nuk ka filluar zbatim

8.	Baza për opinion	Bordi Mbikëqyrës duhet të ndërmerrë veprime për sigurimin e aplikimit të plotë të kërkesave të SNK 21, përmes zhvillimit të politikave dhe procedurave për njohjen, matjen dhe pasqyrimin e fitimit apo humbjes nga kursi i këmbimit valutor. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e saktësisë dhe transparencës së pasqyrave financiare të ndërmarrjes dhe përputhshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.	Ndërmarrja gjatë vitit 2025 kishte ndërmarrë veprimet duke llogaritur fitimin/humbjen nga kursi këmbimit.	I zbatuar
9.	Baza për konkluzion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme atëherë kur për çdo ndryshim të pozitës, pagës apo kushteve të tjera të punës të formalizohet përmes nënshkrimit të kontratës së re apo aneksit të saj, në përputhje me kërkesat ligjore.	Kemi hasur prap raste të transferimeve pa azhurnim të kontratave të punës.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Baza për konkluzion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që të përmirësohen kontrollet e brendshme për të siguruar që pagesat e bëra të jenë në përputhje me numrin e punonjësve të kontraktuar.	Sa i përket kontratës për shërbimet e sigurimit të punëtorëve të Trepça Sh.A., kontrata ka skaduar, ndërsa gjatë vitit 2025 janë shpallur procedura të prokurimit, por për shkak të mungesës së ofertave nga operatorët ekonomikë nuk ka qenë e mundur të përfundojë asnjë procedurë. Si rezultat, gjatë vitit 2025 punëtorët nuk kanë pasur shërbime të sigurimit.	I zbatuar
11.	Baza për konkluzion	Bordi Mbikëqyrës të sigurojë që në të gjitha aktivitetet e prokurimit të kërkohet dhe verifikohet licenca përkatëse para lidhjes së kontratës dhe që nënshkrimi të bëhet vetëm nga zyrtarët e autorizuar sipas LPP-së.	Nuk kemi hasur në raste të ngjashme vitin aktual.	Nuk është i aplikueshëm më

12.	Baza për konkluzion	Bordi mbikëqyrës duhet të siguroj që janë zhvilluar dhe zbatohen procedura të qarta dhe të dokumentuara për të siguruar kontroll të duhur dhe transparencë në proceset e brendshme financiare, duke përfshirë certifikimin e pagesave nga zyrtari certifikues.	Në njësinë Jug, deri më datë 24 shtator 2025, zyrtarja përgjegjëse ka qenë në pushim të lehonisë, për pasojë faturat nuk janë certifikuar brenda kësaj periudhe. Ndërsa në njësinë Kopaonik-Leposaviç nuk është kryer fare certifikimi i faturave.	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Baza për konkluzion	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që të hyrat nga subvencionet dhe grantet të paraqiten në pasqyrat financiare ose si zë i veçantë, ose brenda një grupimi të qartë dhe identifikueshëm, si "Të ardhura të tjera", në përputhje me kërkesat e SNK 20. Përveç kësaj, informacioni shpjegues duhet të përfshijë natyrën, burimin dhe ndikimin e këtyre granteve.	Nderrmarrja gjatë vitit 2025 ka shpalosur të ndara të hyrat nga grantet me subvencione.	I zbatuar
14.	Baza për konkluzion	Bordi mbikëqyrës të sigurojë që procedurat e prokurimit në ndërmarrje të zhvillohen në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe legjislacionin sekondar.	Rekomandim i pa implementuar.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që ndërmarrja gjatë regjistrimit dhe përpilimit të PFV ka përdorur kontabilitetin e dyfishtë si dhe duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme dhe identifikimi i gabimeve që ka shkaktuar këtë mos barazim.	Me aplikimin e softuerit të ri ndërmarrja parasheh ta implementojë rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimi
16.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë, së bëhen vlerësimet e nevojshme për provizionet dhe kontingjencat dhe të jepen informacionet shpjeguese të plota në pasqyra financiare.	Ndërmarrja nuk ka arritur ta implemetojë rekomandimin nga viti paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që janë marrë veprime konkrete përmirësuese për të trajtuar çështjen e kapitalit aksionar sipas kërkesave ligjore.	Ndërmarrja nuk ka arritur ta zbatojë rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimi
18.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se pasqyrat financiare janë përgatitur dhe aprovuar në afatet e përcaktuara ligjore.	Ndërmarrja kishte vonuar aporovimin e Pasqyrave Financiare dhe kjo qështje është elaboruar në raportin e auditimit.	Nuk ka filluar zbatimi

19.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës të sigurojë një analizë gjithëpërfshirëse të zërave të cilët kanë ndikuar në mos prezantimin e saktë të rrjedhës së parasë dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet, si dhe të marrë veprimet e nevojshme korrigjuese për të pasur një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.	Ndërmarrja ende nuk ka arritur ta implementojë rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimin
20.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që shënimet shpjeguese, përmbajnë parimet bazë që përdoren për hartimin e pasqyrave financiare dhe informacionet mbi përbërjen e zërave të pasqyrave, janë dhënë sipas kërkesave të standardeve të kontabilitetit.	Ndërmarrja nuk kishte implementuar rekomandimin nga viti paraprak.	Nuk ka filluar zbatimin
21.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ndërprerjen e përdorimit të numrit unik të identifikimit (NUI) që nuk është në përputhje me dispozitat ligjore dhe harmonizimin e të gjithë veprimtarisë me identitetin juridik të ndërmarrjes. Po ashtu, Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë integrimin e njësishë "Miniera me Flotacion Kopaonik - Leposaviç" në sistemin e kontabilitetit, prokurimit, kontrollit financiar dhe auditimit të Trepça sh.a., llogaritë bankare të jenë brenda sistemit unik financiar të Trepça sh.a, si dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme dhe raportimin e rregullt dhe funksional të njësishë ndaj Bordit.	Megjithëse ishin bërë disa veprime për implementimin e rekomandimit, gjetja mbetet e përsëritur dhe detajet janë shpalosur në raport tek gjetja.	Nuk ka filluar zbatimin
22.	Kontrollet e brendshme në raportimin financiar	Bordi Mbikëqyrës të sigurojë hartimin dhe miratimin e rregulloreve të cilat janë të nevojshme për afarizimin e ndërmarrjes duke siguruar aplikimin e tyre në të gjitha njësishë biznesore.	Gjatë vitit 2025, ndërmarrja nuk kishte përgatitur disa drafte të rregulloreve, mirëpo nuk kishte arritur ti aprovonte deri sa ne ishim në proces të auditimit.	Nuk ka filluar zbatimin
23.	Llogaritë e arkëtueshme	Bordi mbikëqyrës duhet të zhvillojë dhe zbatojë një politikë të qartë për provizionimin e llogarive të arkëtueshme në përputhje me kërkesat e IFRS 9, duke përdorur modelin e humbjes së pritshme. Kjo përfshin ndarjen e debitorëve sipas periudhës së vonesës, historikut të pagesave dhe rrezikut të kreditit.	Ndërmarrja edhe në vitin 2025, nuk kishte aplikuar provizionimin për llogaritë e arkëtueshme tregtare.	Nuk ka filluar zbatimin
24.	Stoqet	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme që raporti i inventarizimit të jetë gjithëpërfshirës, si dhe të sigurojë që komisionet të bëjnë vetëm evidentimin e pasurive në ndërmarrje.	Nuk ishin marrë veprime nga ndërmarrja, si rrjedhojë rekomandimi nuk ishte zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

25.	Pasuritë afatgjata	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë së janë marr veprimet e nevojshme për trajtimin e çështjeve pronësore të ndërmarrjes dhe të përditësoj regjistrin e pasurisë me gjendjen aktuale duke prezantuar saktë dhe të drejtë pasurinë afatgjatë në pasqyra financiare.	Gjendja mbetet e njëjtë me vitin paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
26.	Pasuritë afatgjata	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë marrë veprimet e nevojshme për të përcaktuar një politike të menaxhimit të pasurive dhe zhvlerësimit të pasurive në përputhje me kërkesat e standardeve të kontabilitetit.	Ndërmarrja nuk kishte marrë veprime për implementimin e rekomandimit.	Nuk ka filluar zbatimi
27.	Pasuritë afatgjata	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që para miratimit të pasqyrave financiare vjetore, të kryhet një proces i detajuar i harmonizimit ndërmjet regjistrin analitik të pasurive dhe vlerës së tyre të prezantuar në pasqyrat financiare. Ky proces duhet të përfshijë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rishikimin e plotë të regjistrave të pasurive të kontabilitetit dhe krahasimin me pasqyrën e pozicionit financiar;</li> <li>• Identifikimin dhe korrigjimin e çdo mospërputhjeje në vlerat e pasurive afatgjata;</li> <li>• Vendorsjen e kontrolleve të brendshme për të siguruar që të dhënat e pasurive të jenë të përditësuara, të sakta dhe të mbështetura me dokumentacion përkatës.</li> </ul>	Ndërmarrja nuk ka rritur të evitohet shkaqet e diferencave.	Nuk ka filluar zbatimi
28.	Pasuritë afatgjata	Bordi Mbikëqyrës duhet të shqyrtoj mundësinë e rivlerësimit të pasurive të ndërmarrjes që të sigurohet se vlera e prezantuar e pasurive në pasqyra financiare nuk ndryshon materialisht nga vlera e drejtë në fund të periudhës raportuese. Po ashtu të bëhet një vlerësim profesional i vlerës dhe formës më profitabile për trajtimin të mbetjeve/sterilit për ndërmarrjen.	Për shkak të gjendjes financiare ndërmarrja nuk kishte arritur ta implementojë rekomandimin.	Nuk ka filluar zbatimi
29.	Detyrimet afatshkurta	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë krijimin e një regjistri të plotë me dëshmi relevante me rastin e regjistrimit të detyrimeve ndaj granteve me qëllim që prezantimi në pasqyra financiare të jetë i plotë dhe i saktë.	Rekomandimi nuk ishte implementuar.	Nuk ka filluar zbatimi
30.	Detyrimet afatshkurta	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme që obligimet tatimore të ndërmarrjes të harmonizohen me gjendjen e llogarive në ATK dhe të prezantohen saktë në pasqyrat financiare vjetore.	Ndërmarrja nuk ka arritur ti harmonizojë obligimet e prezantuara me gjendjen në ATK.	Nuk ka filluar zbatimi

31.	Detyrimet afatshkurta	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që janë bërë harmonizimet periodike të llogarive me klientët dhe gjithashtu të rishqyrtoj regjistrin e obligimeve në mënyrë që pasqyrat financiare të prezantojnë sa më saktë dhe drejt gjendjen e ndërmarrjes.	Përsëri janë identifikuar, diferenca dhe mos harmonizime për këtë kategori.	Nuk ka filluar zbatimin
32.	Shpenzimet operative	Bordi Mbikëqyrës duhet të sigurojë që personeli i angazhuar në menaxhimin e kontratave të ketë njohuri në përdorimin e platformës së e-prokurimit, dhe të aplikoj sistemin e-prokurimit në procesin e menaxhimit për të gjitha kontratat.	Ndërmarrja ka bërë menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës përmes platformës së e-prokurimit gjatë vitit 2025.	I zbatuar
33.	Shpenzimet e pagave	Bordi Mbikëqyrës të rishikoj rregulloren e brendshme dhe ti ndërmerr veprimet e duhura për sistematizim të punonjësve të ndërmarrjes për të siguruar që të gjitha pozitat që mbulojnë nga punonjësit të jenë të përcaktuara në rregulloren për sistematizim të vendeve të punës.	Ndërmarrja kishte aprovuar plotësimin e rregullorës për sistematizimin e vendeve të punës. Për më tepër rregulloret për sistematizim ishin në proces të rishikimit të plotë nga menaxhmenti.	I zbatuar
34.	Shpenzimet e pagave	Bordi Mbikëqyrës duhet të marrë masat e menjëhershme për shlyerjen e obligimeve ndaj punonjësve dhe ATK-së në mënyrë që të shmanget rritja e vazhdueshme e kostove shtesë që rrjedhin nga këto obligime, si dhe të trajtoj rastet e punëtorëve të pa deklaruar.	Në mungesë të mjeteve financiare, ndërmarrja nuk kishte arritur të paguante kontributet pensionale për punëtorët e saj.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Besim Lezi, Udhëheqës i ekipit



Besarta Rrahmani, Anëtare e ekipit



Arbresha Grainca, Anëtare e ekipit




## Shtojca I: Letër konfirmimi


**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Company**  
**Trepça Deoničarsko Društvo**

Nr. 5893 Data: 26.06.2026

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government



Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



---

**LETËR E KONFIRMIMIT**


Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe për zbatimin e rekomandimeve


Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Trepça sh.a, për vitin 2025 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe bashkëngjitur me këtë Letër të Konfirmimit gjeni komentet e menaxhmentit për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Shpetim Dobra  
Kryesues i Bordit Mbikëqyrës në Trepça Sh.A.,  


Data: 26. qershor 2025, Mitrovicë,  


Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mungesa e dokumentacionit mbështetës dhe llogaritja jo e saktë e të hyrave nga shërbimet	<p>Çështja e qerasë: Ka ndodhur një gabim teknik, i cili do të korrigjohet në vijim.</p> <p>Çështja e terminalit: Pajtohem me gjetjen e paraqitur nga Zyra Kombëtare e Auditimit lidhur me mospërputhjen e konstatuar në kalkulimin e të hyrave nga shërbimet e qëndrimit të automjeteve në Terminalin Doganor. Pas analizës dhe verifikimeve të brendshme të kryera nga ana jonë, është konstatuar se shuma e pa faturuar prej 1,830€ nuk është inkasuar nga ndërmarrja në asnjë formë, respektivisht nuk është pranuar as fizikisht në arkë dhe as përmes pagesës bankare. Nga analiza e detajuar e rastit është evidentuar se mospërputhja ka ardhur si rezultat i mënyrës së kalkulimit të bërë nga programi softuerik i menaxhimit të Terminalit Doganor, i cili gjatë gjenerimit të pagesës ka përlogaritur vetëm periudhën e qëndrimit që i përket vitit kalendarik 2023 dhe periudhën e vitit 2025, duke mos përfshirë në kalkulim periudhën e plotë të vitit kalendarik 2024. Si rezultat i këtij defekti në kalkulim, ka ardhur deri te faturimi i vlerës më të ulët sesa ajo që duhej të</p>	Gjetja qëndron, ndërmarrja ka dhënë detaje shtesë të rrethanave që ka ndikuar tek çështja e raportuar nga ekipa.

	<p>realizohet sipas kohëzgjatjes reale të qëndrimit të automjetit në terminal.</p> <p>Për sqarime dhe detaje më të hollësishme lidhur me këtë rast, ndërmarra ka përgatitur dhe ka përcjellë gjatë procesit të auditimit tek zyrtarët e Zyrës Kombëtare të Auditimit raportin me nr. protokolli 3200, të datës 15.04.2026, në të cilin janë paraqitur analizat, verifikimet dhe konstatimet lidhur me rastin konkret.</p>	
<p>Mbivlerësim i të hyrave nga shitja si pasojë e mosregjistrimit të faturave finale</p>	<p>Sa i përket rastit të DUD-it nr. R594 në vlerë prej 88,947 €, vlerësojmë se kalkulimi i paraqitur nuk e reflekton sakte mënyrën e mbylljes së lotit sipas kushteve të kontrates. Për këtë rast, loti nuk është trajtuar si tersi, por është mbyllur së bashku me dy eksportet e tjera bredna mujit të njejejt, ndërsa balanca përfundimtare është përcaktuar përmes faturës finale. Sipas dokumentacionit mbështetës, rezultati përfundimtar ka qenë në favor të Trepça Sh.A., ku diferenca sipas Credit Note ka rezultuar në shumën 9,509.92 USD, ose në xxxxx euro Për këtë arsye, konsiderojmë se ky rast duhet të rishqyrtohet bazuar në dokumentacionin e plotë të transaksionit, të cilin e kemi bashkëngjitur si dëshmi.</p> <p>Sa i përket rastit të DUD-it nr. R10528 në vlerë prej 560,734 €, duhej të ishte 560,794.16€ vlerësojmë se kalkulimi i</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të dërguar nga Trepça sh.a. për faturën R594 me vlerë 88,947€ (91,650.75\$) dhe faturën finale me nr. dokumenti 11/24-Zn/Tuneli, e cila ka vlerë 86,959.41\$. Nga krahasimi i këtyre dokumenteve është identifikuar një diferencë prej 4,691.34\$, e cila paraqet zvogëlim të vlerës së shitjes dhe nuk është regjistruar në librat kontabël dhe as nuk është pasqyruar në PFV të vitit 2025. Gjithashtu, për faturën R10528/2025 me vlerë 560,794€ (632,631.92\$) dhe faturën finale me nr. dokumenti 06/25-Pb/Tuneli në vlerë 572,425.60\$, është identifikuar diferencë prej 60,206.32\$. Edhe kjo diferencë është dashur të regjistrohet si zvogëlim i të hyrave nga shitja, por nuk është reflektuar në kontabilitet dhe në PFV. Diferencat që janë paraqitur nga ana juaj në mes faturave finale dhe pagesave lidhen me gjendjen/obligimin ndaj klientit</p>

	<p>paraqitur nuk e reflekton sakte sepse vlera përfundimtare ne USD 572,425.60 ose ne euro xxxx x</p> <p>Për këtë arsye, konsiderojmë se ky rast duhet të rishqyrtohet bazuar në dokumentacionin e plotë të transaksionit, të cilin e kemi bashkëngjitur si dëshmi.</p> <p>Lidhur me konstatimin për mosregjistrimin e notave të kreditit dhe debitit në librat e shitjes dhe në evidencat kontabël, sqarojmë se ndërmarra ka ndërmarra veprime në përputhje me rekomandimet e auditimit të vitit paraprak dhe ka kryer barazimet e nevojshme me ne formatin xls dhe ka ndejk hapat sipas rekomandimeve të ZKA.</p> <p>Megjithatë, procesi i shitjes së koncentratit paraqet specifika të veçanta, pasi vlera përfundimtare e shitjes përcaktohet vetëm pas pranimit të rezultateve finale të analizave, çmimeve të metale dhe elementeve të tjera të kontrates. Për shkak të këtyre specifikave, sistemi aktual i softwerit ende nuk mundëson automatizimin e plotë të të gjitha hapave të nevojshëm për mbylljen përfundimtare të faturave dhe regjistrimin korrigjimeve përkatëse.</p>	<p>dhe nuk janë pjesë e gjetjes për te cilën kemi konstatuar diferenca. Gjetja jonë lidhet vetëm me diferencat në mes dokumenteve doganore dhe faturave finale, të cilat nuk janë reflektuar në PFV të Trepça sh.a. Tabela e dërguar nga ana juaj nuk është reflektuar në regjistrat kontabël dhe për këtë arsye nuk është pasqyruar as në PFV. Prandaj, ajo nuk ndryshon konstatimin e auditimit.</p>
Trajtimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme të bartura nga vitet e kaluara dhe nënvlersim i	I. Lidhur me rastin e parë Ne vend borxhit eshte kompensim i demit material e cila eshte vepruar sipas dispozitave ligjore te ligjit per marrëdhënie detyrimore me nr.	Gjetja qendron, pasi sqarimi për nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar mosbartjen e borxheve të vjetra sipas SNK 8.

llogarive të arkëtueshme	<p>neni 169 ligji 04/L-077 për marrëdhënie te detyrimeve, shperblim i demit material me te holla.</p> <p>Lidhur me këtë rast I , sqarojmë se klienti në fjalë nuk ka pasur borxh të regjistruar ndaj Trepça Sh.A. për periudhat paraprake. I njëjti ka qene uzurpus- hapësirat e ndërmarrjes për një periudhë kohore pa pasur marrëveshje apo kontratë me Trepça Sh.A. Me kërkesë te Ndërmarrjes dhe në përputhje me procedurat dhe rregulloret në fuqi, ndërmarrja ka shpallur procedurë publike për dhënien me qira të hapësirës, nga e cila klienti është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës për tre vitet e ardhshme.</p> <p>Me rastin e lidhjes së kontratës, ndërmarrja ka vendosur si kusht që klienti të kompensojë edhe periudhën trevjeçare paraprake gjatë së cilës ka qe hapësira e uzurpuara / te shfrytezuara pa kontratë. Për këtë arsye, termi “borxh” i përdorur në kontratë mund të jetë jo adekuat, pasi nuk bëhet fjalë për një borxh të regjistruar paraprakisht në kontabilitet, por për faturim të kompensimit për shfrytëzimin e hapësirës në periudhën kur nuk ka ekzistuar marrëdhënie kontraktuale dhe asnje borgje I regjistruar me heret.</p> <p>Në zbatim të kontratës, klientit i lëshohen dy fatura mujore: një faturë për periudhën aktuale të shfrytëzimit sipas kontratës në fuqi dhe një faturë për</p>	
--------------------------	--	--

	<p>kompensimin e periudhës së kaluar gjatë së cilës hapësira është shfrytëzuar pa kontratë. Rrjedhimisht, vlerat e faturuara gjatë vitit 2025 përfaqësojnë të hyra të njohura në bazë të kontratës së lidhur në vitin 2025 dhe jo arkëtim të një borxhi të regjistruar nga vitet paraprake.</p> <p>II. Lidhur me rastin e dytë Lidhur me këtë rast, sqarojmë se klienti në fjalë nuk ka pasur borxh të regjistruar ndaj Trepça Sh.A. për periudhat paraprake. Klienti ka vazhduar të shfrytëzojë hapësirat e ndërmarrjes për një periudhë kohore pa pasur kontratë aktive me Trepça Sh.A., pasi për shkak të problemeve operative dhe teknike në terren nuk ishte bërë vazhdimi i kontratës paraprake. Me kërkesë të klientit dhe në përputhje me procedurat dhe rregulloret në fuqi, ndërmarrja ka shpallur procedurë publike për dhënien me qira të hapësirës. Si rezultat i kësaj procedure, klienti është shpallur fitues dhe ka lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës për tre vitet e ardhshme.</p> <p>Me rastin e lidhjes së kontratës, ndërmarrja ka vendosur të njëjtin kusht, respektivisht që klienti të kompensojë edhe periudhën trevjeçare paraprake gjatë së cilës ka shfrytëzuar hapësirën pa kontratë. Për këtë arsye, termi “borxh” i përdorur në kontratë mund të mos jetë adekuat, pasi nuk bëhet fjalë për një borxh të regjistruar</p>	
--	--	--

	<p>paraprakisht në kontabilitet, por për faturim të kompensimit për shfrytëzimin e hapësirës në periudhën kur nuk ka ekzistuar marrëdhënie kontraktuale dhe nuk ka ekzistuar asnjë borxh i regjistruar më herët.</p> <p>Në zbatim të kontratës, klientit i lëshohen dy fatura mujore: një faturë për periudhën aktuale të shfrytëzimit sipas kontratës në fuqi dhe një faturë për kompensimin e periudhës së kaluar gjatë së cilës hapësira është shfrytëzuar pa kontratë. Rrjedhimisht, vlerat e faturuara gjatë vitit 2025 përfaqësojnë të hyra të njohura në bazë të kontratës së lidhur në vitin 2025 dhe jo arkëtim të një borxhi të regjistruar nga periudhat paraprake.</p>	
<p>Mungesë e dëshmisë së regjistrimit sipas kërkesës së Ligjit të Prokurimit Publik</p>	<p>Pohimet janë të sakta.</p> <p>Për shkak të numrit të madh të zërave specifike, si dhe numrit të madh të anëtarëve të komisionit të përfshirë në proces, nuk jemi në gjendje të organizojmë trajnim për të gjithë në nivelin e duhur.</p> <p>Në periudhën e ardhshme do t'i kushtojmë më shumë vëmendje kësaj çështjeje.</p>	<p>Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen e auditimit.</p>
<p>Pranimi i softuerit pa verifikimin e përmbushjes së specifikave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe kontratë</p>	<p>Janë krijuar depot për lëvizjet e stoqeve. Jemi në proces të funksionalizimit të plotë të tyre.</p>	<p>Gjetja qëndron, dhe komenti sqaron nevojën për funksionalizimin e plotë të softuerit.</p>

Mos protokollimi i faturave në mënyrë zyrtare	Në përputhje me takimet e mëparshme, është përcaktuar procedura e pranimi të dokumenteve me të gjitha të dhënat e nevojshme, përfshirë edhe numrin unik protokollar. Në ditën e pranimi të dokumenteve, regjistri përmban të gjitha elementet formale të menaxhimit të dokumenteve.	Ndërmarrja ka konfirmuar se gjetja qëndron dhe rekomandimi do të implementohet.
Trajtim i pasaktë i shtesave për punonjësit si shpenzim dhe mospërfshirje në pagën bruto	E pranojmë vërejtjen e lartcekur dhe në të ardhmen do të veprojmë sipas gjetjes së dhënë.	Gjetja qëndron dhe ndërmarrja pranon marrjes e masave korrigjuese për rastin.
Kontrata të punës të punonjësve të Njësisë Kopaonik-Leposaviq të pa azhurnuara me ndryshimet ligjore	<p>Gjatë kontrollit kemi shpjeguar se procesi i harmonizimit të kontratave të punës së të punësuarve është në zhvillim e sipër dhe se kontratat e reja të punës lidhen në përputhje me legjislacionin pozitiv të Kosovës. Gjatë kontrollit të auditimit ju kemi dorëzuar një kopje të kontratës së përditësuar dhe të re të punës, e cila tani është në zbatim.</p> <p>Lidhur me gjetjen e auditimit se paga për gjithsej 19 të punësuar paguhet në arkë, ju njoftojmë se këtë vërejtje, përkatësisht këtë gjetje, e kemi eliminuar në pjesën më të madhe dhe kanë mbetur vetëm edhe 4 të punësuar të cilët nuk kanë hapur llogari në bankën përkatëse afariste. Konsiderojmë se edhe këtë gjetje do ta eliminojmë në afatin më të shkurtër të mundshëm.</p>	Gjetja qëndron dhe do ta vlerësojmë implementimin e rekomandimit në vazhdimësi.

<p>Mos prezantim i saktë i pasqyrës së rrjedhës së parasë gatshme dhe pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet</p>	<p>Te çështja e tokës është prezantuar në formë të Excel-it vlera totale e tokave, duke i përfshirë edhe të dhënat tjera relevante sipas Njesisë Kadastrale. Diferenca është paraqitur vetëm për të dhënat rezultativë final, pasi sipas informatave të disponueshme, në të kaluarën nuk ka ekzistuar një listë e tillë, të cilën po juaj përcjell bashkëngjitur.</p>	<p>Gjetja qëndron dhe ndërmarrja në komentimin e paraqitur nuk ka ofruar diçka që kundërshton qëshmtjen e prezantuar në raport.</p>
<p>Mosregjistrim i plotë i pasurive dhe mungesë e dokumentacionit mbështetës</p>	<p>Njësia afariste Kopaonik Leposaviq ka realizuar procesin e regjistrimit të pasurisë në përputhje me dokumentacionin e regjistrimit që posedonte nga periudha e mëparshme. Vlera e parcelave kadastrale nuk është paraqitur, pasi objektivisht kjo njësi afariste nuk kishte mundësi reale për këtë, përkatësisht nuk kishte qasje në të dhënat kadastrale. Theksojmë se është në zhvillim e sipër procesi i harmonizimit dhe përcaktimit të këtyre të dhënave me kolegët e njësive të tjera afariste të Trepça Sh.A., të cilët kanë qasje në këto të dhëna. Presim që deri në fund të vitit të përfundojë ky proces.</p>	<p>Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen dhe ka paraqitur nevojën për marrjen e masave të koordinuara me të gjitha njësitë.</p>
<p>Mangësitë lidhur me zhvlerësimin e pasurive</p>	<p>Është sqaruar çështja e zbatimit të metodës së llogaritjes së amortizimit të pasurisë. Konkretisht, Njësia afariste Kopaonik Leposaviq ka zbatuar normat e amortizimit në përputhje me rekomandimet e PAK-ut. Pas sqarimit të bërë, është pranuar gjetja që në të ardhmen amortizimi të llogaritet në përputhje me Standardet</p>	<p>Gjetja qëndron dhe ndërmarrja do të marr veprime për implementimin e rekomandimit.</p>

	Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).	
Mos përputhje e vlerës së pasurive në mes regjistrimit analitik dhe pasurive të prezantuar në pasqyra financiare	Kopaonik Leposaviq në raportin e vet financiar ka paraqitur dhe u ka dorëzuar auditorëve raportin mbi gjendjen e stoqeve të produkteve të gatshme në depo sipas llojit, sasisë dhe vlerës.	Çështja kryesisht lidhet me njësitë tjera dhe nuk ka të bëjë me raportete financiare të Njesisë Kopaonik Leposaviç.
Mos përjashtimi i transaksioneve brenda njësive gjatë konsolidimit financiar	Në takim është sqaruar se pasqyrat financiare të konsoliduara nuk mund të përfshijnë kërkesat e ndërsjella ndërmjet njësive organizative të së njëjtës kompani. Edhe pse është e padiskutueshme se kërkesat e Trepça-Veri ndaj Trepça-Jug janë harmonizuar, vulosur dhe pranuar nga të dyja palët, është konstatuar se është e nevojshme të bëhet trajtimi i duhur kontabël i tyre në procedurën e konsolidimit financiar.  Është konstatuar se duhet të formohet një komision i veçantë, i cili do të propozojë mënyrën dhe dinamikën e shlyerjes së detyrimit të Trepça-Jug ndaj Trepça-Veri.	Gjetja qëndron, ekipa nuk ka kontestuar obligimet ndaj Njesisë Kopaonik Leposaviç, por vetëm prezantimin në formatin e konsoliduar të pasqyrave financiare.
Mos harmonizimi i detyrimeve afatshkurtra ndërmjet shënimeve kontabël dhe PFV	Lidhur me mosharmonizimin e detyrimeve afatshkurtra, mbetemi pranë shpjegimit që ju kemi dhënë në emailin e mëparshëm dhe drejtpërdrejt gjatë kontrollit.	Gjetja qëndron dhe lidhet më të gjitha njësitë e Trepça Sh.a.
Mangësi në procedurat e transferimit të punonjësve	Vendimet e marra nga Kryeshefi Ekzekutiv lidhur me transferet dhe sistemimet e punonjësve, në shumicën e rasteve janë nxjerrë duke u bazuar në kërkesat e Udhëheqësve të Njësive Biznesore përkatëse, në	Komenti i ndërmarrjes nuk adreson thelbin çështjes. Gjetja qëndron dhe kërkon veprime për azhurnimin e kontratave varësisht nga pozita e punës ku punonjësit transferohen.

	<p>përputhje me dispozitat e Rregullores për Marrëdhënie Pune në Trepça Sh.A., me nr. protokolli 2907, datë 30.07.2020. Sipas Statutit të Trepça Sh.A., konkretisht nenit 22, paragrafi 3, përcaktohet qartë se organizimi i shoqërisë, si dhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi, realizohen nga Kryeshefi Ekzekutiv në përputhje me Statutin dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për rrjedhojë, në rastet kur Udhëheqësit e Njësive Biznesore kanë paraqitur kërkesa të arsyetuara lidhur me nevojat operacionale dhe organizative të njësive përkatëse, Kryeshefi Ekzekutiv, në ushtrim të kompetencave të tij statutare dhe ligjore, ka nxjerrë vendimet përkatëse për transferimin dhe sistemimin e punonjësve në pozitat përkatëse të punës, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së procesit të punës dhe realizimit efikas të veprimtarisë së ndërmarrjes. Sa i përket çështjes së nivelit të pagës, ju njoftojmë se në Trepça Sh.A. pagat, detyrat dhe përgjegjësitë e punës përcaktohen në bazë të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës. Për këtë arsye, në rastet e transferimit ose sistemimit, niveli i pagës përcaktohet sipas pozitës në të cilën punonjësi është sistemuar dhe jo sipas pozitës së mëparshme. Po ashtu, lidhur me këtë çështje ekziston edhe praktikë gjyqësore përkatëse, ku me aktgjykim të Gjykatës</p>	
--	--	--

	Themelore në Mitrovicë është vlerësuar se Trepça Sh.A. ka vepruar në përputhje me dispozitat e rregulloreve në fuqi kur paga e punonjësit është përcaktuar sipas pozitës së sistematizuar dhe koeficientit përkatës të asaj pozite. Prandaj, pretendimet se transferimet ose sistemimet janë kryer në kundërshtim me dispozitat e brendshme të ndërmarrjes nuk qëndrojnë, pasi të gjitha veprimet janë ndërmarrë në kuadër të kompetencave të Kryeshefit Ekzekutiv dhe në përputhje me aktet statutare, ligjore dhe nënligjore në fuqi.	
Prezantim jo i plotë dhe i saktë i shënimeve shpjeguese	Konsiderojmë se këtë rekomandim mund ta zbatojmë pas konsultimit paraprak me auditorin shtetëror dhe auditorin e brendshëm.	Ndërmarrja pajtohet me gjetjen.
Mospërbushja e kriterëve të përshtatshmërisë profesionale	Për shkak të kufizimeve të tregut dhe mungesës së konkurrencës për këtë lloj punësh (punime minerare), jemi të detyruar t'u përshtatemi ofertave të pranuar, përkatësisht mundësive dhe kapaciteteve të ofertuesve, duke pasur parasysh interesin më të mirë të kompanisë.	E gjetura qëndron, Ndërmarrja ka dhënë arsyetime në lidhje me gjetjen.
Mungesa e dokumentimit të certifikimit të pagesave nga zyrtari certifikuesi	Vërejtja është pranuar dhe është zbatuar.	Ndërmarrja pajtohet me gjetjen.
Funksionimi i njësisë "Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviç", jo në përputhje me kërkesat ligjore	Janë eliminuar vërejtjet lidhur me pikën B24. Është vendosur dhe harmonizuar sistemi i raportimit financiar, si dhe sistemi i informimit lidhur me raportin e prodhimit, i cili	Në qështjen e përshkruar në raport kemi potencuar se ka filluar implementimi I disa pikave nga rekomandimi i vitit paraprak që lidhen me qështjen, por që mbeten edhe disa pika që duhet

	përfshin edhe nxjerrjen e xehes dhe procesin e flotacionit, përkatësisht procesin e prodhimit. Aktivitetet e prokurimit dhe shitjes zhvillohen nën personin juridik Trepça Sh.A. – Minierat me Flotacion Kopaonik – Leposaviq, gjë që mund të shihet edhe në portalin e prokurimit publik.	të implementohen në periudhen vijuese që janë prezantuar në raport.
Mungesa e rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes	Në bashkëpunim me auditorin e brendshëm të Trepça Sh.A. po zhvillohet procesi i standardizimit të të gjitha akteve të përgjithshme.	Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen dhe ka prezantuar hapat për implementimin e rekomandimit.
Mos pagesa e kontributeve dhe tatimit në pagë për punëtorët	Sa i përket të punësuarve që nuk kanë llogari bankare, theksojmë se kjo vërejtje në thelb është realizuar. Nënvizojmë se nga numri i përgjithshëm i punëtorëve kanë mbetur vetëm edhe 4 të punësuar që ende nuk kanë arritur të hapin llogari bankare. Presim që edhe ky problem të zgjidhet në afatin më të shkurtër.  Lidhur me çështjen e pagesës së kontributeve, ju rikujtojmë se kemi dhënë shpjegim përmes komenteve në raportin e auditimit për vitin 2024.	Ndërmarrja është pajtuar me gjetjen dhe ka sqaruar se është në proces të implementimit të rekomandimit.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- <sup>2</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

**Trepça Shoqëri Aksionare**  
**Trepça Joint Stock Company**  
**Trepça Deonitarsko Društvo**

Nr. 3848 Data: 05.05.2026  
Mitrovicë Mitrovicë

**"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

**Raporti i përpilimit i praktikuesit**

**Pasqyrat Financiare**  
**për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025**

---

**Prishtinë, Mars 2026**

## **PËRMBAJTJA**

## **FAQE**

RAPORTI I PËRPILIMIT I PRAKTIKUESIT	3
DEKLARATA E PAJTUESHMËRË	5
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	6
PASQYRA TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	9
SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE	10 - 29



**ProAudit**

Tel: +383 44 126 395

Email: [proaudit34@gmail.com](mailto:proaudit34@gmail.com)

## Raporti i përpilimit i praktikuesit (kontabilistit të çertifikuar)

### Për Menaxhmentin e shoqërisë "Trepça" SH.A. - Mitrovicë

Ne kemi përpiluar pasqyrat financiare shoqëruese të shoqërisë "Trepça" SH.A., në bazë të informacionit që ju keni dhënë. Këto pasqyra financiare përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar të "Trepça" SH.A., për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e fluksit të parave për vitin e përfunduar, si dhe një përmbledhje të rëndësishme të politikave të kontabilitetit dhe të tjera informacion shpjegues.

Ne e kemi kryer këtë angazhim përpilimi në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Sherbime të Lidhura 4410 - Angazhime Përpilimi, sipas kontratës titull "*Rishikimi dhe përgatitja e pasqyrave financiare për Trepça sh.a.*", më numer të prokurimit: 1299 12998-25-9336-2-3-6. Ne kemi aplikuar ekspertizën tonë në kontabilitet dhe raportim financiar për t'ju ndihmuar në përgatitjen dhe prezentimin e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ne kemi përmbushur kërkesat në përputhje me Kodin e Etikës për Profesional Kontabilistët e lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (Kodi IESBA). Parimet etike që rregullojnë llogaritarin përgjegjës të profesionale për këtë lloj angazhimi janë:

- (a) Integriteti;
- (b) Objektiviteti;
- (c) Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur;
- (d) konfidencialiteti;
- (e) sjellja profesionale; dhe
- (f) Standardet teknike.

"Pavarësia nuk është një kërkesë për një angazhim përpilimi. Megjithatë, kur kontabilisti nuk është i pavarur, një deklaratë për këtë qëllim do të ishte bërë në raportin tonë". Këto pasqyra financiare, saktësia dhe plotësia e informacionit të përdorur për përpilimin e tyre janë përgjegjësi e menaxhmentit.

Meqenëse një angazhim përpilimi nuk është një angazhim sigurie, ne nuk jemi të detyruar të verifikojmë saktësinë ose tërësinë e informacionit që na keni dhënë për të përpiluar këto pasqyra financiare. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion të auditimit ose një përfundim të rishikimit nëse këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me SNRF.

- Theksojme se PVF-të e shoqërisë "Trepça" SH.A., janë raportuar duke konsideruar transaksionet financiare të njëjësive jugore dhe veriore, ku te kjo e fundit kemi patur kufizime në fushveprim.



## ProAudit

Tel: +383 44 126 395

Email: [proaudit34@gmail.com](mailto:proaudit34@gmail.com)

- Sic është shpalosur në *shënimin 4 – Prona, Pajisjet dhe Impiantet*, shoqëria ka raportuar shumat sipas kostos historike, pa zbatuar kërkesat e SNK 16 për rivlerësimin e aseteve. Për më tepër, mungesa e shënimeve analitike ka pamundësuar raportimin e drejtë dhe të plotë të pasurive.
- Mungesa e shënimeve të detajuara lidhur me detyrimet rrjedhëse si rrjedhoj e deklarimeve të përgjithshme tek ATK (përfshir njësit veri) dhe çështjet e tjera, mund të reflektojë në PVF-të për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025.
- Në shënimin 10 – Te hyra te shtyera, theksojmë mungesën e shënimeve analitike dhe dokumenteve burimore.
- Theksojmë që në keto pasqyra janë të përfshiera edhe pasqyrat financiare per Njësine e veriut ku potencojmë që gjatë procesit kemi patur qasje të kufizuar ne dokumentacion, si rrjedhoj kemi rezerva në këtë proces.

Pranuar në emër të " ProAudit " SH.P.K.

z. Besnik Kaleci, Kontabilist i Çertifikuar



ProAudit

SH.P.K.

Adresa: Rr. Behar Begolli,  
Linda Premium, 10 000 Prishtinë

Prishtinë, më  
25 mars 2026

**"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

## **DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË**

**Emri i biznesit:** "TREPÇA" SH.A. - MITROVICË

**Adresa:** Trepça Parku Industrial Mitrovicë, p.n.

**NUI:** 811278747

### **Deklaratë e Pajtueshmërisë**

Për pasqyrat financiare që përfundojnë më 31.12.2025, deklaroj që pasqyrat financiare për vitin raportues 2025 paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare, rezultateve të operacioneve, dhe rrjedhave të parasë dhe që pasqyrat financiare janë përgatitur në pajtim me të gjitha kërkesat e *Ligjit 06/L- 032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim.*

Drejtor Ekzekutiv



Drejtor Financiar



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

	Notes	31-Dec-25	31-Dec-24
<b>Pasuritë</b>			
Prona, Paisjet dhe Impiantet	4	559,729,179	323,063,504
<b>Pasuritë afatgjata</b>		<b>559,729,179</b>	<b>323,063,504</b>
Stoku	5	29,939,061	29,654,353
Llogaritë e arketueshme dhe te tjera	6	9,646,647	8,063,527
Pasuri tjera afateshkurtera	7	1,443,478	1,033,071
Paraja në dorë dhe në bankë	8	255,677	628,349
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurta</b>		<b>41,284,863</b>	<b>39,379,300</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>601,014,042</b>	<b>362,442,804</b>
<b>Detyrimet dhe kapitali aksionar</b>			
Detyrimi ndaj kredise dhe mbiterheqjes			
Grantet dhe të hyrat e shtyra	9	3,071,409	2,943,690
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>3,071,409</b>	<b>2,943,690</b>
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	10	13,785,353	13,187,776
Detyrimi tjera afateshkurtera	11	22,955,679	21,105,679
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurta</b>		<b>36,741,032</b>	<b>34,293,455</b>
<b>Gjithsej Detyrimet</b>		<b>39,812,440</b>	<b>37,237,145</b>
Kapitali aksionar	SCE	596,084,306	358,711,927
Fitimi i Mbajtur	SCE	(34,882,704)	(33,506,268)
Fitimi/Humbja e vitit			
<b>Ekuiteti</b>		<b>561,201,602</b>	<b>325,205,659</b>
<b>Gjithsej kapitali dhe detyrimet</b>		<b>601,014,042</b>	<b>362,442,803</b>



**Faton Ahmeti**  
Kryeshef Ekzekutiv



**Arian Berisha**  
UD Zyrtar Kryesor Financiar dhe  
Thesarit

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**PASQYRA E TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE**

		Më 31 dhjetor 31-12-2025	Më 31 dhjetor 31- 12-2024
	Notes		
Te hyrat	12	22,052,759	15,325,725
KMSH	13	(23,708,001)	(19,685,991)
<b>Fitimi Bruto</b>		<b>(1,655,241)</b>	<b>(4,360,266)</b>
Shpenzimet e personelit	15	(3,013,040)	(5,885,635)
Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative	16	(1,061,670)	(2,071,362)
Shpenzimet operative	17	(2,485,266)	(843,049)
Te hyrat tjera	14	7,089,888	12,265,246
<b>Gjithsej shpenzimet</b>		<b>(6,559,976)</b>	<b>(10,212,068)</b>
Shpenzimet e zhvleresimit		(1,069,829)	(1,412,022)
<b>Fitimi operativ</b>		<b>(2,195,159)</b>	<b>(2,307,087)</b>
Shpenzimet e interesit			-
<b>Fitimi/ Humbja para tatimit</b>		<b>(2,195,159)</b>	<b>(2,307,087)</b>
Tatimi			
<b>Fitimi/ Humbja e vitit</b>		<b>(2,195,159)</b>	<b>(2,307,087)</b>
<b>Te Ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
Fitimi ose humbja nga rivlersimi I pasurive afategjata			
Fitimi ose humbja nga kursi i kembimit		(38,528)	
Fitimi ose humbja nga instrumentet financiare ne kapital			
<b>Gjithsejt te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse</b>		<b>(2,233,687)</b>	<b>(2,307,087)</b>

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

**“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL PËR PERIU DHËN E PËRFUNDUAR  
MË 31 DHJETOR 2025**

	<b>Kapitali Aksionare</b>	<b>Fitimet e mbajtura</b>	<b>Rezervat tjera</b>	<b>Total</b>
<b>Më 01 Janar 2023</b>	<b>10,000</b>	-	-	<b>10,000</b>
Kapitali aksionar-Deponimet	357,885,487	-		357,885,487
Fitimi/Humbja e vitit		(1,771,937)		(1,771,937)
Fitimi i akumuluar		(29,427,246)		(29,427,246)
Dividenta				-
<b>Më 31 Dhjetor 2023</b>	<b>357,895,487</b>	<b>(31,199,183)</b>	-	<b>326,696,304</b>
<b>Më 01 Janar 2024</b>	<b>357,895,487</b>	<b>(31,199,183)</b>	-	<b>326,696,304</b>
Kapitali aksionar-Deponimet	816,440			816,440
Fitimi/Humbja e vitit		(2,307,085)		(2,307,085)
Fitimi i akumuluar				-
Dividenta				-
<b>Më 31 Dhjetor 2024</b>	<b>358,711,927</b>	<b>(33,506,268)</b>	-	<b>325,205,659</b>
<b>Më 01 Janar 2025</b>	<b>358,711,927</b>	<b>(33,506,268)</b>	-	<b>325,205,659</b>
Korigjim i PFV nga viti 2024		857,252		
Kapitali aksionar-Deponimet				-
Korigjim/ PFV	237,372,379	-		237,372,379
Fitimi/Humbja e vitit		(2,233,687)		(2,233,687)
Fitimi i akumuluar				-
Dividenta				-
<b>Më 31 Dhjetor 2025</b>	<b>596,084,306</b>	<b>(34,882,703)</b>	-	<b>560,344,350</b>

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare*

**"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

**PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË**

<i>Notes</i>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:</b>		
<b>Fitimi/Humbja neto</b>	(2,233,687)	(2,307,087)
<i>Rregullimet për:</i>		
Zhvlerësimi	1,069,829	1,412,022
Te hyra nga grandet dhe subvencionet	(526,236)	
Provisionet		
<b>Humbja/Fitimi operative para ndryshimeve në kapitalin punues</b>	<b>(1,690,093)</b>	<b>(895,065)</b>
Pasuri tjera afateshkurtera	(410,407)	85,653
Stoqet	(284,708)	1,556,888
Rritje në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	(1,583,120)	282,487
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe akrualet	597,577	1,645,736
Detyrimet e tjera afatshkurtera	1,850,000	528,816
Interesi i paguar		85,138
Tatimi në fite ardhura i pagueshem	-	
<b>Paraja neto nga aktivitetet operative</b>	<b>(1,520,751)</b>	<b>3,289,653</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive:</b>		
Shitja e prones, pajisjeve dhe impianteve	653,954	(1,000,355)
Blerja e prones, pajisjeve dhe impianteve	(363,127)	
Rritja prej investimeve		
<b>Paraja neto nga aktivitetet investive</b>	<b>290,827</b>	<b>(1,000,355)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese:</b>		
Ndryshimi në kapital	-	(2,777,144)
Transakionet me pronaret		816,440
Pagesa për renten minerale	-	-
Huazime, lizing dhe të tjera / Te hyra te shtyera	-	-
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare</b>	<b>-</b>	<b>(1,960,704)</b>
<b>Rritja/zvogëlimi neto në para dhe ekuivalentët e saj</b>	<b>(1,229,925)</b>	<b>328,594</b>
Korigjimi	857,252	-
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	628,349	299,755
<b>Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit</b>	<b>255,677</b>	<b>628,349</b>
	255,677	628,349

*Shënimet shoqëruese nga 1 deri 18 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.*

## "TREPÇA" SH.A. - MITROVICË

Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat janë në Euro)

### SHËNIME SHPJEGUESE DHE POLITIKAT KONTABËL

#### 1. TË PËRGJITHSHME

"Trepça" SH.A. është një shoqëri aksionare që u regjistrua në agjencinë e regjistrimit të bizneseve në Kosovë më 08/03/2019 me numrin unik identifikues 811278747. Zyra qendrore e kompanisë është e vendosur në Mitrovicë, Trepça Parku Industrial Mitrovicë, p.n.

#### Pronar/ Aksionarë

Qeveria e Republikës së Kosovës	8,000.00 €	80.00 %
Punëtorët e Trepçës	2,000.00 €	20.00 %

#### Njësitë

Numri i Njesisë	Emri i Njesisë	Kodi	Vendi
5237742	Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg	729	Stantërg
5237769	Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë	729	Graçanicë
5237777	Minierat me Flotacion Kopaonik - Leposaviç	729	Mitrovicë Veriore
5237785	Metalurgjia e Plumbit	2443	Mitrovicë Veriore
5237793	Metalurgjia e Zinkut	2443	Mitrovicë
5237807	Industria Kimike	2015	Mitrovicë
5237815	Fabrika e Akumulatorëve në Mitrovicë	2720	Mitrovicë
5237823	Fabrika e Pajimeve të Procesit	2573	Mitrovicë
5237831	Stabilimentet Energjetike (Energjetika)	3513	Mitrovicë
5237858	Laboratori në Zveçan	7120	Mitrovicë Veriore
5237866	Instituti i Plumbit dhe Zinkut	7120	Mitrovicë
5237874	Kompleksi Administrativ i Kishnicës në Prishtinë	8411	Prishtinë
5237882	Kompleksi Administrativ në Zveçan	8411	Mitrovicë Veriore

Aktivitete e kompanisë sipas Agjencisë së Regjistrimit të biznesve në Kosovë (ARBK):

Kodi	Përshkrimi	Tipi
729	Nxjerrja e xeheve të tjera jo-hekuri	Aktiviteti kryesor i biznesit
811	Nxjerrja e gurit dekorativ dhe të ndërtimit, gurit gëlqeror, gjipsit, shkumësit dhe rrasave	Aktiviteti sekondar

*Dhe Aktivitetet tjera sipas ARBK:*

*Me 31 dhejtor 2025 kompania kishte 1023 punëtorë, ndërsa gjatë vitit 2024 kishte mesatarisht 1220 punëtorë.*

## **2. Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara të Raportimit Financiar Ndërkombëtarë**

Kompania ka zbatuar të gjithë Standardet dhe Interpretimet e Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('IASB') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Çdo standard ose interpretim i kontabilitetit i ri ose i ndryshuar që nuk është ende i detyrueshëm nuk është miratuar më herët. Zbatimi i këtyre standardeve dhe interpretimeve nuk kishte ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Kompanisë.

- Ndryshimet në SNRF 3 Referenca te Korniza Konceptuale
- Ndryshimet në SNK 16 Prona, Impiantet dhe pajisje - Të ardhurat para përdorimit te percaktuar
- Ndryshimet në SNK 37 Kontratat e komplikuara - Kostoja e permbushjes se një Kontrate

**2.1** Standardet e reja, rishikimet dhe interpretimet nuk pritet të kenë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar.

## **3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT**

### **3.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë të përgatitura në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("IFRS").

### **3.2 Baza e përgatitjes**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur sipas parimit të kostos historike siç është shpjeguar më poshtë në politikat e kontabilitetit.

Kostoja historike është e bazuar në përgjithësi në shumën e dhëne në këmbim të pasurisë.

Këto janë pasqyra financiare individuale te organizatës qe synojnë te përdoren kryesisht për përmbushjen e raportimeve statutore. Organizata duhet te përgatisë pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat nuk janë ne dispozicion e datën e këtij raporti. Këto pasqyra financiare individuale munde te mos jen te përshtatshme për t'u përdorur për qëllime te përgjithshme nëse nuk lexohen se bashku me Pasqyrat Financiare te Konsoliduara.

### **3.3 Supozimi i parimit të vijimësisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijimësisë.

### **3.4 Valuta funksionale dhe prezentimit**

## **“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

### **Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

Valuta funksionale dhe raportuese e Kompanisë është euro (EUR) e cila është në pajtueshmëri me rregullativat e Unionit Monetar Europian dhe udhëzimet e lëshuara nga Banka Qendrore e Kosovës, valuta euro është adoptuar si valutë e vetme legale në territorin e Kosovës që nga 1 janari 2002.

Pasqyrat financiare janë përgaditur për vitet e përfunduara më 31 dhjetor 2025 dhe 31 dhjetor 2024 (krahasues). Të dhënat aktuale dhe krahasuese të deklaruara në këto pasqyra financiare janë të shprehura në mijëra euro, përveç nëse kërkohet të janë të shprehura ndryshe. Sipas nevojës, figurat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet e prezantimit për vitin.

#### **3.5 Transaksionet në valutë të huaj**

Transaksionet e denominuara në valuta ndryshe nga euro janë të regjistruara në kursin e këmbimit që vendoset në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit që vijnë nga shlyerja e transaksioneve në monedhë të ndryshme nga euro, përfshihen në fitimin ose humbjen duke përdorur kursin e këmbimit që vendoset në atë datë.

Pasuritë dhe detyrimet të valutës monetare ndryshe nga euro përkthehen me kursin e këmbimit të tregut të mesëm në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në kurset e këmbimit pas datës së transaksionit njihen në fitim ose humbje pasi përkthimi i këmbimit valutor fiton më pak humbje.

#### **3.6 Prona, impiantet dhe paisjet**

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë paraqitur sipas kostos minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet.

Kosto përfshinë shpenzimet të cilat i atribuohen direkt blerjes së pasurisë.

Kur pjesët e një zëri të pronësimianteve dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të përdorimit ato trajtohen si zëra të veqant.

Kostot e mëvonshme përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose njihen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera i ngarkohen fitimit ose humbjes gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

Zhvlerësimi në pasuritë është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të shpërndarë kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar, si vijon:

<b>Përshkrimi</b>	<b>Norma vjetore</b>
Ndertesa dhe struktura ndertimore	20 vite
Automjete Transporti dhe paisje	5 dhe 10 vite

Vlera e mbetur e pasurive dhe jeta e përdorimit janë rishikuar dhe rregulluar nëse ka qenë e përshtatshme, në secilën datë të pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimet dhe humbjet nga shitja

janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitim ose humbje.

### **3.7 Pasuritë e paprekshme**

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të kufizuar të cilat fitohen veçmas, mbarten me kosto zvogëluar amortizimin e akumuluar dhe humbje të akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet mbi baza lineare gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar.

Jeta e dobishme dhe metoda e amortizimit rishikohen në fund të çdo periudhe raportimi, me efektin e çdo ndryshimi në vlerësim, të cilat llogariten mbi bazën e ardhshme.

Pasuritë e paprekshme me jetë të dobishme të papërcaktuar që janë fituar veçmas, mbarten me kosto zvogëluar humbjet e akumuluar nga dëmtimi.

### **3.8 Mosnjohja e pasurive të paprekshme**

Një pasuri e paprekshme nuk njihet në shitje ose kur nuk priten përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi ose shitja. Fitimet ose humbjet që rrjedhin nga çregjistrimi i një pasurie të paprekshme, maten si diferenca midis fitimit të asgjësimit neto dhe vlerës së mbartur të pasurisë, njihen në fitim ose humbje kur pasuria është çregjistruar.

### **3.9 Dëmtimi i pasurive jo - financiare**

Në secilën datë të raportimit, Kompania rishikon vlerat kontabël të pronës, impianteve dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme për të përcaktuar nëse ka ndonjë indikacion që ato pasuri kanë pësuar një dëmtim nga humbjet. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet të përcaktojë masën e humbjes së dëmtimit (nëse ka). Kur pasuria nuk gjeneron fluks të parave që janë të pavarura nga pasuritë e tjera, Kompania vlerëson shumën e rikuperueshme të njësisë gjeneruese të parave të cilës i përket pasuria. Kur mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme e alokimit, pasuritë e korporatave u shpërndahen edhe njësisive individuale të gjenerimit të parave, ose përndryshe ato shpërndahen në grupin më të vogël të njësisive gjeneruese të parave për të cilat mund të identifikohet një bazë e arsyeshme dhe e qëndrueshme të alokimit.

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se vlera e drejtë minus kostot e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e parashikuara të parave zbriten në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe rreziqet specifike për pasurinë për të cilin vlerësimet e flukseve të ardhshme të parave nuk janë rregulluar.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie (ose njësi gjeneruese të parave të gatshme) vlerësohet të jetë më e vogël se vlera e tij kontabël, vlera kontabël e pasurisë (ose njësia gjeneruese e parave të gatshme) zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje, përveç nëse pasuria përkatëse mbahet me një shumë të rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si një rivlerësim dhe në atë masë që humbja e dëmtimit është më e madhe se teprica e rivlerësimit të lidhur, humbja e tepërt nga dëmtimi njihet në fitim ose humbje.

Kur një humbje nga dëmtimi shfuqizon më pas, vlera kontabël e një pasurie (ose njësisia gjeneruese e parave të gatshme) është rritur në vlerësimin e rishikuar të shumës së rikuperueshme të tij, por në mënyrë që vlera e shtuar kontabël të mos kalojë vlerën kontabël që do të ishte përcaktuar nuk do të kishte asnjë humbje nga dëmtimi që do ishte njohur për pasurinë (ose njësinë gjeneruese të parave të gatshme) në vitet e mëparshme. Një kthim i humbjes nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim ose humbje në atë mënyrë që eliminon humbjen nga dëmtimi i cili është njohur për pasurinë në vitet e mëparshme. Çdo rritje më të madhe se kjo shumë është trajtuar si një rritje të rivlerësimit.

### **3.10 Asetet dhe detyrimet financiare**

Kompania klasifikon investimet e saj në kategoritë e mëposhtme: asetet financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, huave dhe llogarive të arkëtueshme, të mbajtura deri në maturim asetet financiare dhe asetet në dispozicion për shitje financiare. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilën investimet janë të fituara. Menaxhimi i përcakton klasifikimin e investimeve të saj në njohjen fillestare dhe rivlerëson këtë në çdo datë raportimi.

#### *a) Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes*

Kjo kategori ka dy nën-kategori: asetet financiare të mbajtura për tregtim dhe atyre të përcaktuar në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në fillim. Një aset financiar klasifikohet në kategorinë e "aseteve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes" në fillim nëse është përfituar kryesisht për qëllim të shitjes në afat të shkurtër, nëse ajo është pjesë e një portofoli të asetëve financiare në të cilat ka prova afatshkurtër fitim-marrjen, ose në qoftë se kështu i caktuar nga Menaxhmenti. Kompania nuk ka asetë të klasifikuara në këtë kategori.

#### *b) Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme*

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme janë jo-derivative asete financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv, përveç atyre që kompania synon të shesë në afat të shkurtër ose ajo i ka përcaktuar si me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes apo në dispozicion për shitje. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pastaj me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, duke zbritur provizionet për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të huave dhe llogarive të arkëtueshme është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale.

Shuma e mbartur e aktivitetit ulet nëpërmjet përdorimit të një llogarie provizioni, dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pakthyeshme, ajo shlyhet kundër llogarisë së provizionit të arkëtueshmeve tregtare. Ri kthimet pasuese të shumave të shlyera më parë kreditohen në fitim ose humbje.

#### *c) Asetet financiare të mbajtura deri në maturim*

Asetet financiare të mbajtura deri në maturim janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse të tjera përveç atyre që plotësojnë përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshme që Menaxhmenti i kompanisë ka qëllimin pozitiv dhe

## **“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

### **Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

aftësinë për të mbajtur deri në maturim. Këto asete njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit, duke zbritur provizionet për zhvlerësim. Një dispozitë për zhvlerësim të letrave me vlerë të borxhit të mbajtura deri në maturim është krijuar kur ka evidencë objektive që Kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat në përputhje me kushtet e tyre origjinale.

#### *d) Asetet financiare të vlefshme për shitje*

Asete financiare në dispozicion për shitje janë asete financiare jo-derivative që janë të përcaktuara në këtë kategori apo nuk janë të klasifikuara në asnjë prej kategorive të tjera. Kompania nuk ka asete të klasifikuara në këtë kategori.

##### *- Njohja fillestare dhe mosnjohja*

Rregullt-mënyrë blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit - data në të cilën Kompania kryen për të blerë ose shitur aktivin. Aktivet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha aktiveve financiare nuk kryhen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e tyre. Aktivet financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbje të njihen fillimisht me vlerën e drejtë, dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në fitim ose humbje.

Aktivitetet financiare nuk njihen kur e drejta për të marrë flukset monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ata janë transferuar dhe kompanisë ka transferuar edhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë.

##### *- Matjet e mëpasshme*

Asetet financiare në dispozicion për shitje dhe asete financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes maten me pas me vlerën e drejtë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe asetet financiare të mbajtura deri në maturim mbahen në koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet e realizuar dhe të parealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të kategorisë së “aseteve financiare në vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes” janë të përfshira në fitim ose humbje në periudhën në të cilën ato arrijnë. Fitimet e parealizuara dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave jo-monetare të klasifikuara si të disponueshme për shitje njihen në kapitalin neto.

Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të disponueshme për shitje janë shitur ose dëmtuar, rregullimet e vlerës së drejtë të akumuluar janë të përfshira në fitim ose humbje si fitimet neto të realizuara / humbjet mbi asetet financiare.

Interesi në dispozicion për shitje i letrave me vlerë të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv është i njohur në fitim ose humbje. Dividendët nga instrumentat e mbajtura për shitje të kapitalit njihen në fitim ose humbje kur e drejta e kompanisë për të marrë pagesa është themeluar. Të dyja janë të përfshira në linjë të ardhurave nga investimet.

Vlerat e drejta të investimeve të cituara janë bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Nëse tregu për një aset financiar nuk është aktiv, Kompania përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të vlerësimit. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve në gjatësinë e krahut, referenca për

## **"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

### **Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

instrumente të tjera që në thelb janë të njëjtë, analiza e rrjedhës së parasë të diskontuar etj

#### **3.11 Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme**

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshinë paranë e gatshme, depozitat në të pare dhe investimet e tjera shumë likuide afatshkurtra të cilat janë lehtë të konvertueshme në një shumë të njohur të parave dhe janë subjekt i rrezikut të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerë.

#### **3.12 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera**

Detyrimet për llogarite e pagueshme tregtare dhe të tjera maten sipas kostos e cila përfaqëson vlerën fer të shumës që duhet të paguhet për mallrat apo shërbimet e pranuar pa marre parasysh a i janë faturuar apo jo kompanisë.

#### **3.13 Kostot e përfitimeve të pensionimit**

Kompania nuk bënë provizionin dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve përveç atyre të paguara pranë Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK).

#### **3.14 Tatimi**

Tatimi është kalkuluar në pasqyrat financiare në përputhshmëri me ligjin aktual në fuqi të Kosovës mbi tatimet, Ligji nr. 06/L-105 "Tatimi mbi të Ardhurat e Korporatave". Norma e tatimit mbi të ardhurat e tatueshme të korporatave është 10%.

##### *- Tatimi aktual*

Tatimi aktual llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç raportohet në fitimin ose humbjen sepse përjashton zërat e të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe më tej përjashton zëra që nuk janë kurrë të tatueshëm ose të zbritshëm. Përgjegjësia e kompanisë për tatimin aktual llogaritet duke përdorur tarifën tatimore që janë aprovuar në mënyrë thelbësore ose thelbësore deri në fund të periudhës së raportimit. Një provizion është e njohur për ato çështje për të cilat përcaktimi i tatimit është i pasigurt, por konsiderohet e mundshme që do të ketë një rrjedhje të ardhshme të fondeve tek një autoritet tatimor. Provizionet maten në vlerësimin më të mirë të shumës që pritet të paguhet. Vlerësimi bazohet në gjykimin e profesionistëve të tatimeve brenda Kompanisë bazuar në përvojën e kaluar me këto aktivitete dhe në raste të caktuara në bazë të këshillave të pavarur të këshillimit tatimor.

##### *- Tatimi i shtyrë*

Tatimi i shtyrë njihet në ndryshimet midis vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve në pasqyrat financiare dhe bazës përkatëse tatimore të përdorur në llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe llogariten për përdorimin e metodës së bilancit. Detyrimet tatimore të shtyra njihen përgjithësisht për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe pasuritë tatimore të shtyra njihen në atë masë sa është e mundshme që fitimet e tatueshme do të jenë të disponueshme kundrejt të cilave mund të përdoren diferencat e përkohshme të zbritshme. Vlera kontabël e

## **"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

### **Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

*(shumat janë në Euro)*

pasurive tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe zvogëlohet në atë masë sa nuk është më e mundshme që fitimet e mjaftueshme të tatueshme do të jenë në dispozicion për të lejuar që të gjithë ose një pjesë e pasurisë të rikuperohet.

Tatimi i shtyrë llogaritet në normat e tatimeve që pritet të zbatohen në periudhën kur detyrimi shlyhet ose pasuria realizohet. Tatimi i shtyrë është ngarkuar ose kredituar për fitim ose humbje, përveç kur ka të bëjë me zërat e ngarkuar ose kredituar drejtpërdrejt në ekuitetin e vet, si PPE të rivlerësuar më parë të trajtuar si kosto e vlerësuar për kalimin në SNRF, në këtë rast tatimi i shtyrë gjithashtu trajtohet në ekuitet.

Matja pasuese e detyrimit tatimor të shtyrë llogaritet gjithashtu në ekuitet si të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse. Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar pasuritë tatimore aktuale ndaj detyrimeve tatimore aktuale dhe kur ato lidhen me taksat e të ardhurave të vendosura nga i njëjti autoritet tatimor dhe Kompania synon të shlyejë pasuritë dhe detyrimet e tanishme tatimore në baza neto. Kompania nuk e njeh pasuri tatimore të shtyrë në provizione duke përfshirë provizionin e arkëtueshme pasi konsideron se është për shkak të pasigurisë së trajtimit tatimor në periudhat e ardhshme.

*- Tatimi aktual dhe i shtyrë për vitin*

Tatimi aktual dhe i shtyrë njihet në fitim ose humbje, përveç kur lidhet me zërat e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt me ekuitetin, në të cilin rast tatimi aktual dhe i shtyrë njihet edhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose të ardhura neto nga ekuiteti.

### **3.15 Ekuiteti**

#### **3.15.1 Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar përbëhet nga 10,000 euro.

#### **3.15.2 Humbjet e akumuluar**

Humbjet e akumuluar debitohen / kreditohen për humbjet ose fitimin e vitit.

### **3.16 Njohja e të hyrave**

*Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e Entitetit kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë*

Të ardhurat njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike.

### **3.17 Grantet qeveritare**

Grantet qeveritare nuk njihen derisa të ekzistojë siguri e arsyeshme që Kompania do të respektojë kushtet e këtyre granteve dhe që ato grante do të pranohen.

Grantet qeveritare kushti kryesor i të cilave është që Kompania duhet të blejë, ndërtojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të sigurojë asete jo-rrjedhëse njihen si të hyra të shtyra në bilancin e gjendjes dhe transferohen në pasqyrën e të ardhurave në bazë sistematike dhe racional përgjatë kohës së përdorimit të aseteve përkatëse.

Grantet tjera qeveritare njihen si e hyrë gjatë periudhave të nevojshme për t'i barazuar ato me shpenzimet të cilat ato kanë për qëllim t'i kompensojnë, në mënyrë sistematike. Grantet qeveritare që janë të arkëtueshme si kompensim për shpenzimet apo humbjet që tani kanë ndodhur apo që kanë për qëllim dhënien e përkrahjes së menjëhershme financiare për Kompaninë pa shpenzime që lidhen me të ardhmen njihen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës në të cilën ato bëhen të arkëtueshme.

### **3.18 Provizionet**

Një provizion njihet kur Kompania ka një detyrim të tanishëm si rezultat i një ngjarjeje në të shkuarën dhe është e besueshme që një rrjedhë e burimeve që paraqesin përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të paguar një detyrim, dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në lidhje me shumën e obligimit. Provizionet rishikohen gjatë secilës datë të bilancit të gjendjes dhe korrigjohen me qëllim që të reflektojnë vlerësimin më të mirë aktual. Kur efekti i vlerës në kohë të parës është material, shumën e provizionit është vlera e tanishme e shpenzimeve të cilat priten të jenë të nevojshme për të paguar obligimin.

### **3.19 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim**

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

#### *- Jeta e dobishme e Pronave, impianteve dhe pajisjeve*

Sic është shpjeguar në shënimin, Kompania rishikon jetën e dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të secilës periudhë të raportimit. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktorëve tjerë mund të ndikojë në jetën e dobishme të aseteve dhe rrjedhimisht mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme në shumën e bartur të këtyre aseteve.

#### *- Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe stoqet:*

Kompania është në proces të aprovimit të rregullores për llogaritë e arkëtueshme, dhe me aprovimin e kësaj rregullore dhe hyrjes në fuqi do të bëhen rregullimet e nevojshme. Në rrjedhën normale të biznesit, Entiteti do të bëjë vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme. Duke u bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave dhe shlyerjen e stoqeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

#### *Vlerësimi i rasteve ligjore:*

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bëjë një vlerësim për shumën që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, kompania në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos

**“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

**4.Prona, paisjet dhe impiantet**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>				
	<b>Toka dhe pasurit e pazhvleresuara</b>	<b>Ndertesa dhe struktura ndertimore</b>	<b>Automjete Transporti dhe paisje</b>	<b>Total</b>
	<b>Investments on objects</b>	<b>Furniture and furnishings</b>	<b>Equipment</b>	<b>Total</b>
<i>Balanca më 31 Dhjetor 2023</i>	161,534,513	45,973,130	112,223,169	319,730,812
<i>Balanca më 31 Dhjetor 2024</i>	161,534,515	45,984,576	112,777,891	320,296,982
<i>Balanca më 31 Dhjetor 2025</i>	161,534,515	45,984,576	112,538,322	320,057,413
<i>Tokat te bashkangjitura pasurise (te pa deklaruar vitete te shkuara )</i>	237,372,379			237,372,379
<i>Balanca më 31 Dhjetor 2025 - Me Rivleresimin e tokës</i>	398,906,894	45,984,576	112,538,322	557,429,791
<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>				
	<b>Toka dhe pasurit e pazhvleresuara</b>	<b>Ndertesa dhe struktura ndertimore</b>	<b>Automjete Transporti dhe paisje</b>	<b>Total</b>
	<b>Investments on objects</b>	<b>Furniture and furnishings</b>	<b>Equipment</b>	<b>Total</b>
<i>Balanca më 31 Dhjetor 2023</i>				3,263,711

**“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

Balanca më 31 Dhjetor 2024	2,766,522
Balanca më 31 Dhjetor 2025	2,299,388

**5.Stoku**

Njësia operative Mitrovica Jug		
<b>Stoku</b>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Stoku	29,117,941	28,919,274
<b>Total</b>	<b>29,117,941</b>	<b>28,919,274</b>
Njësia operative Mitrovica Veri		
<b>Stoku</b>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Stoku	821,120	735,079
<b>Total</b>	<b>821,120</b>	<b>735,079</b>

Lidhur më gjendjen e stokur, referuar “Vlerësim dhe analizë strategjike e përbërjes minerale, potencialit ekonomik dhe implikimeve mjedisore të 12 deponive industriale të mbetjeve të Trepçës.” i dates Shatort 2025, është vlersuar gjendja e vlerave minerale në sasi dhe vlerë financiare, mirëpo nuk është vlersuar regjistrimi në PVF-të për vitin 31 dhjetor 2025.

Metalreserves tailings deposits of the Kishnicë and Artanë/ Novo Brod Flotation Mines Busniess Unit.					EstimaTED Value Based on Curent stock market price
Metals	Artane/Novo Brod 1/2	Badovc/ Badovac	Gracanica/ Gracanica	Total	
	Qty	Qty	Qty	Qty	
Pb (ton)	6,937.13	16,422.80	53,800.69	77,160.62	154,321,240.00
Zn (ton)	8,740.25	22.868.17	70,763.00	79,503.25	286,639,976.00
Ag (kg)	35,723.10	65,312.22	223,735.96	324,771.28	487,156,920.00
Au (kg)	1,462.93	3,748.63	23,934.54	29,146.10	3,614,116,400.00
					<b>4,542,234,536.00</b>

Deposit Site	Estimated Value €
Kelmend	414,401,973
Artane/Novo Brod 1 and 2	273,334,930

**“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

Mitrovicë/ Mitrovica PIM	160,328,700
Badovc/ Badovac	659,674,926
Gracanicë/Gracanica	3,609,224,680
Leposaviq/ Leposavic 1	49,434,645
Gornje Polje 1	452,148,133
Gornje Polje 2	649,403,302
Gornje Polje 3	827,333,284
Zhitkovc	1,319,200,908
<b>Total (all deposits)</b>	<b>8,414,485,481</b>

**6. Të arkëtueshmet dhe të tjera**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	2,024,094	2,200,992
Provizionet per borxhet e kqia	499,165	-
<b>Total</b>	<b>2,523,260</b>	<b>2,200,992</b>

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
<b>Të arkëtueshmet</b>		
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	7,123,387	5,979,124
		(116,589)
<b>Total</b>	<b>7,123,387</b>	<b>5,862,535</b>

**7. Pasuri tjera afateshkurtera**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
<b>Të arkëtueshmet</b>		
Tvsh e arkëtueshme	1,443,478	953,284
Parapagimet afateshkurtera	-	79,787
Kerkesa tjera		-
<b>Total</b>	<b>1,443,478</b>	<b>1,033,071</b>

**8. Paratë e gatshme dhe ekuivalentët e saj**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Paraja ne dore	1	692
Llogaria ne banke TEB	30,713	
Llogaria ne banke NLB USD		477,899

**"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

<b>Total</b>	<b>30,713</b>	<b>478,591</b>
<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Paraja ne dore		12,280
Llogaria ne banke	224,964	137,478
Ekuivalentet e parase		-
<b>Total</b>	<b>224,964</b>	<b>149,758</b>

**9. Grantet dhe të hyrat e shtyra**

**9. Grantet dhe të hyrat e shtyra**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>	<b>Vlera</b>	<b>Zhvlersimi</b>	<b>Total te hyrat e shtyera</b>
<b>31 Dhjetor 2023</b>	1,826,973	365,395	2,030,663
<b>31 Dhjetor 2024</b>	2,459,289	491,858	1,538,805
<b>31 Dhjetor 2025</b>	1,538,805	338,918	1,199,887
<b>Shpronsimi i pronave</b>			
<b>31 Dhjetor 2025</b>	653,954	-	653,954
<b>Totali:</b>			
<b>31 Dhjetor 2025</b>	2,192,759	-	1,853,841

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>	<b>Vlera</b>	<b>Zhvlersimi</b>	<b>Total te hyrat e shtyera</b>
<b>9.2 Grantet dhe të hyrat e shtyra</b>			
<b>31 Dhjetor 2023</b>			1,618,009
<b>31 Dhjetor 2024</b>			1,404,885
<b>31 Dhjetor 2025</b>			1,217,568

**"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

**10. Llogaria e Pagushme, detyrimet e pagueshme dhe akrualet**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Llogarite e pagueshme	7,165,910	7,720,748
Detyrime tjera / sindikata	45,243	-
Akruaal per shpenzimet e Energjise elektrike	370,048	
<b>Total</b>	<b>7,581,202</b>	<b>7,720,748</b>

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
<b>Taksat dhe detyrimet e tjera të pagueshme</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Llogarite e pagueshme	6,191,293	5,285,182
Detyrime tjera	12,859	181,846
<b>Total</b>	<b>6,204,151</b>	<b>5,467,028</b>

**11. Detyrimet e tjera afatshkurtera**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Parapagimet nga bleresit	374,106	962,841
Te pagueshmet ndaj tatimit ne burim	3,612,012	2,971,560
Parapagimi per tatimin ne fitim		-
Te pagueshmet ndaj kontributeve pensionale	5,644,885	4,478,178
Te arketueshmet per ATK (TVSH e paguar ne avanse)		-
Interesi I pagueshem-Renta minerare	5,183,571	4,214,033
Interesi I pagueshem ne Tatim		631,119
Interesi I pagueshem ne Kontribute pensionale		955,486
Detyrimi per TVSH		-
Detyrimi per paga	186,782	-
<b>Total</b>	<b>15,001,356</b>	<b>14,213,218</b>

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
<b>Parapagimet për shpenzimet dhe tatimin</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Parapagimet		-
te pagueshmet ndaj tatimit ne burim	2,317,801	-
Parapagimi per tatimin ne fitim		-
Te pagueshmet ndaj kontributeve pensionale	3,780,390	5,354,061
Te arketueshmet per ATK (TVSH e paguar ne avanse)		-
Interesi I pagueshem-Renta minerare		-
Interesi I pagueshem ne Tatim		-
Interesi I pagueshem ne Kontribute pensionale		-
Detyrimi per TVSH		1,200,582
Detyrimi per paga		337,818
Detyrime tjera	1,856,131	-
<b>Total</b>	<b>7,954,323</b>	<b>6,892,461</b>

**“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

**12. Te hyrat**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Te hyrat nga shitjet e mallrave	11,950,648	6,392,270
<b>Total</b>	<b>11,950,648</b>	<b>6,392,270</b>

**Njësia operative Mitrovica Veri**

Te hyrat nga sherbimet	31-Dec-25	31-Dec-24
Te hyrat-Njësia operative Mitrovica Veri	10,102,111	8,933,455
<b>Total</b>	<b>10,102,111</b>	<b>8,933,455</b>

**13. Kostoja e Mallit te Shitur**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Stoku në fillim	28,919,273	31,369,694
Blerjet 2025	1,510,681	
Stoku në fund	(29,117,941)	28,919,273
<b>KMSH</b>	<b>1,312,013</b>	<b>2,450,421</b>
Shpenzimet e Energjis elektrike ne prodhim dhe tjera	3,135,756	2,243,462
Shpenzimet e pagave te punetoreve ne prodhim	9,605,756	6,064,575
Renta Minerare	969,538	
Kosto Tjera qe l ngarkohen KMSH	60,112	
<b>KMSH</b>	<b>13,771,162</b>	<b>10,758,458</b>

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Stoku në fillim+Blerjet	9,445,945	9,662,612
Stoku në fund	821,120	735,079
<b>KMSH</b>	<b>8,624,825</b>	<b>8,927,533</b>
Shpenzimet Direkte		-
<b>KMSH</b>	<b>8,624,825</b>	<b>8,927,533</b>

**"TREPÇA" SH.A. - MITROVICË****Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025***(shumat janë në Euro)***14. Te hyrat tjera**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Te hyrat-Njësia operative Mitrovica Jugore	-	10,553,095
Te hyrat nga Qiraja	602,670	
Te hyrat nga energjia Elektrike	65,656	
Te hyra nga subvencionet	5,320,332	
Të ardhura nga amortizimi i aseteve Donacion	491,858	
Te hyrat tjera	185,501	
<b>Total</b>	<b>6,666,018</b>	<b>10,553,095</b>

**14. Te hyrat tjera**

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Te hyrat-Njësia operative Mitrovica Veri	236,554	1,712,151
Të ardhura nga amortizimi i aseteve Donacion	187,316	
<b>Total</b>	<b>423,870</b>	<b>1,712,151</b>

**15. Shpenzimet e personelit****15. Shpenzimet e personelit**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Pagat bruto	2,361,609	4,920,114
Kontribute pensionale	118,080	246,006
Shpenzimet e sigurimit të Stafit	-	68,614
<b>Total</b>	<b>2,479,689</b>	<b>5,234,733</b>

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Pagat bruto	533,351	529,641
Kontribute pensionale		26,482
Stipendionet për punëtor		74,099
Shpenzimet e sigurimit të Stafit		20,680
<b>Total</b>	<b>533,351</b>	<b>650,902</b>

**“TREPÇA” SH.A. - MITROVICË**

**Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025**

(shumat janë në Euro)

**16. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative**

<b>Njësia operative Mitrovica Jug</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Shpenzime Administrative	20,060	374,247
Shpenzimet e zyrës	46,691	55,619
Shpenzimet e energjis elektrike	187,298	249,274
Shpenzimet e ujit	213,749	143,338
Shpenzimet e reprezentacionit		4,576
Shpenzimet e menzes dhe ushqimit		150,652
Shpenzimet e mirembajtjes dhe te tjera	300,855	
Shpenzime tjera dhe sigurime	60,158	
Shpenzimet e interesit per vonesa	232,859	
<b>Total</b>	<b>1,061,670</b>	<b>977,706</b>

<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
<b>Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Shpenzime Administrative		29,236
Shpenzimet e zyrës		39,345
Shpenzimet e energjis elektrike		748,549
Shpenzimet e ujit		-
Shpenzimet e reprezentacionit		-
Shpenzimet e menzes dhe ushqimit		276,525
Shpenzimet e mirembajtjes dhe te tjera		
Shpenzime tjera		
Shpenzimet e interesit per vonesa		
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>1,093,655</b>

**17. Shpenzimet operative**

<b>Njësia operative Mitrovica Jugore</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Shpenzimet e Shperndarjes dhe logjistikës	223,040	469,177
Shpenzimet e fushates		1,723
Shpenzimet e fabrikes dhe puntorise	121,130	51,697
<b>Total</b>	<b>344,170</b>	<b>522,597</b>
<b>Njësia operative Mitrovica Veri</b>		
	<b>31-Dec-25</b>	<b>31-Dec-24</b>
Shpenzimet e Shperndarjes dhe logjistikës	2,141,096	184,077
Shpenzimet e fushates	-	-
Shpenzimet e fabrikes dhe puntorise		136,375
<b>Total</b>	<b>2,141,096</b>	<b>320,452</b>

## “TREPÇA” SH.A. - MITROVICË

### Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat janë në Euro)

#### 18. Fitimi ose humbja nga kursi i kembimit

Njësia operative Mitrovica Jugore	31-Dec-25	31-Dec-24
Shpenzimet e humbjes nga kursi i kembimit	(38,528)	-
<b>Total</b>	<b>(38,528)</b>	<b>-</b>
Njësia operative Mitrovica Veri	31-Dec-25	31-Dec-24
Shpenzimet e Shperndarjes dhe logjistikes	-	-
Shpenzimet e fushates	-	-
Shpenzimet e fabrikes dhe puntorise	-	-
<b>Total</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

## MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

### A: - Menaxhimi i rrezikut kapital

Objektivat e Kompanisë kur menaxhon me kapital janë që të mbrojë aftësinë e Kompanisë për të vazhduar me vijimësinë në mënyrë që të ofrojnë kthime për aksionarët përmes optimizimit të gjendjes së borxhit dhe ekuitetit. Struktura e kapitalit të kompanisë përbëhet nga huazimet dhe kapitali i atribuar ndaj mbajtësit të kapitalit, që përfshin kapitalin, rezervat dhe humbjet e mbajtura.

#### Raporti i borxhit

Menaxhmenti rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij shqyrtimi, menaxhmenti konsideron koston e kapitalit dhe rrezikun që lidhet me secilën klasë të kapitalit. Raporti i borxhit në fund të vitit ishte si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Borxhi	39,812,440	37,237,145
Ekuiteti	561,201,602	325,205,659
<b>Koeficienti i borxhit në raport me ekuitetin</b>	<b>0.07</b>	<b>0.11</b>

	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
Borxhi	39,812,440	37,237,145
Ekuiteti	561,201,602	325,205,659
<b>Koeficienti i borxhit në raport me ekuitetin</b>	<b>7%</b>	<b>10%</b>

## "TREPÇA" SH.A. - MITROVICË

### Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat janë në Euro)

#### B: - Rreziku kreditor

Kompania i nënshtrohet rrezikut të kredisë përmes aktiviteteve të saj të shitjes. Në këtë drejtim, rreziku i kredisë për Kompaninë buron nga mundësia që palë të ndryshme mund të mos paguajnë detyrimet e tyre kontraktuale. Kompania merr garanci kur është e përshtatshme për të zbutur rrezikun e kredisë. Politika e Kompanisë është që të merret vetëm me palë të besueshme. Kushtet e kredisë variojnë midis 30 dhe 90 ditë.

Rreziku i vazhdueshëm i kreditor menaxhohet duke monitoruar klientët çdo muaj dhe duke i paralajmëruar klientët menjëherë. Të arkëtueshme tregtare përbëhen nga një numër i madh i konsumatorëve. Llogaritë e arkëtueshme konsumatorët e amviserise përbejnë pjesën e konsiderueshme të arkëtueshmeve neto të Kompanisë më 31 dhjetor 2024. Rreziku i kredisë për para dhe ekuivalentët e saj konsiderohet i papërfillshëm, pasi palët janë banka me reputacion. Ekspozimi maksimal i kompanisë ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e secilës pasuri financiare në Pasqyrën e pozicionit financiar, siç thuhet në tabelën e mëposhtme:

Pasuritë financiare	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
<i>Huatë dhe arkëtimet</i>		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	9,646,647	8,063,527
Pasuri tjera afateshkurtera	1,443,478	1,033,071
Paraja dhe ekuivalentët e saj	255,677	628,349
<b>Totali:</b>	<b>11,345,802</b>	<b>9,724,947</b>

#### C: - Rreziku tregtar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë kryesisht në rrezikun financiar të ndryshimeve në normat e interesit, si më poshtë në 28 (e) dhe rrezikun e mallrave në 28 (d). Rreziku i tregut nuk është i përqendruar në rrezikun valutor, pasi shumica e transaksioneve të kompanisë janë në valutë vendore.

#### D: - Rreziku i produktit

Rreziku i mallit i referohet paqartësive të vlerave të tregut në të ardhmen dhe madhësisë së të ardhurave të ardhshme, të shkaktuara nga luhatja e çmimeve të mallrave. Kompania nuk është ekspozuar ndaj rrezikut te produktit.

#### E: - Rreziku i normave të interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive që mbartin interes ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve që mbartin interesin e përdorur për të

## "TREPÇA" SH.A. - MITROVICË

### Pasqyra financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

(shumat janë në Euro)

financiar ato pasuri (ri -Rreziku i çmimit). Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është e fiksuar në një instrument financiar tregon, në ç'masë është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

Menaxhmenti beson se Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit në instrumentet e tij financiarë. Më poshtë është dhënë analiza e pasurive financiare dhe e detyrimeve financiare.

#### F: Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit pasqyron paaftësinë e Kompanisë në mbledhjen e fondeve për të përmbushur zotimet. Menaxhmenti monitoron nga afër pozicionin e likuiditetit dhe rrjedhën e parasë të Kompanisë. Kjo përfshinë mirëmbajtjen e pasqyrave të raporteve të likuiditetit të pozicionit financiar, përqendrimit të debitorëve dhe kreditorëve si në aspektin e përzierjes së përgjithshme të financimit, ashtu edhe për shmangien e besimit të padrejtë të një klient të madh individual. Më 31 dhjetor 2024 dhe 2023, detyrimet e kompanisë kanë maturime kontraktuale (përfshirë pagesat e interesit kur është e aplikueshme) siç përmbliidhen më poshtë:

Pasuritë financiare	Më 31 Dhjetor 2025	Më 31 Dhjetor 2024
<i>Huatë dhe arkëtimet (kosto e amortizuar)</i>		
Të arkëtueshmet tregtare dhe të tjera	9,646,647	8,063,527
Paraja dhe ekuivalentët e saj	255,677	628,349
<b>Total</b>	<b>9,902,324</b>	<b>8,691,876</b>
<b>Detyrimet financiare</b>		
<i>Detyrime të tjera (kosto e amortizuar)</i>		
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera	13,785,353	13,187,776
<b>Total:</b>	<b>13,785,353</b>	<b>13,187,776</b>
<b>Raporti</b>	<b>0.72</b>	<b>0.66</b>

#### 19. Ngjarjet pas datës raportuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullim ose shpallje në pasqyrat e veçanta financiare.